Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (133). MAJ 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Të rinjtë, heronjtë e heshtur të Dibrës



Nga **Samet Zagradi**

15 vjet "Sarina 2002", një histori suksesi



Nga **Zabit Lleshi**

Sabri Abdiu - Mjeshtri i Madh, meteori i sportit dibran!



Nga **Defrim Methasani**

Të pushtojmë Korabin

Për herë të parë klubi Discover Albania e vendos Malin e Korabit si atraksion turistik. Misioni ka nisur më 5 mars dhe më 2 korrik, anëtarët e klubit synojnë ngjitjen në majën më të lartë në Shqipëri

Nga **Alban Tufa - Faqe 3**



Në Korab me ambasadorin e Zvicrës

Nga **Grehans Uka - faqe 7**

REPORTAZH

GOLLOBORDA, vendi i varfër i mjeshtërve të punës dhe të mundjes



Nga **URIM BAJRAMI**

Ah, sikur të ishte bërë kjo Rruga e Arbërit, ah...!

E pamundur të mos e dëgjoje këtë ofshamë të zgjatur tek ata që kishin tejmbushur rrugët e Ostrenit të Madh, të enjten e 18 majit. Gra, burra dhe fëmijë i gëzoheshin kampionatit tradicional të mundjes, një aktivitet tashmë i përvitshëm, që përpiqet të mbajë gjallë një traditë të vyer e të vjetër sa vetë Golloborda.

Ostreni, ai i madhi, ishte bërë gati për të pritur mysafirë nga çdo cep i Shqipërisë ku gollobordasit duartë kanë lënë gjurmët e tyre të pashlyera. Mysafirë ishin dhe kampionët e mundjes, të shpërndarë në shumë vende të botës. Ata u nderuan me kupa dhe tituj nga organizatorët e kampionatit tradicional të mundjes, si një përpjekje modeste për të kthyer kokën pas e për të mos harruar një trashëgimi që ua kanë zili të gjithë. Sofra e madhe e Gollobordës do të dukej e paplotë pa përfaqësuesit nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, bashkë me ekipet e tyre të mundjes, të cilët u ndeshën me vëllezërit e tyre në tapetin e gjelbër të barit.

(Lexoni në faqen 11-12)

NË BRENDËSI: ■ Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" **proteston** kundër ndërtimit të HEC-it SETA 4 ■ **Skllavërimi** i Dibrës ■ **Politikanë**, mos na vidhni festat ■ **Përurohet** monumenti i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Vajkal të Bulqizës ■ **Kafe në Athinë** me një zdojanak të ri ■ **Familja Topuzi**, aty ku me punë ndërtohet e ardhmja ■ **Bahutja**, fshati që po shkon drejt zhdukjes… ■ A është "Qytetar Nderi" **Xhafer Martini?!** ■ **Pehlivanët** e Gollobordës ■ **"Shtegu"** që ndan poezinë e vërtetë nga vjershërimi amator ■ **Liman Hoxha**, njeriu i punëve dhe jo i fjalëve ■ **Vepra e Naim Plakut,** një testament fjale ■ **Fisi Doda** në Reç të Dibrës ■ **Ali Abas Buci**, drejtuesi e kryetari që mbahet mend për mirë ■ **Fëmijëria**, shkolla, rinia ■ **Tola i Çidhnës**, kullë e nacionalizimit ■ **Sulejman Istrefi**, shpirti stoik ■ **Qazim Prejsi** dhe populli i Lurës ■ **Arif Vladi**, zëri i këngëve lapidare

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 133

Redaksia i njofton bashkëpunëtorët e saj, se të njëjtat shkrime të botuar në mediumet e tjera nuk do të mund të botohen në faqet e gazetës, përveç rasteve kur çështja mbetet aktuale dhe e nevojshme për riinformim.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (133). Maj 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Naim ZOTO
Urim BAJRAMI
Arsim KOLARI
Grehans UKA
Metush SKEJA
Dionis XHAFA
Halil RAMA
Zabit LLESHI
Hilë LSHAKU
Razi RAMA
Islam ÇENGA
Besnik ALKU
Agim DODA
Osman VLADI
Mevludi BUCI
Dedë DOÇI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" **proteston kundër ndërtimit të HEC-it SETA 4**

Paraditen e 6 majit, Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" protestoi për më shumë se një orë para Prefekturës së Dibrës, kundra futjes në tuba të ujit të Setës, në kuadër të ndërtimit të HEC-eve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4. Protesta u mbështet nga antarë të shoqatës dhe banorë të zonën.

Pas protestës në Peshkopi, ata u zhvendosën në Çidhën, pikërisht në vendin, ku pritet të ndërohet Seta 4. Disa nga protestuesit ishin çidhnak te ardhur dhe nga Tirana me nxitjen e shoqates ''Çidhna dhe Kastriotët '', të cilët ishin mbi 40 protestues.

Ujëvara dhe shpella e Sopanikës, të cilat janë në rrjedhën ujore të Setës, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr 676, datë 20.12.2002, u shpall Zonë e mbrojtur dhe Monument Natyre, firmosur nga ishKryeministri Fatos Nano. Ndërsa në dokumentin e rregullores për miratimin e lejes së ndërtimit të hidrocentraleve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4, mbi përroin e Setës me shtrirje në territorin e Qarkut Dibër shkruhet: "Në zonën e zgjedhur për projektin në fjalë nuk ka habitate apo objekte me status të përcaktuar, por theksojmë se e gjithë zona ku këto nënobjekte do të dërtohen, është zonë e cila nuk ka ndonjë status të veçantë mbrojtjeje".

Kanali i Setës fillon, sapo mbaron Gurë Lura, aty gjendet një burim që quhet Sopanikë që është burim më i madh i Setës mbi kanal. Kjo është një e treta e burimeve të Setës, ndërsa pjesa tjetër buron nën kanal.

Themeluesi i Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët Mustafa Tola, shprehet: "Seta 1+2, dhe Seta 3 nuk e shkatërrojnë Setën, por shkatërrimi i vërtetë vjen me Setën 4. Sigurisht e dëmtojnë, por jo aq shumë në bilanc me interesat. Ujrat e Setës, rreth 2 km, në gjatësinë më të bukur, do të futen në tuba çeliku nën tokë, përfshi këtu edhe një tunel. Kështu, thahet totalisht dhe kthehet në shkretëtirë".

Madej ai shton: "Ujvara dhe shpella e Sopanikës, është shpallur Monument i mbrojtur dhe Monument Natyror me vendim të Këshillit të Ministrave Nr 676, datë 20.12.2002".

Zoti Tola, shprehet se aty bëhet pllenimi ose rrahja e peshkut dhe me tharjen e ujrave e e gjithë fauna e asaj zone do të shkatërrohet. Seta është e pastër, dhe me natyrë të virgjër. Ajo ka jetën dhe gjallesat e saj. Banorët kanë jetuar edhe me peshkim dhe me Setën kanë jetuar.

Në fakt trofta që rritet në këto vende, është më e mira e peshkut në Dibër.

Me tharjen e setës mund të zhbëhet edhe historia në planin afatgjatë, duke qenë se në këtë vend është prejardhja e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu.

Z.Tola shprehet më tej se ata vetëm duan vendin, nuk i shtyn asnjë interes tjetër.

Shoqata ka dy vite që e kundërshton me shkresa Setën 4, madje kanë dërguar edhe një peticion me 300 firma të banorëve të zonës, por u shpërfill.

Zona e Çidhnës, dhe saktësht rrjedha e Setës, shquhet për pamjet e gjelbërta dhe atraksionet turistike. Gjithashtu edhe për ujrat e shumtë të pijshëm. Në përgjithësi tërësisht zona e Çidhnës shquhet për rezistencë kombëtare dhe për vlera etno-kulturore.

A.Tufa



reportazh

“Të pushtojmë Korabin” ky është misioni i Klubit Discover Albnia. Misoni ka nisur më 5 mars dhe do zgjasë deri në kurorëzimin e tij më 2 Korrik 2017.

Një ditë në Korab

Nga **ALBAN TUFA**



Foto © Grehans Uka

Fundmaj, ditë e shtunë, unë së bashku me tim atë morëm rrugën për në Malin e Korabit .

Pika e nisjes për ngjitje alpinistike (edhe pse ne nuk kemi kishim këtë plan) në Korab është fshati Radomirë, i lidhur me rrugë automobilistike me Peshkopinë.

Ngaqë nuk ka furgona për të arritur deri në vend, por edhe ato që të çojnë në zonat rrotull që përbëjnë Kalanë e Dodës, lëvizin vajtje-ardhje vetëm një herë në ditë. U nisëm me makinën tonë. Megjithse është disi rrangalle, punën e bëri fort mirë. Ne u nisëm nga fshati im (Sohodoll) drejt Kalasë së Dodës, fiks në orën 8 të mëngjesit. Rruga nuk është e keqe, por kthesat janë rraskapitëse.

Peizazhet që ndesh rrugës të marrin me vete në të gjelbërtën e tyre. Ecja normale, e kalon ose jo një orë, dhe gjendesh në Kalanë e Dodës. Sapo kalon urën e Veleshicës dhe ngjitesh në ca kthesa që formojnë zig-zage, në të përtejmen e Veleshicës shtrihen shpate të thepisura gipsi. Këtu pranvera vjen me pak vonesë dhe rrugës lulet kanë çelur. Rruga dukej sikur priste arat ku në to po mbilleshin misrat. Thuajse në çdo arë kishte një burrë që mbante plugun që tërhiqte kalin dhe dy-tre nga pas që hidhnin farë.

“Ecni edhe pak, dhe futuni në rrugën e parë majtas”, tha një plak me kësulë, me një palë mustaqe të pazgjatura, pasi e pyetëm se cila është rruga për në fshatin Radomirë, pasi në anën shqipëtare të Malit të Korabit, është më i afërt.

Në Radomirë arritëm për një orë e dhjetë minuta. Ishte një diell rrezëllitë, dhe vendi ishte qetësi. Rrallëkënd shihje në rrugë. Sapo futesh në këtë fshat, veç lartësisë së malit më të madh ndeshesh edhe me lartësinë e një xhamie të ndërtuar nga emigrantët e këtij fshati. Parkuam makinën aty në një hapsirë ngjit një kafeneje, që më vonë mësuam nga pronari se ishte edhe hotel, dhe u ulëm të pinim një kafe. Hotele ishin 3, pastaj në raste fluksi turistësh, gjë që rrallë herë ndodhte, i merrni banorët në shpitë e tyre.

U ulëm jashtë, ku gjendeshin dy tavolina, për të shijuar pamjen që ky vend ofron. Përballë nesh, në një arë të pjerrët, një djalë diku rreth 12 vjeç lëronte arën me kalë. Herë ulej e ngrihej dhe vazhdimisht i rrëshqiste plugu nga duart. Gjatë qendrimit në kafene, mësuam që ishte i biri i një burri që rrinte ulur në një tavolinë tjetër dhe që tërë kohën pinte duan me llullë.

Pas kafesë, u nisëm për në Malin e Korabit. Korabi përbëhet kryesisht nga rreshpe dhe gëlqerore të paleozoit, me strukturë luspore e bllokore dhe nga gipset permo-triasike tepër të shkatëruara nga tektonika. Dhe kur sheh përreth, disa gipse të ngjajnë me pasqyrën. Relievi është shumë i thyer, në veçanti relievi i formuar nga gëlqerorët është mjaft i ashpër, me kreshta e maja të mprehta që përfundojnë në gremina, kurse në rreshpet është relativisht më i butë, kështu që duhet forcë dhe dëshirë për ta parë këtë vend.

Sa nisesh, të gugullon në vesh uji i pastër kristal dhe i ftohtë akull. Është uji që furnizon gjithë qytetin e Peshkopisë dhe një pjesë të madhe të fshatrave të Dibrës. Rruga deri në rrafshat e Korabit zgjat dy deri në tre orë. Ecja sipër vertet që të lodh, sidomos nëse je disi moshë e thyer. Por ajri i pastër, aroma e luleve, e pishave e degdis lodhjen. Kodrina, rrafshnalta dhe fusha të gjelbërta shtrihen pa fund. Rrugës ndeshesh me barinj që kullosin tufat e mëdha me dhenë.

“Me këto jetoj, unë s’kam gjalë për gurbet”, tha një bari, moshë thyer. Sepse në këto zona jetojnë me emgracion, kryesisht në Angli. “Shes qumështin dhe qingjat, jetojmë”, tha bariu.

E lëmë atë në punën e tij dhe ngjitemi sipër, bashkë me tim atë. Përgjatë rrugës lëvizin njerëz tek-tuk. Vende-vende, në qoshke dhe

Sa nisesh, të gugullon në vesh uji i pastër kristal dhe i ftohtë akull. Është uji që furnizon gjithë qytetin e Peshkopisë dhe një pjesë të madhe të fshatrave të Dibrës.

skuta nuk ka shkrirë akoma dëbora. Dhe jo rrallë, buzë dëborës kanë çelë lule.

Në mes një livadhi takuam tre të rinjë, (jemi nga Dipjaka thanë), të cilët mblidhni një lloj luleje të verdhë e quajtur aguliçe. “10 mij lek i shkon kilja, ama të thara” tha njëri prej tyre. Njëri nga ata shprehet se këtu është bukur, por këto ditë janë, si me thënë në orar të punës dhe do vijnë herë tjera, me arsyen e vetme për të eksploruar këtë vend.

“Çdo pranverë e bëjë më këmbë që nga bjeshkët e Gramës e deri këtu”, thotë i treti, pak më i burrëruar se dy tjerët.

Mandej takuam disa turistë të huaj, dhe anglishtja ime edhe pse jo aq e mirë, gjithnjë ia del të merret vesh me të huajt. Të them të drejtën thellë më erdhi turp, pasi ato vinin nga Çekia, për të dytën herë në Korab, ndërsa unë, bir i këtij vendi, jam për herë të parë këtu.

Arritëm në fushën e Korabit, fiks në vendin kur gratë përcillni burrat për në kurbet (oj fusha e Korabit e mjera unë o/ taj na erdhe hakut e mjera unë o).

Kodrat dhe lëndinat ndërthuren me njëratjetrën dhe të krijojnë një pamje mahnitëse. Lulet me ngjyra kanë pushtuar lëndinat dhe herë-herë kanë mbirë edhe mbi dëborë. Këtu e zë dëbora dëborën, duke qenë se ajo rri aty për dymbëdhjetë muajt e vitit.

Kur ngjitesh për në Korab të duhen kë këpucë të forta, dhe mundësisht të mso fusin ujë, sepse këtu ka ujë në çdo 200 metra. Madje i gjithë uji, futet nëpër gropa dhe damarë nëntoksorë dhe mandje ridel në Radomirë. Oshtima e ujit të ndjek gjatë gjithë rrugës, dhe ky tingull vërtet që është shumë relaksues.

Pamja është pabesueshme kur hedh sytë rrotull vetes. Ku gjendesh? 2000 metra lartësi mbi nivelin e detit. Oksigjen me shumicë dhe mushkëritë ngopen tërësisht.

Gjatë rrugës në ngjitje të shoqërojnë masive pyjorep prej bredhi dhe pishe. Aroma e pishave të deh, siç të deh edhe dëshira e të jetuarit këtu.

Drurët rrallohen me ngjitjen e lartësisë, dhe fillojnë e nxjerrin kokën kullota alpine. Drurët këtu janë ruajtur mirë nga banorët dhe kanë fare pak dëmtime, ku: ose janë mirëmbajtur, ose banorët janë pak në raport me të shkuarën por edhe me drurët që gjenden këtu rrotull.

Kullotatat e këtushme, mbajnë gjallë tërë atë pasuri blektorale duke na sjellë kështu mishin dhe produktet më natyrale dhe në kushtet më të favorshme për prodhimin e tyre.

Ka shumë cirqe akullnajore që zbresin shkallë-shkallë në gropën e Panairit në verilindje dhe atë të staneve të Preshit në jugperëndim. Disa prej tyre janë kthyer në liqene të vogla akullnajore. Korabi në përgjithësi është i zhveshur nga bimësia pyjore, por dallohet për kullotat alpine shumë të pasura.

Pasi kaloi mesdita, konsumuam ushqimet që patëm me vete. Këtu gjithçka, madje edhe buka me krypë shijon, sidomos pas lodhjes.

Kthimi nuk është më i lodhshëm dhe zbret shpejt, por kur ndahesh me atë pamje as këmbët nuk të bëjnë. Dëshira për tu kthyer sërish të kaplon akoma pa ikur.

Unë dhe im atë nuk pretendonim alpinizëm, por vetëm unë doja të njihesha me vendin. Sepse, sa herë dëgjoja emrin Korab, ndjeja diç si boshllëk në krahërorë. Dhe jo rrallë, ndër biseda me shokë në Fakultet, më vinte turp të thoja se nuk kam qenë kurrë në Malin Korabit.

MALI I KORABIT PËFSHIHET NË GUIDAT TURISTIKE

Të pushtojmë Korabin” ky është misioni i Klubit Discover Albnia. Misoni ka nisur më 5 mars dhe do zgjasë deri në kurorëzimin e tij më 2 Korrik 2017. Kjo është hera e parë Mali i Korabit përfshihet në guida si atraksion turistik, dhe madje si pikë finale.

Është hartuar një program guidash -përkatësisht 18 udhëtime - që do paraprijnë për përgatitjen e nevojshme për të bërë pushtimin e Korabit. Gjithashtu, krahas udhëtimeve që do kryhen çdo javë, do të jepen dhe informacionet përkatëse për pajisjet dhe veshjet e nevojshme që duhet të keni me vete.

Kjo bëhet me qëllim për ti dhënë mundësi çdo personi që dëshiron të bëjë këtë udhëtime ku të ketë kohën e duhur për t’u përgatitur. Guidat që do të zhvillohen dhe do të paraprijnë ngjitjen e Korabit janë të niveleve të ndryshme dhe fillojnë nga më të lehtat, deri tek ato më sfiduese. Në fund do të jetë guida (tour lideri) që do të përcaktojë nëse mund të bëhesh pjesë e këtij misioni ose jo. Sigurisht bazuar në kushtet fizike dhe shëndetësorë.

Bazuar në të gjitha kushtet dhe elemntët që ndikojnë në mbarvajtjen e udhëtimi Klubi Dicover Albania e ka konsideruar udhëtimin për në Korab si “shumë i vështirë”. Në të gjithë renditjen, vetëm Korabi cilësohet si i tillë, jo vetëm nga lartësia, por edhe nga kushtet infrastukturore, klima, shërbimet që ofrohen dhe kthimin.

Mali Korabit, 2764 metra i lartë, ndodhet edhe maja më e lartë në Shqipëri dhe në Maqedoni, duke qënë se është mal kufi-ndarës. Gjithashtu, Korabi, që renditet i katërti në të gjithë Ballkanin pas Rila (Bullgari), Olimpit (Greqi) dhe Pirini (Bullgari), është ndër malet që të ofron pamje fantastike të natyrës me peizazhe përrallore.

Rruga e Arbërit nr. 133

Kohët e fundit janë shtuar mediat onlinë në qarkun e Dibrës. Redaksia e gazetës sonë e ka theksuar edhe më herët se nuk riboton shkrime të cilat janë botuar më parë, por për disa prej tyre, me qëllim nxitjen e debatit, ne menduam se janë të vlefshme edhe për lexuesit tanë. Për çdo rast, redaksia jo detyrimisht është dakord me konkluzionet e tyre.

opinion

Skllavërimi i Dibrës

Është koha për dibranët e zgjuar nga gjumi, është koha për dibranët e mençur.

Nga **BESNIK ALKU**



Dibra është zona më e varfër në Shqipëri, me numrin më të lartë të papunësisë, largimit të popullsisë me afro 45% (nga 98,000 banorë në 1990, me censusin e fundit është afërsisht tek 62,000 banorë), dhe ku popullsia aktuale trajtohet me ndihmë ekonomike afro 47% e familjeve (rreth 6300 familje), me një shumë prej 25$ në muaj. Pikërisht këtë varfëri të popullsisë e kanë shfrytëzuar politikanët duke u mbajtur peng dibranët me ndihmën ekonomike dhe me thesin e miellit, për t'u blerë votën, për tu mbyllur gojën, e dhënë drejt për ti skllavëruar duke i trajtuar si skllevër.

Dibra është zona më e izoluar në Shqipëri, me infrastrukturën rrugore më të keqe. Dibra është mbajtur peng me rrugën e Arbërit nga politikanët gjatë gjithë këtyre viteve me rrena nga më të ndryshmet, për ta mbajtur atë të skllavërume. Edhe qyteti, fshatrat apo lagjet në Dibër kanë një infrastrukturë rrugore si mos-mëkeq, dhe janë mbajtur peng nga premtimet e politikanëve të vegjël lokalë se do shtrojmë një makinë zhavor, një kamion asfalt, apo një ekskavator dhe, duke ja mbajtur lakun ke fyti e duke e shtrëngu sa herë që vijnë fushatat. Ky është skllavërim kolektiv që i bëhet Dibrës.

Dibra është zona më arsimdashëse, por që ka mbetur pa shkolla dhe me cilësinë më të ulët të arsimit. Shumë shkolla në fshatra të degraduara, pa mjedise mësimore, pa mësues, me kushte mizerable, dhe ku një mësues jep mësim për 3-4 klasa se nuk ka nxënës. Shkollat e mesme të tjera në disa qendra krahinore, nuk kanë mjediset e duhura për mësim dhe oborret e terrenet sportive janë kthyer në ara me misër e jonxhë. Gjimnazi i Peshkopisë dhe shkolla profesionale janë degdisur diku në periferi të qytetit, dhe Universiteti i hapur disa vite më parë është mbyllur duke e lënë simbolin e arsimit në Dibër, godinën e gjimnazit në qendër të qytetit si një ngrehinë e vjetër që pret ta privatizojë ndonjë "dallkauk" apo ta kthejnë në zyra për institucione që nuk bëjnë asgjë por vetëm do marrin rrogat si shpërblim i kontributit politik që kanë dhënë në fushatë. Pra, Dibrën po skllavërojnë duke i marrë dijen, dhe hequr të drejtën për arsimim, duke e pasur më të lehtë ta nënshtrojnë e sundojnë.

Mjedisin e bukur të Dibrës e kanë degraduar dhe masakruar. Pyjet e larta të Lurës, Kacnisë dhe Pratit janë prerë dhe djegur jo vetëm njëherë por disa herë. Peshkopia dhe përrenjtë e Dibrës janë të mbushura plot e përplot me mbeturina, a thua se je në një fushë gjigante mbetjesh. Kjo nuk është bërë pa qëllim, por me qëllimin e vetëm që Dibra të jetë një zonë e shkretë, ku nuk ja vlen të investohet, nuk ja vlen me bërë rrugë, nuk ja vlen me bërë shkolla, por të çojmë kamionë me mbetje nga Italia apo vendet e tjera që do importojnë të fuqishmit e politikës. Ky është skllavërimi dhe uzurpimi i territorit të Dibrës.

Brezi i ri dhe rinia jo vetëm që janë pa shkollë, por u jepet modeli i keq i shoqërisë, i hashashit dhe të fortit. Bareve, rrugëve, rrugicave, mejave dhe arave kudo vetëm era hashash ndihet, a thua se vetëm hashash tymoset dhe ky brez jeton i lumtur në qiejt e hashashit. Të gjithë bisedojnë dhe pregaditen që të jenë ushtarë të shpërndarjes së drogës dhe vjedhjeve në Zvicër, Holandë, Gjermani apo Itali. Këtë rini e kanë më të lehtë ta manipulojnë dhe skllavërojnë.

Dibra është e pa-përfaqësuar në vendimmarrje. E mbushur me buste me dibranë që kanë drejtuar kuvende, beteja, qeveri dhe ngjarje të mëdha të kombit shqiptarë, që duket më shumë sikur nuk kanë ekzistuar dhe nuk kanë qenë pjesë e këtij populli. Sot Dibra shikohet si zonë e lirë për të rehabilituar "mbetsat" e liderve që u kanë ngelë nëpër këmbë në Tiranë, pazareve politike të partickave të vogla që nxjerrin grek, çam, demokristianë, radikalë islamikë, sllav dhe çifutë e lloj-lloj race, por vetëm dibranë jo. Edhe kur zgjidhet ndonjë dibran ato janë njerëz pa-vlera që ngjiten pas një drejtuesi partie për të marrë një rrogë dhe s'ka problem pse ndrrojnë xhaketat, apo ikin nga një zonë në një zonë tjetër, dhe fillojnë e u duket vetja të patjetërsueshëm, u duket vetja si pronarë të Dibrës që herë me një parti e herë me një tjetër ata e kanë nën-sundim Dibrën. Ky është skllavërimi politik i Dibrës, duke e sunduar me njerëz të përhershëm, me sejmenë, çirak dhe dallkaukë.

Ka ardhë koha që dibranët të zgjohen, dhe të krijojnë lëvizjet e tyre, lëvizje dhe organizim si çifutët nëpër botë. Dibranët duhet të krijojnë partinë e tyre apo struktura politike që të mbrojnë të drejtat e dibranëve dhe vazhdojnë përpjekjet për zhvillim ekonomik, social dhe shoqëror. Kjo strukturë duhet të jetë e fuqishme që të mos lejojë skllavërimin e Dibrës, poshtërimin e dibranëve. Ajo duhet të ketë zgjuarsinë me nxit dibranët, dhe guximin me u përballë me pushtetin dhe të pushtetshmit. Kjo lëvizje kërkon individë të fortë që nuk janë përdorur nga pushteti i dikujt tjetër, kërkon të mençur dhe të zgjuar, kërkon edhe guxim qytetarë.

Është koha për dibranët e zgjuar nga gjumi, është koha për dibranët e mençur.

www.dibraexpress.com

Politikanë, mos na vidhni festat

Këto ditë dibranët kanë festuar festat e Shën – Gjergjit dhe të Shën – Kollit. Janë dy festa që mbahen dy javë ndërmjet njëra tjetrës, dhe simbolizojnë ardhjen e pranverës së vertetë në Dibër. Në zonën e ulët është Shën Gjergji dhe festohet me datë 6 Maj, dhe në zonën malore dy javë më vonë me datë 20 Maj. Këto janë festa tradicionale që janë festuar që në kohën e paganëve ne Dibër.

Festimi këtë vit ndodhi me fushatën elektorale të partive në pushtet, që në vend që të kontribonin për organizonizimin e festës sa më mirë për komunitetin dibran, vrapuan se kush të organizohet më mirë me stafin e tyre për të ngrënë mish keci dhe pi raki.

Poltikanë mos ua vidhni festën komunitetit, mos u bëni karshillëk me pasurinë tuaj fukarenjve të Selishtës, Lurës, Arrasit, Luznisë, Muhurit, Zall-Dardhës, Recit, Sllovës dhe te tjerave që janë zonat më të varfëra në Shqipëri.

Mos ua prishni lojrat e fëmijëve që kanë dalë në livadhe, me mbledh lule dhe ngrënë ndonjë kulac me tavolinat tuaja të përplota, me sejmenë dhe dallgauk që ju kanë pregadit kinxha në hell me paratë e korupsionit që kanë bërë ose do bëjnë pas pushtetit dhe me ndihmën sociale të familjeve të këtyre fukarenjve.

Mos ua prishni kuvendimin e burrave mes njëri tjetrit në livadhe, ku diskutojnë hallet dhe planifikojnë verën në fshatrat e tyre, me interesat dhe diskutimet tuaja politike duke u futur grencat e mos me I lënë të shijojnë në mënyrën e tyre këtë festë.

Mos u prishni lojrat grave dhe vajzave, që lojrat e tyre popullore në livadhe janë më të mira se ahengu dhe muzika juaj e makinave apo këngëtarëve që keni marrë me vete.

Mos ua zini dhe prishni livadhet kuajve me makinat dhe foristradat tuaja të shtrejta dhe të shtetit që ju drejtoni.

Punoni që festat të jenë për komunitetin, lehtësoni organizimin e festave sipas mënyrës së vetë banorëve, rruaje traditwn e pasur tw kwtij populli shpirtmadh, organizoni dhe promovoni këto vlera për turzimin dhe zhvillimin e zonës.

Boll me servilizëm politik dhe karshillëk ndaj popullit të varfër.

www.dibraexpress.com



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

përurim

Më 27 maji 2017 u vendos monumenti i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në Vajkalin e Bulqizës, pikërisht në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut"

Përurohet monumenti i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti **Skënderbeu në Vajkal të Bulqizës**

Nga **HYSEN LIKDISHA**

BULQIZA NË FESTË

Të shtunën më 27 maji 2017, Bulqiza u gdhi në festë. Banorë nga Bulqiza dhe zonat përreth saj, por jo vetëm, që në orët e para të mëngjesit mbushin sheshin e qytetit për të festuar me rastin e vendosjes së monumentit të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në Vajkalin e Bulqizës, pikërisht në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut".

Kishin ardhur me këtë rast veç banorëve të zonës edhe banorë nga Kosova, Maqedonia, Tirana, Dibra, Mati etj. Morën pjesë me këtë rast edhe figura përfaqësuese nga fusha e politikës, kulturës artit etj, si ish Presidenti Moisiu, Prefekti i Dibrës, Ardit Kaja, personalitete te kultures dhe artit si: Bujar Kapexhiu, Skënder Cala, etj.pedagogë e profesorë të universiteteve të vendit etj.

Sipas programit në fillim nxënësit e shkollave 9- vjeçare të qytetit, Fushë-Bulqizës, Gollobordës, Martaneshit, të veshur me kostume kombëtare, dhanë një spektakël kulturoro-sportiv, duke zhvilluar në qendër të qytetit lojra olimpike, si dhe valle popullore, duke i dhënë kështu jetë e gjallëri atmosferës festive

Më pas eventi ka vijuar në sallën e kinemasë së Pallatit të Kulturës, ku u dha për të pranishmit një dokumentar kushtuar figurës më të lartë të historisë tonë kombëtare Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Takimin e hapi përfaqësuesi i bashkise nënkryetari Adhurim Lika, i cili uroi të pranishmit për pjesmarrjen në përurimin e vendosjes së përmendores së Skënderbeut në Fushën e Vajkalit, pikërisht aty ku Heroi jonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu zhvilloi dy nga betejat e tij



mbi asqerët e Sulltanit. Dhe vajkalorët e kohës së Skënderbeut, rrëfyen për bijt e bijat e tyre, se këta gurë prezent në fushën e tyre, janë "Gurët e Skënderbeut" të cilët ai i përdori si mjete rrethanore për të sulmuar e frenuar ushtritë që dërgonte herë pas here Sulltani, për të pushtuar vendin tonë. Ish presidenti Moisiu, si ushtarak kariere pohon se Skënderbeu i rritur dhe stërvitur si ushtarak në oborrin e Sulltanit, i njihte në imtësi dredhitë e hordhive osmane, ndaj kush më mirë se aim und tu përgjigjej kurtheve e pusive që hordhitë osmane përdornin për pushtimin e vendit tonë. Dhe pikërisht kush më mirë se Fusha e Vajkalit e garantonte këtë mundësi për të sul-

Qindra pjesmarrës nga Bulqiza e zonat përreth, por edhe nga Dibra, Mati, Tirana, Kosova e Maqedonia, kanë ardhur të marrin pjesë në përurimin e vendosjes së përmendores së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.





të suksesshme brënda një viti, beteja këta që e lidhën Vajkalin e Bulqizës pazgjidhshmërisht me Heroin, gjë e cila është transmetuar tradicionalisht ndër breza të Vajkalorëve, për të mos u harruar kurrë edhe pse kanë kaluar dhe do të kalojnë vite e shekuj me radhë.

FUSHA E VAJKALIT- FUSHË E SKËNDERBEUT

Ish presidenti Alfred Moisiu tha në fjalën e tij përshëndetëse se nuk mund të rrija pa ardhur në këtë event të rëndësishëm, pasi kam respekt për banorët e kësaj zone, që spikasin për vlerat e tyre atdhetare.

Adem Bunguri, arkeologu i njohur dibran, tha se kujtimi i një figure të tillë epokale që nderohet në të gjithë botën, ku vijon të studiohet në shkollat ushtarake të kohës për artin ushtarak të strategut Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Në planin arkeologjik mund tju them se në këtë fushë Skënderbeu zhvilloi dy beteja të rëndësishme brënda një viti..Mbi bazën e zbulimeve dhe studimeve në fushën e arkeologjisë, hedhin dritë se rrugëtimi Gryka e Radikës, Ura e Qytetit-Qafa e Buallit Bulqizë, ka qenë nga më të frekuentuarat në betejat e mësymjeve të hordhive osmane për të pushtuar vendin tonë, ku për 25 vite me radhë u ndaluan nga Skënderbeu.

Aq e lidhur është Fusha e Vajkalit me Skënderbeun sa as sot që kanë kaluar vite e shekuj, ajo ende vijon të emërtohet nga banorët me toponimin kuptimplotë "Gurët e Skënderbeut". Është emërtuar kështu pasi mban mbi shpinë ende gurët që ushtria e Skënderbeut rrokullisi muar me rrokullisje gurësh, pasi në të dyja anët e saj rrethohet me shpate të pjerrta malesh. Gurët edhe pse të heshtur, flasin dhe tregojnë mjaft me madhështinë e tyre në këtë fushë, ku bëjnë që historia e saj të mos harrohet kurrë.

Dhe me të vërtetë vajkalorët kurrë nuk e harruan këtë fushë. Kështu në këto vite të demokracisë, fillimisht fisi Tançi dhe më pas të i gjithë Vajkali nisën që mbi gurët e fushës të valvisin flamurin kombëtar në përkujtim të betejave të Skënderbeut. Kështu për cdo 17 janar në një nga shkëmbejtë e kësaj zone ata ngrinin flamurin kombëtar. Ky rit erdhi dhe u bë i përvitshëm, deri sa lindi ideja e ngritjes së një përmendoreje të Heroit në këtë fushë.

PËRURIMI I PËRMENDORES SË SKËNDERBEUT

Fusha e Vajkalit, e ndodhur fare pranë qytetit të Bulqizës vetëm rreth 1 kilometër larg tij në dalje drejt Peshkopisë, është e zbukuruar e hijeshuar si kurrë ndonjëherë. Qindra pjesmarrës nga Bulqiza e zonat përreth, por edhe nga Dibra, Mati, Tirana, Kosova e Maqedonia, kanë ardhur të marrin pjesë në përurimin e vendosjes së përmendores së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Mes ovacionesh, këngësh e vallesh, ish presidenti Alfred Moisiu dhe kryebashkiaku Melaim Damzi, kanë zbuluar përmendoren e Heroit, me urimin "ta gëzoni dhe trashëgoni në jetë të jetëve këtë përmendore, ju vajkalorët dhe populli i Bulqizës, pasi e meritoni plotësisht atë".



ALFRED MOISIU, ISH-PRESIDENTI I REPUBLIKËS:

Ngjarje shumë e rëndësishme për zonën dhe gjithë shqiptarët. Skënderbeu na bën krenar. Vendosja e bustit të Heroit, padyshim që rrit krenarinë e zonës, të rinjve, por është edhe objektt turistik. Në këtë fushë janë zhvilluar dy beteja shumë të rëndësishme të cilat kanë demostruar jo vetëm fuqinë e trimërinë e shqiptarëve, por edhe zgjuarsinë dhe strategjinë ushtarake të Skënderbeut. Pavarësisht ndryshimeve që sjell koha, terreni nuk ka ndryshuar, por ka qenë dhe mbetet mjaft i përshtatshëm për tu shfrytëzuar për të future në kurth osmanët, gjë të cilën Skënderbeu e dinte dhe e përdorte më mirë se askush.

ASLLAN ZEMANI, DREJTORI I MUZEUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Falenderoj gjithë bulqizakët që kontribuan dhe e bënë qytetar nderi Skënderbeun, i cili do kujtohet gjithmonë me vendosjen e këtij busti. Strategjia ushtarake e Skënderbeut njihet e studiohet ne të gjitha akademitë ushtarake si ata lindore dhe ata perendimore. Pikërisht këtu u përdor strategjia e futjes në kurth të ushtrisë gjermane gjë që e favorizonte mjaft mirë ky terren. Me dy betejat e Vajkalit Skënderbeu ka pasuruar artin ushtarak me artileri shkëmbore. Vendosja e bustit në vendin ku ka luftuar heroi është gjetja e duhur.

SHAHIN LEKA, HISTORIAN, ISH SHEFI I KATEDRËS SË HISTORISË USHTARAKE, NË AKADEMINË USHTARAKE

Skënderbeu është heroi ynë kombëtar dhe ka zhvilluar një seri betejash, por dy betejat e Vajkalit zënë një vend të rëndësishëm në historinë e luftrave të tij. Zhvillimi I këtyre betejave në vitin 1465, kur Sulltan Mehmeti II ndrroi strategjinë dhe tentonte që ti përgjigjej Skënderbeut pak a shumë me një natyre të strategjisë së tij, nëpërmjet luftës në prita me goditje të befaishme. Skënderbeu me organizimin e një zbulimi strategjik, të cilin e kishte mësuar që në Stamboll, siguroi të dhëna të mjaftueshme për mësymjen osmane dhe bëri që me mjeshtrinë e tij ushtarake, bëri që të fitojë dy betejat ushtarake të Vajkalit, atë të prillit dhe gushtit 1465.

PROF. BUJAR KAPEXHIU ARTIST, REGJISOR.

Kënaqësi që mora pjesë në përurimin e një monumenti të madh të një njeriu shumë të madh. Vepër e bukur e bërë me shumë profesionalizëm, ku gjej rastin të falenderoj jo vetëm skulptorin, por edhe sponsorët e Bulqizës. Përmendorja e vënë në këtë vend është shumë e gjetur pasi duket se kur kanë kaluar në këtë zonë, Skënderbeu me ushtarët e tij kanë hedhur gurë, me mesazhin se kush pushtues do kalojë kësaj lugune do ti hidhen gurët…

SKËNDER CALA - MJESHTËR I MADH, ARTIST, REGJISOR

U kënaqëm ndjeva emocion si 40 vite më parë kur kam vënë në skenë shfaqjen e Skënderbeut në Peshkopi, po ata emocione përjetova edhe sot në Vajkal. Një ceremoni shumë e bukur, organizim shumë i bukur.

AVNI KAMISHI, BANOR I ZONËS

U kënaqa sot, u gëzova, u lumturova. Kjo na bashkon të gjithëve bashkë, duke na bërë krenar për të kaluarën e Vajkalit. Dëshiroj me këtë rast ti çoj një mesazh qeverisë aktuale asaj që ishte dhe kësaj që do vijë që të kthejë vëmendjen edhe këtej nga Rruga e Arbërit, pasi i ka vlerat për tu ndërtuar dhe duhet gjetur mënyra e mundësi financiare për tu ndërtuar, që edhe zona jonë dhe gjithë Bulqiza e Dibra të marrin zhvillimin e duhur.

ASLLAN DAXHA, NJË NGA NISMËTARËT E PROJEKTIT.

Vendosja e memorialit të Skënderbeut në këtë fushë, pra jo vetëm në parqe e lulishte, më duket një project ambicioz realizuar nga djali i Bulqizës, Edmond Balja, me mbështetjen e biznesmenëve të zonës, kjo u bë e mundur. Ta gëzojë Vajkali, ta gëzojë Bulqiza, ta gëzojë Shqipëria memorialin e Skënderbeut. Këtij vendi i ka munguar një symbol i tillë i luftrave të Heroit tonë Kombatar, ne e sollëm atë në këtë fushën e betejës. Dhe sot më duket se edhe gurët thonë jemi gurët e Skënderbeut.

Kujtime
të fshatit tim



Kafe në Athinë me një zdojanak të ri

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Zdojani është vendlindja ime.
E saktë!
Ndokush do të më kujtojë Brezhdanin si vendlindja ime.
E saktë!
Në regjistrin themelor të gjendjes civile të Brezhdanit më shkruan prindërit më 11 maj 1941, plot 62 ditë pas daljes në jetë.
Kohë lufte...
Brezhdani ka qenë që herët katundi më i madh dhe më i populluar i Dibrës. Treqind shtëpi numëroheshin.
U nda në dy katunde, në Brezhdan dhe Zdojan përmes një vije ndarëse hequr nga lindja në perëndim.
Ashikët, lagjja e parëkur hynë në katund nga Peshkopia, mbeti me Zdojanit, emër i lashtë i lidhur me një lagje, me toponiminë e një kishe, me një përrua e me disa burime uji të gjallë.
Zdojani do ti jepte emër një plantacioni me mollë, "Sektori i Zdojanit", me qendrën administrative të ekonomisë së bashkuar, shtëpinë e kulturës, centralin telefonik, shkollën tetëvjeçare që u shndërrua në shkollë të mesme, shtëpinë e kulturës, qendrën shëndetësore, maternitetin, klubin, njësinë tregtare...
Në vitin 1989 Brezhdani kishte 1487 banorë mbledhur në 296 familje kurse Zdojani kishte 1712 banorë mbledhur në 326 familje
Të dy bashkë kishin 3199 banorë mbledhur në 622 familje.
Mbase nuk duhet të ndaheshin, por i ndanë për të mos mundur me i ndarë asnjëherë në të folmen e përditshme, sepse edhe mua edhe të gjithëve na ka pëlqyer dhe na pëlqen të themi "Jam prej Brezhdani"...
Më mungon vendlindja, vendi ku kam kujtimet më të bukura të fëmijërisë time, vendi ku kam trojet e mija, ku kam nënë e babë, tash pranë e pranë poshtë mermerit të bardhë në përtej jetë...
Është kjo nostalgji për vendlindjen time që sa herë më fton dikush në bisedë online i përgjigjem, sa herë dikush më fton në takim shkrihem si sheqeri në kafe e udhëtoj me Të atyre rrugëve me pluhur në verë e me baltë në dimër në kërkim të të gjallëve e të vdekurve në mallin e dashurinë për ta.
Kjo më ndodhi do ditë më parë e nuk mundem pa e shkruar për tu çliruar shpirtërisht nga malli duke i hedhë "një grusht ujë Drini" që në vend që ta shuaj, e këndell më shumë...
Doshi, më tha se e quajnë në një komunikim në efir. Lavdosh e kishte emrin e plotë. Më tha se ishte djali i Him Sefullait dhe se banonte në një lagje të Athinës. Dëshironte që të më takonte për të përcjellë një porosi nga babai i tij. I dhashë numrin e telefonit, adresën dhe trolein 11 që e sillte drejt e tek lagjja ime.
U gëzova për shokun tim të fëmijërisë e të katër klasave të shkollës fillore, për Himin, emrin tonë të dytë që na thërrisnin të gjithë, në shkurtim të emrit Abdurahim...
Udhëtova vetëm nëpër Brezhdan-Zdojan për të udhëtuar një mbrëmje vetë i dytë me Doshin e me kujtimet që bashkoheshin tek njerëz që në kujtesën time ishin të gjallë.
Nuk mund ta heq nga mendja atë kryqëzim rrugësh nga lindja në perëndim e nga jugu në veri që mblidhet nyje pikërisht tek dera e madhe e avllisë me dy sofra anash e Himit për tu ndarë teposhtës drejt Gjeceve, Vojkeve, Degjoneve, Skureve..., rrafshës me shtëpinë e AisheHajrullait, simbol i qëndresës dhe trimërisë së gruas dhe familjes dibrane, Tonuzeve me histori të lashtë e bëmash ndër shekuj, Gjizeve..., djathtas tek Kaliset e pas shpine Sefullajt e Tuket.
Nuk mund të lë pa përmendur edhe Zhuzhet e Brezhdanit ku u rrita nën kujdesin e gjyshes time Aishes e me të u ula mbrëmjeve në të gjitha odat e asaj lagjeje që kishte një emër që nuk lidhej me emrat e asnjë fisi, Lagja Rrahmane...
Nuk di në se ka odë të asaj lagjeje që nuk kam hy e jam ulur e pirë një gotë me dhallë.
Aishe Hajrullai e kishte shtëpinë në kënd të kryqëzimit. Një shtëpi në dy pode me një pemëtore prapa e një tjetër përballë, në anën tjetër të rrugës. E kishte piketuar dhe mbjellë më kultivarët më të mirë të pemëve frutore të kohës i biri, Mehmet Hajrullai, një ikonë e madhe e pemëtarisë dibrane. Halla Aishe, siç i thërrisnin, jetonte në përdhesen e shtëpisë. Sipër, me dalje nga rruga, vite më vonë do të ishte dyqani i fshatit.
Tonuzet, siç thashë më përpara ishin më të njohur e të fismë. Më vjen mend Elezi me të shoqen, një grua që erdhi nga larg për tu bërë simbol i emancipimit të gruas në fshat. Me kërshëri kush kalonte rrugës për në kishën e Rrahmane shihte miskat siç u thoshim gjelave të detit, ngrehjen e tyre tek gurgullonin, diçka e rrallë jo për fshatin por edhe për krahinën...
Me Tonuzet më lidhte edhe gjaku i hedhur në gotë uji dhe i pirë nga nëna ime Defe Zhuzhi dhe Sheme Tonuzi që në jetë do të merrnin mbiemrin Ashiku dhe Shehu. Me Shemen do të lidhesha vite më vonë kur do të krijoja familje e do të pija kafe me të shoqin, Babë Shehun, Myslimin e tre djemtë: Uken, Astritin dhe Flamurin dhe vajzën Dozen, gjak i fëmijëve të mi.
Motër nëna ime ishte edhe me RabieTrukën Selxhaferrin që gjithë jetën i kemi thirrë teze e që nuk u ndanë kurrë me njëra tjetrën si ti kishte bërë një nënë e një baba.
Tek Tonuzet kam pas një shok, Hamdiun, një njeri ikja e të cilit më ka dhembur si të ikte një ndër katër vëllezërit e mi.
Ramazanin e kam në një fotografi me traktorin e tij me të cilin lëvroi tokat kudo nëpër Dibër.
Ismetin e kujtoj me mall në takimet në fshat dhe si dajë në dasmat e tre nipërve dhe të mbesës në familjen Shehu në Peshkopi...
Nuk e di se nga erdhën e u ngulën në Brezhdan Kaliset. Njoha ndërta Rexhepin në shtëpinë e të cilit hyri nuse e u trashëgua një kushërirë imja nga fisi i Ndregjoneve, Xhilisfia E kam njohur si njeriun më punëtor e të ndershëm që e kalonte kufirin e fshatit. Një pamje punëtori dhe njeriu familjar kishte edhe i vëllai,Zeqiri...
Por ai që më ka mbetur në kujtesë e nuk e harroj është Elmazi, Elmaz Kalisi. Kishte lindur sakat Elmazi, sakat në gjymtyrët e poshtme, por atë që ia kishte marrë natyra poshtë ia kishte dhënë me bollëk lart: mençurinë, humorin, aftësinë e aktrimit. Dhe po qe se do të ndiqte shkollën ai do të ishte një aktor i shkëlqyer deri në Teatrin Popullor.
Isha në një klasë me Elmazin. Më kujtohet njëherë kur erdhi në klasë me një palë pantallona në dy krahët e të cilëve kishte dy xhepa të mëdhenj, xhepa në të cilët kishte futur librat dhe fletoret, ato pak libra e mjete mësimore që atë kohë kishim e që zëvendësuan pllakën e gurtë ku bënim detyrat e drejtshkrimit dhe të aritmetikës që i shuanim me një topth lecke sapo merrnim notën nga mësuesi. Atë ditë çantat tona prej bezeje me rryp varur përqafe na u dukën të rënda.
Sa e sa herë me Himin, babanë e Doshit, kishim shtyrë derën e avllisë dhe ishim ulur në odën poshtë të kullës e kishim bërë detyrat. Më vijnë në këtë moment fytyrat bujare të babait dhe të nënës por nuk më vijnë emrat. Sak më ngjan se i thërrisnin babait të tij e Shahin të vëllait.
Nuk më rrihet pa e zgjat rrugën e u ndalë tek Gjizet, pa e sjellë në kujtesë portretin e të parit traktorist e të parit elektricist të fshatit, Rakipit.
Në vjeshtë të vitit 1955 Brezhdan- Zdojani mori në çdo shtëpi dritë elektrike, një rrymë 110 voltësh që vuri në garë tërë fshatin se kush do të fuste në shtëpi radion më të madhe e më të bukur. Uji për furnizimin e hidrocentralit kaloi mes përmes trojeve të babait tim, u grumbullua në një auz në krye të vreshtit dhe zbriti me forcë për të vënë në lëvizje turbinën e për ta kthyer forcën fizike në rrymë elektrike. Centralist ishte Rakipi e më vonë RufatPrençi për ta mbyllë RustemGjeci me elektrifikimin e plotë të vendit...
Familje e madhe ajo që vinte pas një porte avllie e Sefullave, e Qamilit, Xhavitit, Islamit, Budinit e të tjerëve që tash nuk më vijnë në kujtesë. Poshtë shtëpisë së madhe me qerpiç për shumë vite, që në kohën e triskëtimit dhe reciprokut ishte dyqani i fshatit, i pari dyqan shtetëror ku gjeje produkte ushqimorë, veshmbathje, kinkalerie, misër, grurë, fasule, vezë e prodhime të tjera të fshatit në këmbim të produkteve industriale.
Islam Sefullajn e kam pas shokun më të mirë në udhëtimet drejt Peshkopisë në shtatëvjeçare. Asokohe (fillimvitet '50-të) megjithëse Brezhdani ishte fshat shumë i madh, me gishta numëroheshin ata fëmijëqë pasi mbaronin filloren udhëtonin për në Peshkopi më se dy orë vajtje e ardhje për të vazhduar shkollën. Para meje ishte AbdullaHakorja të cilin pasi mbaroi klasën e 6-të e morën në arsim, profesion që u bë pjesë e jetës së tij. Islami dhe unë ishim brezi i dytë i atyre që vazhduam shtatëvjeçaren. Pas nesh erdhën NexhmedinHidri, BasriHakorja, EqeremHakorja, MersimSopoti për të vijuar më tej të tjerë...
Tre të fundit do të vazhdonin pedagogjiken e do të ishin një jetë të tërë mësues kurse Nexhmedini të mesmen do ta mbaronte natën për tu bërë normist në sektorin e Zdojanit të Ndërmarrjes Bujqësore të Dibrës. Nexha iku shpejt pa iu gëzuar fëmijëve, iku duke më lënë një brengë që nuk më shqitet nga mendja. Basriu e di që jeton me fëmijët në Itali kurse ikjen e Mersimit e përjetova me dhimbje të madhe. E kisha shok fëminie, komshi 20 metra larg shtëpie, bashkudhëtarë drejt Drinit ku me dy kunguj ujëz lidhur për brezi hymë e mësuam notin tallazeve të Drinit.
Me Islamin na binte rruga gjithnjë së bashku. E prisja tek mulliri i Dikës dhe vazhdonim rrugën në një debat mësimor veçanërisht në matematikë, lëndë që ishte dashuri e jetës së tij. Në vitet e mëvonshme e takoja shpesh në SMT ku ai ishte mjeshtër i pazëvendësueshëm i riparimit të makinave shirëse dhe autokombajnave...
Me Munirin (Sefullaj) ndër të tjera ishim kufitar në zabelet e gështenjave, zabel që ai e administroi si nip i Hakës derisa u bashkua në kooperativë bujqësore. Një njeri korrekt në punë, veçanërisht në administrimin e blegtorisë në sektorin e grumbullimit në Çap të Brezhdanit. I vëllai ishte shofer, një ndër më të mirët e parkut të mallrave të Peshkopisë. Tuket ishin në krye të lagjes Rahmane. Kishin një shtëpi të gjatë pjesa e poshtme e së cilës ishte gati në tre poda ku banonte familja e Rremës kurse pjesa e sipërme ishte në dy poda ku banonte familja e Abdylit. Simin nga rridhnin e mbaj mend ashtu të kërrusur nga pleqëria.
Tek varrezat, fare pranë shtëpive të tyre kam parë e prekur tuba qeramike. Thuhej se ata ishin pjesë e një ujësjellësi që merrte ujin e Sulnarit për tërë lagjen. Mes përmes zabelit të gështenjave të familjes sime, fare pranë burimit, kam parë vijën e një kanali që vazhdonte. Nuk e di në se janë bërë kërkime arkeologjike për të hedhë më shumë dritë mbi kohën e ndërtimit të ujësjellësit.
Shokë klase kisha Hamzën. Gjuriu apo sic e thërrisnin me tjetër emër, Besniku, ishte polic për shumë kohë, derisa doli në pension.
Më poshtë, me pamje që shihte tërë Brezhdanit ishte kulla e babait të Metit që më ka dalë nga kujtesa si emër por jo si figurë, në kufi me Gjecet.
Një rrugë e ngushtë këmbësore me shkallasijë zbriste poshtë për në Mëhallë të Poshtme, rrugë të cilën e kam bërë disa qindra herë për të zbritur në trojet e hallës time NaileGjeci e tek fisi i madh i Gjeceve.
Nga Gjecet dua të veçoj Ramazan Gjecin, doktorin që megjithëse me shkollë të mesme, nga përvoja e gjatë në shërbim të të sëmurëve në luginën e Drinit të Zi, kryesish, u jepte ujë në shpinë të lugës mjekëve me universitet. Mund të përmend edhe të tjerë, Sinanin, shokë klase në fillore që me një këmbëngulje të jashtëzakonshme arriti të mbarojë shtatëvjeçaren, të mesmen dhe të bëhej avokat. E takova disa muaj më parë në Përmet dhe u gëzova që ishte po ai Sinan i gjallë dhe plot respekt.Shukriun, Hazizin, Rrahimin, XhevatGjecin që vihesh "pendë" me Mentor Karasanit se kush ia kalonte shoqit në punë...
Harrova Zyberin, Zyber Priftin që nuk e di pse kishte këtë mbiemër kur ishte i vetëm mes fisit të Gjize. Zyberi ishte nga ata njerëz që çfarë i shihte syu ia bënte dora. Zyberi ishte i pari dentist në fshat. Dentist në një kohë kur në tërë Dibrën a kishte apo s'kishte një të vetëm në Peshkopi. Kishte një palë darë dhe ua shkulte njerëzve dhëmbët pa narkozë e pa dezinfektantë. Kujt i dhimbe dhëmballa kujtonte Zyberin...
Ne fëmijët e kishim frikë...
Harrova? E si të mos harroj. Fytyrat e fiksuara në fëmijëri më vijnë e më ulen përkarshi. Emrat nuk më vijnë.
Disa m'i kujton Doshi.
Disa po i kujtoj tash që po shkruaj.
Disa do të mi kujtojnë ata që do të lexojnë këto rreshta.
Duke më korrigjuar e duke shtuar.
Më vjen keq se jeta më largoi dhunshëm nga vendlindja, nga Brezhdan-Zdojani im. Do të desha që të ulesha mes fshatit e të shkruaja një fletë të gjerë për ata njerëz dhe për ata vende që malli më vjen në grykë e nuk e kapërdij dot.
Të faleminderit Doshi, djali i shokut tim të fëmijërisë Abdurahim Sefullaj që erdhe dhe më hodhe një kovë me ujë nga "Kroi i Vokës" mbi prushin e këndellur të mallit dhe dashurisë sime për vendlindjen.
Të faleminderit Adash që ma dërgove djalin. Kafe më të shijshme nuk kam pirë ndonjëherë, larg, me ty dhe të tjerë.

Athinë 30 maj 2017





guidë

Vlerësim maksimal për natyrën, kulturën, punën dhe respektin ndaj mikut

Në **Korab** me ambasadorin e **Zvicrës**



Nga **GREHANS UKA***

Ardiola, nga Shoqata Kombëtare për Udhërrëfyesit Turistik Shqiptar (National Association of Tourist Guides of Albania - NATGA), më njofton se ambasadori zviceran Dr.Christoph Graph dhe e shoqja Nicola kishin planifikuar një vizitë turistike jozyrtare në Dibër në datat 13 dhe 14 maj 2017. Duhej të përgatitej një axhendë turistike për në Korab dhe në burimet e ujërave termale të Dibrës. Rolin e guidës do ta kryeja unë, pasi axhenda u aprovua.

Ambasadori mbërrin në Peshkopi dhe u akomodua në një nga hotelet e qytetit. Pas takimit biseduam për planin e së shtunës, pra, të datës 13 maj në detaje. Pastaj zhvilluam një bisedë miqësore rreth historisë, kulturës dhe natyrës se Dibrës. Sipas axhendës të nesërmen do të realizonim ngjitjen drejt Korabit, pavarësisht kohës dhe kushteve klimaterike që ishin. Ambasadori pranoi me kënaqësi që grupit tonë prej 3 vetash për në Korab, t'i bashkëngjitej edhe Almario.

Nga Peshkopia u nisëm në orën 07.00 dhe në fshatin Radomirë arritëm rreth orës 08.00 Fillojmë përgatitjen për ngjitje drejt Korabit. Vendi i nisjes shënonte 1260 metra mbi nivelin e detit.

Shumëllojshmëria e bimësisë me shkurre, pishave dhe gurëve që janë karakteristike për zonën, na shoqërojnë gjatë gjithë rrugës. Gjithashtu, përrenj të shumtë dhe të vegjël, ku uji ishte i bollshëm e i rrëmbyeshëm të relaksojnë me zhurmat e tyre. Për këtë na u desh disa herë të gjenim pika të përrenjve që ishin lehtësisht të kalueshme. Në horizont duket porta hyrëse e Korabit. Nga larg të jep idenë që aty gjithçka fillon të krijohet një ngushticë që do të na shoqërojë gjatë ecjes. Këtë përshtypje pashë edhe te ky grup, siç e kam parë edhe te grupet e tjera që kam shoqëruar për në malin e Korabit.

Kur afrohemi te portat e Korabit, që është dhe pika ndarëse mes Fushës së Korabit dhe pjesës së fshatit, para na shfaqet peizazhi mahnitës i kësaj fushe. Kjo pamje është mahnitëse për të gjithë vizitorët për në malin e Korabit. Gjithashtu, pamja natyrale e shkëmbinjve me ngjyrën gri në të bardhë të krijonin idenë e portave hyrëse. Stanet për bagëtinë janë të punuara me gurë dhe ndërthurnin grinë me kaltërsinë e qiellit dhe me ngjyrat e tjera të luleve rreth e rrotull. Gjatë ecjes takuam Azemin, djalin 13- vjeçar, banor i zonës. Ai na tregoi se bashkë me shokët po mblidhnin lulegishtin dhe bimë të tjera për t'i shitur në pikën e grumbullimit të bimëve medicinale për t'u përpunuar më tej.

Çdo moment i ecjes drejt Fushës së Korabit për në majë krijoi mbresa për grupin që e vizitonte për herë të parë. Impresionet sa vinin e shtoheshin, sepse pavarësisht ngjitjes në fushat rrëzë majës së Korabit në lartësinë 2000-2500 metra mbi nivelin e detit, dukej sikur gjithmonë po i afroheshim qiellit. Duke u rrethuar nga maja e Korabit dhe majat e tjera rreth e rrotull, liqenet akullnajorë, lulet e para të sapoçela në ato lartësi dhe bora që kishte mbuluar gjithçka në lartësinë mbi 2500 m të krijonin ndjesi vërtetë të mahnitshme, që edhe unë më parë nuk i kisha përjetuar. Pas ndalesave të shkurtra dhe marrjes së impresioneve nga secili, bisedonim me grupin për natyrën, bimësinë dhe historinë e zonës.

Gjatë kthimit për në fshat një ndalesë e realizuam pranë Ujëvarës së Korabit, ku të gjithë ujërat vinin nga burime të ndryshme nëntokësore, liqenet rreth e rrotull si dhe bora që po shkrihej. Peizazhi i bukur pranë liqeneve na nxitnin për të bërë disa fotografi. Rreth orës16.20 arrijmë në fshat tek bujtina e Haxhi Himës. Gjatë një pushimi të shkurtër te bujtina, ambasadori u njoh me ekonominë e zonës, kulturën dhe mënyrën e jetesës nga biseda me Haxhiun. Tjetër element që la përshtypje tek ambasadori ishte ndërtimtaria e shtëpive në unison me përdorimin e gurëve që gjendeshin me shumicë te kjo zonë; pa lënë mënjanë pishat, të cilat ishin ruajtur dhe krijonin një pyll fantastik.

Të dielën, me datën 14 maj ambasadori, pasi bëri një shëtitje në bulevardin kryesor dhe pa pazarin (tregun fshatar), shprehu opinion të mirë nga vizita në Dibër. Vlerësoi maksimalisht natyrën në tërësi; vlerësoi kulturën dhe dashurinë që ofronin njerëzit, sidomos respektin ndaj mikut, e mbi të gjitha vlerësoi ndjenjën për punën. Por në opinionet e tij, mendonte që qeveria qendrore duhej të investonte në infrastrukturën nacionale që t'i japë zhvillim kësaj zone, siç është "Rruga e Arbërit". Ndërsa qeveria lokale, në bashkëpunim me atë qendrore, duhet të krijojnë mundësi që të rinjtë të krijojnë mundësi punësimi në Dibër, sepse sektori i turizmit është mjaft potencial në këtë drejtim. Sipas tij të rinjtë këtu mund të punësohen nëpërmjet granteve për mirëmbajtjen e rrugëve turistike e deri te guidat lokale.

Qeveria qendrore duhej të investonte në infrastrukturën nacionale që t'i japë zhvillim kësaj zone, siç është "Rruga e Arbërit". Ndërsa qeveria lokale, në bashkëpunim me atë qendrore, duhet të krijojnë mundësi që të rinjtë të krijojnë mundësi punësimi në Dibër, sepse sektori i turizmit është mjaft potencial.



Foto © Grehans Uka

Kontaktet e guiderit: Grehans Uka
Email: udhetomegresin@gmail.com
Telefon: (+355) 0673625835
(What's app & Viber)





Nuk është ai prodhim që shpresonim", - sikur fsheh një keqardhje brenda në shpirt.
- Duhej të kisha marrë mbi pesë ton dhe duhet të kënaqem me një të pestën e kësaj shume".

Familja Topuzi, aty ku me punë ndërtohet e ardhmja

Nga **OSMAN XHILI**



Kur nisesh nga Maqëllara, për të shkuar për në Peshkopi, aty në të majtë, në vendin e quajtur Qenok, majë një kodrine të bukur, ngrihet një vilë. Jo shumë e madhe nga përmasat, por me njerëz punëtorë, bujarë e mikpritës, të zgjuar e inteligjentë. Bedri Topuzi, nga fshati Trepçë, një burrë truplidhur, energjik dhe me një palë mustaqe të vogla, që i hijeshojnë fytyrën, e ka shumë të limituar kohën. E takojmë në bllokun e qershive, të mbjellur bukur nëpër brezare, duke vjelur prodhimin e ri.

"Nuk është ai prodhim që shpresonim", - sikur fsheh një keqardhje brenda në shpirt. - Duhej të kisha marrë mbi pesë ton dhe duhet të kënaqem me një të pestën e kësaj shume". Dëmtime të ndjeshme pata dhe në arra, mollë, dardhë, pra në të gjitha kulturat drufrutore. Por Bedriu nuk është nga ata që e pranojnë humbjen kollaj. Ashtu si një sportist i mirë që synon dhe nuk ndalet për të marrë titullin, deri në arritjen e qëllimit.

Shpesh gjërat rrjedhin në një rrugë të shtruar që më parë, në një traditë të hershme, diçka e ngjizur në genet e familjes, apo fisit. Gjyshi i tij, Ademi, shquhej në fshat si një fermer dhe blektor i mirë. Familja e tij vazhdimisht i mbante tre katër lopë, një kalë dhe një ka, që e zinte në parmendë me kushëririn e tij, saherë që duheshin kryer punimet e pranverës, apo vjeshtës. Një tufë mikse me dhen e dhi mbushnin oborrin e shtëpisë me zilkat plot nuanca melodie në mëngjes dhe në darkë, kur ktheheshin të ngopura nga kullota e bollshme e malit. Ndërroi jetë diku nga vitet nëntëdhjetë, duke i lënë familjes bereqetin e punës, që s'do të kishte të sosur. Tush Topuzi, djali i tij i ngriti më lartë vlerat e punës dhe inteligjencës, kurse nipi, Bedriu, synon lartësi akoma më të mëdha.

FERMA E LOPËVE

E përmendëm që familja e tyre ka pasur vazhdimisht tre katër lopë me vlera të mira rracore. Pas viteve 2000 kjo shifër do të rritej mbi pesë, kurse sot Bedriu mbarështon dhjetë krerë lopë të rracave Holenshtjn dhe Taranteze të kuqe.

"- Nuk do të heqim dorë nga këto dy rraca, - thotë djali i tij Admiri, që ndonëse ka mbaruar për gjuhë të huaja, është i dashuruar marrëzisht me fermën që kanë ngritur. - Rraca e para, - vazhdon shpjegimin e tij Admiri, ka sasi dhe cilësi, kurse Tarantezja ka shumë rezistencë dhe një qumësht të pasur me yndyrë". Në periudhën e verës lopët shfrytëzojnë terrenin e bollshëm rreth shtëpisë, të rrethuar me tel dhe me lera të vogla, ku mund të pinë ujë sa herë që dëshirojnë. Nuk kanë bari dhe në darkë kthehen vetë në stallë të ngopura, por gjithsesi për tu plotësuar dhe me një vakt koncentrati prej pesë kilogram secila. Stalla është e freskët, e sistemuar mirë, e pajisur me makinë mjelëse dhe një mulli me çekiç, për të bluar koncentratin.

Bedriu ka punuar mbi dhjetë vite në strukturat e policisë së shtetit. Ka mbaruar shkollën e mesme për agronomi dhe gati deri në përfundim fakultetin për gjeografi në Shkodër. Nuk e finalizoi për disa arsye dhe sot nuk ndihet aspak i penduar. Ai tregon se mbi 70 përqind të bazës ushqimore, sidomos të dimrit e prodhon vetë. Ka të mbjellë mbi një hektar misër dhe shtatë dynym tërshërë. Kur korret ajo, bëhet gati toka për misër hamullor, apo misër 86 ditësh, që do të thotë se mund të arrijë dhe pjekjen normale. Bari i shumtë i pemtores është një tjetër mundësi për të rritur rezervat ushqimore. Ferma e tyre prodhon mesatarisht 80 litra qumësht në ditë, që e ka të shitur plotësisht. 60 litra i dërgon në baxhon e qytetit, kurse njëzetë të tjera i dërgon në një pikë shitje në Bulqizë. Ka mbi dhjetë vjet që funksionon një kontratë e tillë, si një tregues i cilësisë së qumështit, i pastërtisë së tij, i seriozitetit. Është kjo kontratë e thjeshtë, një shembull dhe një model se si duhet të operojnë bizneset bujqësore dhe blektorale në ekonominë e tregut, aq shumë të pasigurtë.

Mbi një milion lekë të ardhura hyjnë në buxhetin e kësaj familje për çdo muaj. Normalisht dhe viçat janë një tjetër vlerë e shtuar. Zakonisht ata i dërgon në thertoret e qytetit, pas 6 – 7 muajsh, me një peshë mbi 300 kilogram peshë të gjallë. Kështu, të dy palët ngelen të kënaqura. Lopët me trajtimin që u bëhet dhe fermeri me të ardhurat që përfiton. Kjo është një nga arsyet përse Admiri që ka mbaruar shkollimin e lartë i qëndron aq pranë fermës dhe është i dashuruar me të. Po të shtosh pavarësinë e veprimit, menaxhimin e kohës, kënaqësitë materiale e shpirtërore që të jep një biznes i tillë, atëherë zgjedhja e djalit të ri duket vërtetë e pëlqyeshme. Ai ka vendosur të ndërtojë këtu të ardhmen, duke qenë pjesë e atyre që duan të ndërtojnë këtë vend e këtë komb. Me siguri, Zoti do ta bekojë e do ta mbështesë në punën dhe përpjekjet e tij.

PEMTARIA

Familja Topuzi bashkë me tokën që mori pas viteve nëntëdhjetë, trashëgoi dhe një sasi pemësh të vjetra, të mbjella nga N.B. ja e dikurshme. Për pak kohë u kujdesën për to, por ndihej e nevojshme një sipërmarrje e re, të cilën nuk vonuan dhe nuk hezituan ta bëjnë. Pas viteve 2000, e sidomos me futjen e skemave të subvencionit nga qeveria shqiptare, familja Topuzi filloi të bëjë një projekt të studiuar për pemëtoren e re.

U fillua me kumbull e mollë, që tradicionalisht ishin kultivuar në atë zonë. Më pas qershia, dardha, arra e të tjera kultura, sikur i dhanë një kolorit, peizazhit bosh e monoton. Të dy vëllezërit, Bedriu dhe Arturi, mbollën gjithsej mbi tre hektarë pemtore. Bedriu përpiqet që tu shërbejë maksimalisht pemëve, si të thuash, ti detyrojë ato të prodhojnë. Në 100 rrënjë të bllokut të qershive, ai dërgoi dhjetë traktora me pleh organik, të kalbur mirë. Traktori gjerman i markës "Huliman", ka gati 20 vite që i shërben fermës me punime dhe transporte të ndryshme dhe prapë nuk jep shenja lodhje. Po Bedriu do tu paraprijë gjërave dhe po aplikon te fondacioni "Sared " për një traktor të ri, të fuqishëm, të pajisur me të gjitha agregatet e duhura. 200 rrënjë arra janë në vitin e gjashtë të prodhimit. Themi si me shaka, se kur të rriten dhe pak, këto pemë do të japin rreth një kuintal secila. Shumëzimet bëhen lehtë duke na dhënë një shifër prej mbi 50 milion% lekë të ardhura. E gjitha kjo vetëm nga arra. Në fakt, nuk është as ëndërr dhe as shaka, por një mundësi reale që buron nga puna, pasioni dhe përkushtimi i kësaj familje, që ka vënë forcën dhe shpirtin e saj, në funksion të fermës.

INFERMIERE ANILA

Ajo nuk është tjetër, veçse bashkëshortja e Bedriut. Ajo është bashkëudhëtarja e jetës, nëna e dy fëmijëve të mrekullueshëm dhe krahu i tij i djathtë. Ka mbi 20 vjet që shërben si infermiere në fshatin e Trepçës. Sa punë e sa lodhje në këta 20 vite. Sa urgjenca e sa netë të pagjuma. Sa injeksione të kryera e sa serume të vëna, që jo rrallë kanë kthyer në jetë njeriun që lundronte në ujërat e vdekjes. Dhe sa shumë mirënjohje nën këmbim të kësaj pune titanike. Banorët dhe natën e kanë shërbimin e saj, falë dhe Bedriut që është i gatshëm të shërbejë me makinë, duke përfituar që të dy bekimet e njerëzve dhe shpërblimin e Zotit.

Në kohën e lirë Anila sillet si flutur në shtëpi. Ndihmon tek lopët, ndihmon te punimi i pemëve, pastrime dhe gatime për çdo vakt, punë që vetëm amvisat e dinë sa kohë duan. Gjatë gjithë verës e vjeshtës, ajo përpunon dhe konservon frutat dhe perimet për dimër. Miqtë e shumtë të kësaj familje të nderuar mund të shijojnë në çdo kohë turshitë, kompostot, reçelrat, nardenin e famshëm të thanës, hoshafin e kumbullës, pastërmanë e plot asortimente të tjera të këtij lloji. Pak nga pak, këto produkte po kthehen nga forma e konsumit familjar, në një mundësi reale biznesi, pasi pëlqehen mjaft nga konsumatorët. Bedriu tregon një moment nga viti i kaluar, kur një shofer shkodran i kërkoi hoshaf kumbulle.

– Më adresuan tek ti, - tha shkodrani, më dhanë numrin e telefonit. Bedriu i tregoi dy lloje të kumbullave të thata, Tropojane dhe Stanley, me 500 dhe 700 lekë çmimi. Shkodranit i pëlqeu shumë malli dhe nuk nguroi të marrë një sasi prej 10 kilogramësh nga lloji i dytë.

Ka disa kohë që Anila bashkëpunon me disa shoqata dhe organizata si C.N.V.P, Argitra dhe World Vision. Këtë vit fshati i Trepçës, i shquar në mbledhjen e bimëve mjekësore, falë një projekti të përbashkët me këto shoqata, po tenton kultivimin e tyre me sukses. Në oborrin e Anilës janë shkarkuar 4000 fidanë mëllage për mbjellje, në një sipërfaqe prej 600 metër katror. Vendi është bërë gati dhe këto ditë pritet të mbillen fidanat në tokë. Çdo gjë do të jetë bio, vetëm me pleh organik. Nëse do të ketë sukses, sipërfaqet do të shtohen vitin tjetër, akoma më shumë, duke punësuar më shumë njerëz e më shumë familje.

Nuk do të jetë çudi që pas disa vitesh, familja Topuzi të presë turistët e parë. Vetëm pak vizion dhe disa shtëpi prej druri e kashte në territorin e mrekullueshëm, që ata zotërojnë. Të gjitha ato produkte oreksndjellëse që përmendëm, mund tu vihen në dispozicion mysafirëve, pa asnjë vështirësi. Pulat që gjenden në oborrin e shtëpisë, një tufë e vogël qingjash, disa koshere bletësh, do ta bëjnë akoma më mbresëlënës qëndrimin e të huajve aty. Admiri, djali i familjes Topuzi, që ka mbaruar për gjuhët e huaja, mund të komunikojë me to, duke i lehtësuar gjërat akoma më shumë. Po pse themi vetëm të huajt? Dhe ne vendësit kemi nevojë të pushojmë. Le të konsumojmë dhe ne këto produkte aq të shijshme, bujarinë dhe mikpritjen e kësaj familje të nderuar e të respektuar nga të gjithë.





të rinjtë

Të rinjtë, heronjtë e heshtur të Dibrës



Në ujvarën e Pocestit.

Nga **SAMET ZAGRADI**

Të jesh i suksesshëm jo gjithmonë duhet të kesh vëmendjen e të gjithëve apo të jesh i mbuluar nga jehona e punës. Të punosh fort në heshtje, pa bujë, ashtu siç kanë bërë dhe po vazhdojnë të bëjnë të rinjtë e palodhur dibranë, mund të quhet një sukses i dyfishtë.

E kam fjalën për shumë të rinj që prej disa vitesh kanë kontribuar fuqishëm në veprimtari, shërbime, promovim dhe përmirësim të mentalitetit dhe mënyrës së të jetuarit në qytetin e Peshkopisë. Pozita gjeografike, mungesa e infrastrukturës dhe e dëshirës për investime në këtë qytet nuk ka zbehur dëshirën e tyre për të punuar dhe ti dhënë jetë qytetit. Organizata të mëdha zënë vend kryesor në thithjen e resurseve të pashtershme të dëshirës për ndryshim në Dibër. Të rinj të shumtë dhanë kontributin e tyre duke krijuar dhe një organizatë tërësisht dibrane. Më shumë se 100 të rinj në veri të Shqipërisë po punojnë së bashku për të arritur ëndrrat dhe për të ndryshuar në mënyrë pozitive vendin e tyre.

"Changing the future", një togfjalësh i cili të jep idenë e shpresës për një ndryshim të një situate, është emri i organizatës rinore, e cila përmbledh në vetvete të rinjtë e palodhur dhe të pakursyer për të ndryshuar të ardhmen e vendit të tyre. Ata kanë thyer klishetë e këtij brezi me mungesë mundësish duke treguar në komunitetin e tyre energjitë, talentin dhe shpresën.

Krijimi i këtij grupi i kishte fillimet e tij në verën e vitit 2011, ku 11 vullnetarë po punonin me kampet verore të organizuara nga World Vision. Ata ftuan miqtë e tyre për t'iu bashkuar grupit dhe për t'u shërbyer me dashuri këtyre fëmijëve dhe, nëpërmjet tyre, filluan të identifikonin nevojat e komunitetit. Në mënyrë që të mos humbasin interesin për të vepruar në komunitet, ekipi i World Vision i ftoi të rinjtë që të ndërmerrnin iniciativa ku të identifikonin çfarë nevojitet të ndryshohet në komunitetin e tyre, duke përmirësuar dhe kontribuar në jetët e fëmijëve. Të rinjtë u trajnuan mbi aftësimin për jetën, për planifikimin e projektit, mbi parimet bazë të zhvillimit të komunitetit. Grupi u rrit shumë për një kohë të shkurtër dhe ishte e qartë që kërkonin të ishin pjesë e një grupi kuptimplotë që duke fituar eksperiencë, të fitonin punë, gjë e cila ndodhi te shumë të rinj.

Grupi i të rinjve angazhoi aktorët e zonës si biznese lokale, prindër, mësues, drejtorinë rajonale arsimore, qeverisjen lokale dhe anëtarë të komunitetit. Kjo bëri të munduar që të rinjtë të ngrenë zërin dhe të ndërhyjnë në hapjen e dy kopshteve në dy dy zona ku kishte vite që fëmijët nuk kishin një vend ku të mësojnë, fushata të ngritjes së fondeve dhe ndërgjegjësimit, organizimin e kampeve verore me fëmijë duke u dhënë atyre buzëqeshje, dashuri dhe të qeshura pafund.

Organizimi i panaireve me shitjen e produkteve bujqësore dhe grumbullimi i të ardhurave për qëllim human, ndihma periodike e disa familjeve në nevojë e shumë veprimtari pafund, shërbejnë si provë e gjallë që akoma ka të rinj që punojnë fort, dëshirojnë një komunitet ndryshe. Veprimtari të shumta me fëmijët jetim, ato me aftësi ndryshe dhe gjithëpërfshirja e komunitetit rom në jetën shoqërore janë disa nga drejtimet e punës së të rinjve edhe në të ardhmen. Organizimi i grupeve dhe vullnetarëve u rrit ndjeshëm, pothuajse 300 të tillë, por pas mbylljes së universitetit ky numër u përgjysmua.

Disa të rinj e shohin përfshirjen në grupin vullnetar që prej gjashtë viteve qe operon në Dibër si një mundësi për tu argëtuar apo për të parë mundësi të reja. Mund të themi me plotë gojën që të rinjtë e Changing the Future bëjnë një jetë më aktive se pjesa tjetër e të rinjve në Dibër.

Pjesëmarrja dhe njëkohësisht aktivizimi në këto veprimtari i të rinjve dibranë ka shërbyer si një trampolinë për të qenë të suksesshëm dhe në profesionet dhe karrierën e tyre.

Disa të rinj janë punësuar në punë shumë të mira dhe pohojnë që angazhimi në Changing the Future ka ndikuar thelbësisht në formimin e tyre. Falë aftësive që kanë fituar e kanë pasur më të lehtë të fitojnë vendet e punës. Erblini, Ilirjana, Blerina, Bedria, Arturi, Sameti që tashmë punojnë si staf i organizatës ndërkombëtare World Vision flasin me nostalgji për ato vite dhe krenari për atë ç'ka këto të rinj kanë bërë për një zonë që jep pak shpresë, sa Dibra. "Gjatë veprimtarive që zhvilloheshin unë zbulova që kisha talent kërcimin. Tani jam pjesë e ansamblit popullor të Dibrës", tregon me entuziazëm gjatë një takimi me organizatat partnere Reisi, një nga vullnetarët më të rinj të Changing the Future.

Sot, pas 6 vitesh, këto të rinj po pasojnë njëri-tjetrin duke mos lënë vetëm asnjë çast nevojat që Dibra ka. Dhe pse vitet ikin, puna për ndërgjegjësim, promovim dhe vullnetarizëm në kauza të ndryshme nuk mungon.

"Shumë të rinj ikin për arsye të tyre jashtë Dibrës, e shumë të tjerë vijnë pranë organizatës tonë me një dëshirë për t'u aftësuar vetë dhe për të dhënë kontributin e tyre", thotë Ilir Poçi, drejtori i organizatës rinore Changing the future, i cili po ashtu ka qenë pjese e grupit vullnetar. Iliri mbështetet fort nga disa të rinj si Endri, Kudreti, Linda, Sidorela dhe Mira, të cilët pavarësisht punës që bëjnë, gjejnë kohë për të kontribuar në veprimtaritë e CHF. Mungesa e mundësive të përfshirjes së të rinjve në veprimtari të organizuara nga shteti u jep mundësi organizatave të thithin këto të rinj dhe ti mbështesin ato në nismat që marrin për ndryshimin e situatës së komunitetit përreth tyre.

"Changing the future" jep idenë e shpresës për një ndryshim të një situate, është emri i organizatës rinore, e cila përmbledh në vetvete të rinjtë e palodhur dhe të pakursyer për të ndryshuar të ardhmen e vendit të tyre. Ata kanë thyer klishetë e këtij brezi me mungesë mundësish duke treguar në komunitetin e tyre energjitë, talentin dhe shpresën.

Aktualisht, të rinjtë e Changing the Future janë shumë aktiv në qytetin e Peshkopisë. Ata bashkëpunojnë me shumë institucione lokale ashtu dhe me organizata të ndryshme partnere që operojnë dhe kanë ndikim në këtë zonë. Ato akoma vazhdojnë rrugëtimin me vizionin : "Të rinjtë agjent ndryshimi në komunitet". Synimet kryesore janë mirëqenia e fëmijëve si dhe fuqizimi i të rinjve për punësim. Po punohet vazhdimisht për promovimin e turizmit malor në Dibër. Turizmi në lupën e tyre shihet si një mundësi e mirë për gjenerimin e të ardhurave. Gjatë verës të rinjtë bëhen pjesë e kampingjeve verore malore në malin e Korabit, Hinoskë, Liqenin e Gramës, Ujvarën e Pocestit e shumë vende të tjera që natyra ka treguar bujarinë. Këto të rinj kanë hartuar guida turistike të mirëfillta me çmime shumë të arsyeshme.

Ata janë heronj të heshtur, për të cilët askush nuk flet. Por për ta flet puna. Ata arritën të ndryshojnë mendimin se "nuk punohet vullnetar", duke arritur të bëhen pionierët e ndryshimit dhe të punojnë fort për të thyer barrierat që paraardhësit tanë i vendosen. Ato nuk shikojnë se ç'po bën qeveria, por rendin drejt çdo të mire që mund t'i bëjnë vetes së tyre dhe komunitetit.



Gjatë një aksioni për pastrimin e mjedisit



Vullnetarë të Changing the future gjatë një udhëtimi turistik në Malin e Korabit



Të rinjtë e Changing dhe future duke mbledhur ndihma për familjet në nevojë

Rruga e Arbërit nr. 133

vendlindje

Dikur njerëz punëtore të zellshëm dhe me një harmoni mbresëlënëse jetonin në dyert e njëri-tjetrit. Punonin, festonin dhe ndanin bashkë çdo problem, duke bërë fshatin Bahute një nga fshatrat më paqësorë...

Bahutja, *fshati që po shkon drejt zhdukjes…*

Nga **SAMET ZAGRADI**



Bahutja ndodhet rreth 6 km në veri të qytetit të Peshkopisë dhe është pjesë e rëndësishme e njësisë administrative Tomin. Poshtë vargmaleve të Deshatit në lindje kufizohet me fshatin Shimçan, në veri me Zimurin, në jug me Deshatin dhe në perëndim përroi e ndan me fshatin Vrejnt. Ka një klimë me dimër të ashpër dhe me borë, verë të thatë dhe të nxehtë, klimë tipike të kësaj zone.

Fshati Bahute ndahet në dy pjesë, respektivisht Bahutja e sipërme apo siç e quajnë banorët "Istrefe" dhe Bahutja e poshtme. Gojëdhënat e shumta janë kontradiktore me emrin e këtij fshati, duke dhënë versione të ndryshme. Rreth viteve 1920 ky fshat numëronte 23 familje, për të arritur në vitet e demokracisë rreth 120 familje. Banorët e këtij fshati kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në luftërat që janë zhvilluar në periudha të ndryshme në vendin tonë, duke dhënë jetën si dëshmorë të lirisë. Shehat Halili, Kalosh Taravari, Beqir Baci, Pijazit Neli e shumë të tjerë luftuan me çetat partizane në mbrojtje të atdheut të tyre.

Dikur ishin 120 familje e sot rotacioni na çon sërish në vitet 1920. Në ditët e sotme ky fshat rrezikon të zhduket, duke qenë se lëvizjet masive të popullsisë drejt qendrave urbane nuk po ndalen. Çdo ditë ky fshat po braktiset, nga familje të cilat në kërkim të një jete dhe mundësive më të mira detyrohen të lënë pas trojet dhe historinë e tyre. Shkolla fillore dikur ziente nga zëra fëmijësh e sot, edhe pse pas një investimi të qeverisë shqiptare, ajo qëndron e mbyllur. Mungesa e fëmijëve ka detyruar institucionet të mbyllin klasat kolektive, duke bërë që ato pak fëmijë mes vapës, ftohtit, borës dhe ngricës të udhëtojnë rreth një orë drejt shkollës 9 vjeçare "Shehat Halili" Shimçan, shkollë kjo që po shkon drejt mbylljes dhe pse mbart një histori të jashtëzakonshme ndër breza.

Dikur njerëz punëtore të zellshëm dhe me një harmoni mbresëlënëse jetonin në dyert e njëri-tjetrit. Punonin, festonin dhe ndanin bashkë çdo problem, duke bërë fshatin Bahute një nga fshatrat më paqësorë dhe më të lidhur mes tyre. Ritet dhe traditat ruheshin me fanatizëm nga çdo pjesëtar i

Dikur ishin 120 familje e sot rotacioni na çon sërish në vitet 1920. Në ditët e sotme ky fshat rrezikon të zhduket, duke qenë se lëvizjet masive të popullsisë drejt qendrave urbane nuk po ndalen. Çdo ditë ky fshat po braktiset, nga familje të cilat në kërkim të një jete dhe mundësive më të mira detyrohen të lënë pas trojet dhe historinë e tyre. Shkolla fillore dikur ziente nga zëra fëmijësh e sot, edhe pse pas një investimi të qeverisë shqiptare, ajo qëndron e mbyllur.

asaj zone, i madh dhe i vogël dhe padyshim që ky ka qenë një ndër arsyet pse këto njerëz shkonin mirë më njëri-tjetrin. Dikur kishte shumë gjëra e sot në këtë fshat nuk ka më as njerëz. Xhamia e fshatit mbushej nga besimtarë myslimanë, por ky fenomen detyroi që në ditët e sotme të mos hapet më, duke ndjekur fatin e shkollës. Njerëzit që kryenin ritet fetare janë larguar bashkë me familjet e tyre. Tokat kanë mbetur djerrë, ato toka që dikur prodhonin produkte me emër dhe cilësi duke mbajtur ekonomikisht këto familje. Patatet dhe mollët karakteristike të Bahutes kultivoheshin dhe pëlqeheshin në masë, duke bërë atë të njohur në trevat e tjera të Dibrës.

Panorama që të paraqitet sot, në qoftë se mendon të shkosh në Bahute, të sjell në mendje skena të filmave me tema lufte. Në dalje të Shimçanit, përballë shfaqet një panoramë e shëmtuar me nuanca të thella zymtësie dhe qetësie që të vret. Dikur ajo rrugë në hyrje të fshatit gjithmonë kishte lëvizje me njerëz nga Bahutja, Zimuri, Vrejnti, Voleza e deri në Limjan. Sot ajo mbart një qetësi, e cila të shoqëron deri në fshat. Gjendja e mjerueshme e këtyre pak njerëzve që kanë mbetur duket qartë që zymtësinë që ato kanë në fytyrat e tyre. Teksa mundohesh të depërtosh me thellë, qetësisë së zymtë i përforcohet ideja që t'u shfaq në fillim të fshatit te lapidari. Shtëpi të rrënuara që nga momenti në moment duket sikur do të të varrosin poshtë edhe këto pak frymë që kanë mbetur. Diku më tej, në mëhallën e poshtme situata ishte më keq. Qetësinë e zymtë herë-herë e prishte një gjel që dukej sikur të thoshte se ky vend akoma ka të zot. Ndoshta ka të drejtë, sepse të vetmit besnikë të kësaj shkretëtire kanë mbetur ato bashkë me disa gra e fëmijë që përpiqen të mbijetojnë me çka t'u ndodhet. Burrat dhe djemtë e mbetur të këtij fshati detyrohen të largohen në mërgim, pasi çdo mundësi fitimi në këtë vend nuk përballon jetesën normale të një familje. Gratë, që mjeshtërisht bëjnë gati çdo rol të burrit, duke kositur, prashitur, duke bërë dru në mal dhe duke kullotur bagëtinë në çdo ditë të jetës së tyre. Heroina të vërteta, kur i sheh të stërmunduara e të plakura para kohe, duke bërë punë që një pjesë e madhe e grave në Shqipëri nuk do t'i mendonte kurrë.

Të ishte për mua nuk do ikja kurrë nga ai vend, sepse aty linda dhe punova një jetë të tërë, duke jetuar të varfër, por të lumtur. U largova nga Bahutja, sepse doja një jetë më të mirë për fëmijët e mi. Më merr malli për çdo gur dhe sa herë udhëtoj drejt Dibrës mundohem të vizitoj me mall atë vend, - janë fjalët e 78 vjeçarit Ramazan Elezi, që bashkë me familjen prej dhjetë vitesh jeton ne Durrës.

- Burrat tanë janë në kurbet dhe punët normalisht që duhen bërë. Nuk na bëjnë më përshtypje këto punë, sepse kemi një jetë në këtë fshat, - ishin fjalët e një gruaje rreth të 45-tave, që me nxitim i nisi të thoshte teksa me një vështrim disi të egër bërtiti kalit të ngarkuar me jonxhë. Gruaja me një trastë në dorë, me shami të bardhë në kokë dhe me një fëmijë me fytyrë të pafajshme me hundë të qëruar nga dielli humbën në qetësinë mbytëse që karakterizonte këtë fshat.

Për këta pak banorë jetesa është tejet e vështirë, veçanërisht në stinën e dimrit, ku bora dhe infrastruktura jashtëzakonisht e amortizuar e bën të pamundur lëvizjen në rast të ndonjë emergjence. I vetmi mjet lëvizës është një furgon që përballon lehtësisht lëvizjen e banorëve të fshatit Bahute dhe Zimur bashkë. Ekonomia e këtyre banorëve, siç shprehen ata, nuk është aspak e mirë, ndryshe një orë e më parë do ishin larguar nga ai vend që nuk jetohet më.

- Të ishte për mua nuk do ikja kurrë nga ai vend, sepse aty linda dhe punova një jetë të tërë, duke jetuar të varfër, por të lumtur. U largova nga Bahutja, sepse doja një jetë më të mirë për fëmijët e mi. Më merr malli për çdo gur dhe sa herë udhëtoj drejt Dibrës mundohem të vizitoj me mall atë vend, - janë fjalët e 78 vjeçarit Ramazan Elezi, që bashkë me familjen prej dhjetë vitesh jeton ne Durrës. Ndërtimi i Rrugës së Arbërit si për çdo dibran edhe për banorët e fshatit Bahute do t'i rikthente ata, duke rindërtuar shtëpitë e tyre tashmë të shkatërruara dhe duke punuar tokat djerrë prej disa viteve.

Ky fshat dita-ditës po rrënohet deri në rrënjë, duke rrezikuar dhe mosekzistencën e tij. Si Bahutja janë disa fshatra të thellë që çdo ditë po braktisen nga banorët nga mungesa të ardhurave ekonomike dhe zhvillimi i një infrastrukture që do të bënte një jetesë sa më të mirë. Bellova, Cerjani, Zagradi, Zimuri e disa fshatra të tjerë duket se kanë të njëjtin fat me atë të Bahutes, duke pasur në brendësi të tyre dhjetë, pesëmbëdhjetë apo njëzetë familje e gjithë fshati dhe këto me perspektivë për t'u larguar një ditë e më parë nga ai vend.



...është koha për t'u pajtuar...

KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com

vetëm 600 lekë në vit

opinion

Mendoj se kriteret e dhënies së titullit të lartë "Qytetar Nderi" duhet të ndryshojnë. Të mos varen thjesht tek mendja dhe dora e kryetarit të bashkisë qoftë dhe të këshillit bashkiak.

A është "Qytetar Nderi" Xhafer Martini?!

Nga **ISLAM ÇENGA**



Ky personalitet i letrave dibrane dhe shumë më gjerë, Xhafer Martini a është shpallur Qytetar Nderi për qytetin tim, për bashkinë tonë? Me siguri, i thoja vetës. Nuk mund të ndodhë ndryshe, sepse në fushën e letërsisë, në fushën e artit pak të tillë ka qyteti im dhe lista e saj nuk është kushedi se sa e gjatë. Por isha gabuar. Më përgjigjet thjeshtë, me atë buzëqeshje të lehtë që nuk i hiqet nga buzët... Nuk më ka ardhur ende radha.

Por unë, e shumë të tjerë si unë do të kishin dëshirë, do të kisha nder të kisha më së pari pikërisht Xhaferin Qytetar Nderi, do të krenohesha me të thjeshtë si bashkëqytetar i tij e më thjesht se tek ai kanë gjetur përkrahje me dhjetra e dhjetra krijues të rinj të artit, letërsisë, kulturës, një ndër të cilët jam dhe unë.

Para disa kohësh, në listën bajagi të gjatë "Qytetar Nderi" për Bashkinë e Peshkopisë, u shtua dhe një personalitet tjetër... E ç'rëndësi ka se ç'profesion kishte Mohikani i Fundit, se ç'farë seksi, moshë a tiparet karakteristike të fytyrës, ngjyra e flokëve apo meritat e spikatura në veprimtarinë e përditshme disa vjeçare, dhjetra vjeçare në shërbim të komunitetit, për komunitetin e në funksion të komunitetit. Veprimtaria e dhënies së titullit u zhvillua në ambjent diku në qendër të Tiranës, me jo pak të ftuar, me jo pak dashamirës, një auditor i mbushur plot me fytyra të njohura, fytyra disi të lodhura nga jeta gjithë zhurmë e strese në metropolin shqiptar, ndër të cilët isha dhe unë... I ulur diku nga fundi... Jo për faktin se shkova disi me vonesë, (atëherë kur vendet e fillimit zakonisht janë të zëna), por se më pëlqen që në raste të tilla të gjej vendin më të qetë, larg buzëqeshjeve servile, kujtesave të përkohshme, xhentilesave tipike të stisura, që në takime e festime të tilla janë të pa karar e të pa cak. Pastaj, e thënë troç, nuk më pëlqejnë salltanetet, fjalime oratorësh, mburrjet e lëvdatat pafund për titullmarrësin, tufa lulësh, familjarë të ekzaltuar... I ndodhur në rreshtat e fundit humbet disi forca shkëlqimtare e tyre, verbuese, paralizuese, elektrizuese, duke ardhur më njerëzishëm, më tokësore, më të buta e për pasojë më të vërteta, më të besueshme e veprimtaria disi më normale, më e thjeshtë e më pa salltanete.

Për çudi, në aktivitete të tilla plot dithirambe më rrjedh kujtesa si përrua për të njohurit e qytetit tim, për shumë e shumë figura të ngjashme, pafundësisht të ngjashme me personalitetin që sot merr titullin e lartë "Qytetar Nderi" Parakalojnë para kujtesës sime të vdekur e të gjallë. Njerëz të thjeshtë, punëtorë të palodhur, familjarë të admiruar. Nuk janë të gjithë mjekë, as të gjithë ish drejtorë ndërmarrjesh, as ish artistë, as ish oficerë apo policë, as ish e ish... vijnë pa asnjë cmirë që zakonisht e shoqërojnë sojin njerëzor, pa asnjë zili, kundërshti, xhelozi që zakonisht gërryejnë racën njerëzore që më së shumti zhurmojnë para dhe pas pak ditëve të aktiviteteve të tilla. Pastaj...Pastaj çdo gjë pret aktivitetin e rradhës me të njëjtin sallë, podium, pjesmarrës, rradhë pune, oratorë të ngjashëm në fizionomi, letra fjalimesh, kollare të vëna enkas, thashetheme grash nga rrugicat e kroin e fshatit...

Aty nga fundi ku zakonisht ulem unë, vijnë e ulen përkrah meje e janë në kujtesën e në vëmendje time njerëz të thjeshtë si Han Zyberi, kovaçi i talentuar që i jepte frymë hekurit, apo Ramiz Açka, çliruesi i palodhur i oxhaqeve të zëna e me probleme në tërheqjen e tymit, shpërdarësi tolonave të drurit të zjarrit, Lavdrim Selami, mjeshtri i ndërtimit, ustai, Ismet Kadria, mesuesin e paharuar Qani Pertafi apo Kujtim Leka, Met Xhombulla apo zotni Hasan Rrapi, Iljaz Kaca...nënë Xhelabie apo zonja Ramika Pitarka, Ruzhdi Shehun e Met Hajrullain të persekutuar nga rregjimi apo doktorin infermier Ziçe Kuka, drejtues të palodhur në punë e të panginjur me ndershmëri si Idris Lala, Rahman Çenga, Riza Shehu, Met Kallaverja, Ahmet Kaçori e Perleka, Myslim Koka, Qamil Ashiku, e shumë e shumë të tjerë... Të më ndjeni të dashur lexues por ju mund të rëndisni dhjetra blektorë të talentuar, fermerë të palodhur e të suksesshëm, studiues të historisë së Dibrës, shkencëtarë, doktorë shkencash, profesorë të nderuar si Shaban Sinani, apo poetë e romancierë të spikatur si Agron Tufa...

Mblidhemi andej nga fundi ku dhe bokset e mikrofonave ndihen disi më dobët, bisedojmë e qajmë derte me njëri-tjetrin, për shpërfytyrimin e qytetit tim, për shtesat e pallateve krejt pa kriter, për lulishtet e djegura e të zëna me turrat e druve ku gëlojnë vetëm minj e merimanga e për asfaltin e dalë mos më keq e për dreq...

Të them të drejtën nuk kam asnjë kundërshti, zili apo bezdi, aq më pak cmirë për Qytetarët e Nderit të qytetit tim. Përkundrazi. Si shumëkush përulem në gjunjë ndaj figurave të tilla që kanë spikatur ndër ne të tjerët, kanë dhënë kontribute të vyera, e gjithsesi kanë lënë gjurmë në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, ekonomike, në jetën e qytetarinë e përmendur dibrane dhe më gjerë. Shumë prej tyre ende vazhdojnë të kontribuojnë me sa e si munden për vete, familjen, qytetin, fshatin, krahinën, vendin. Në këtë kuadër, a mund të bëhesh Qytetar Nderi pse ke qenë dikur për pak vite, qoftë dhe për shumë vite shef shëndetësie, shef plani, shef klinike apo pavioni, shef hipoteke, kuadri apo drejtor ndërmarrje, kryetar kooperative, kryetar dege...Po mund të bëhesh. Bëhesh kur veprimtaria jote jo vetëm ka lënë gjurmë të thella në drejtimin ekonomik të kohës, por novacioni, evolucioni, vizioni, transformimi, kultura, qytetaria, mirësia, pasioni, kompleksiteti intelektual përbën në vetvete aksin e figurës që meriton titullin e lartë të Qytetarit të Nderit. Ky aks figure, nëse mund ta quhet kështu, domosdo duhet të jetë krejt i spikatur, krejt i veçantë, krejt ndryshe nga të tjerët, nga shumica e mundshme e njerëzve të nderuar të komunitetit.

Në këtë shtrirje mendimi dua të shtoj se qëllimi i këtij shkrimi nuk është për të analizuar meritacionet e pesonaliteteve që kanë marrë deri tani këtë titull, që për hir të së vërtetës kjo listë për qytetin tim është e gjatë. Vetë kjo "listë e gjatë" sikur ja ul vlerat vetë titullit të lartë dhe akrituesit e këtij titulli. Dikush më thotë se tituj të tillë janë dhënë disi me ngut, me lobingje rastesore, në të shumtën në kohë fushatash elektorale, fill pas kontributeve partiake fill pas zgjedhjeve elektorale. Zoti më faltë por pas ndonjë titulli Qytetar Nderi fshihet një fjalë e dhënë, një pazar politik i bërë, dhjetra vota të tjetërsuara, ndere për militantë e partiakë, për dredharakë partiakë, garë e shfrenur fisesh, oxhaqesh, grupimesh, parcelizmave.

Titulli Qytetar Nderi është i larë më flori, më thotë një veteran i punës në Peshkopi. Duhet të gërmosh me vite për të nxjerrë pak flori nga toka. Peshkopia dhe treva e Dibrës ka njerëz me të vertetë që veçohen për vlerat intelektuale, akademike, krijuese, zhvilluese jo vetëm për zonën, por shumë më gjerë, duke rrezatuar me vlera të spikatura, të rralla. Shumë prej tyre janë nderuar me këtë titull të lartë dhe jo vetëm. Figura të tjera do të nderohen në të ardhmen. Do zoti kurrë në kohë fushate apo fill pas fushatave elektorale...jo me shërbime partiake e nga shpërblime partiake. Qoftë larg të vazhdohet qoftë dhe me hamendje një praktikë e tillë që ul vlerat e larta që mbart ky titull i lartë e fisnik. Kështu, lista e Qytetarëve të Nderit bëhet çarçaf, e gjatë dhe me probleme që shpesh bëhen objekt diskutimesh, kundërshtish, hamendësimeve. Ndaj duhet kujdes, paanësi, një bazë e përcaktuar vlerash, një seleksionim jashtë politikës, jashtë interesave mediokre, që në të shumtën janë edhe të neveritshme. Rujna Zot po hyri dhe ekonomia e tregut në dhënie titulli! Një titull i tillë nuk mund të blihet kursesi si titujt kalorsiakë në kohën e mesjetës! Qytetar Nderi nuk mund të bëhesh kursesi për hir të fisit, të Derës së Madhe, të Malit apo Fushës, të Pragut apo të Oxhakut. I tillë bëhesh për kontribute të spikatura vetjake në shërbim të qytetit, në shërbim të trevës, në shërbim të kombit.

Mendoj se kriteret e dhënies së titullit të lartë "Qytetar Nderi" duhet të ndryshojnë. Të mos varen thjesht tek mendja dhe dora e kryetarit të bashkisë qoftë dhe të këshillit bashkiak. I pari për interesa partiake, të fushatave para dhe pas zgjedhore mund të këtë preference, interesa të ngushta të çastit, të dytët mund të manipulohen, për t'u mos u bërë pengesë, të mos prishin qejfin qoftë të kryetarit qoftë të propozuarit. Fare mirë mund dhe duhet të tërhiqet mendimi, opinioni i komunitetit, i strukturave të komunitetit, i rretheve intelektuale, të historinëve, të me qëllim që vlerat e titullit të mos bien në kufirin e interesave e lobingjeve.

Në këto përpjekje për të çuar deri në fund arsyetimin tim, arsytimin për të portretizuar një Qytetar Nderi kontributesh mbarë dibrane, fisnik, i thjeshtë, futur në botën e tij krijuese, më shfaqet shkrimtari ndër më prodhimtarët, më cilësorët, më të spikaturit e letrave dibrane dhe jo vetëm, Xhafer Martini. Shkrimtar, studius, historian,sociolog, etnolog, gjuhëtar etj, me një kolanë të pasur veprash të botuara, si pak kush, si rrallë kush, me projekte të mrekullueshme për të ardhmen, mjafton një përkrahje modeste sponsorizimi nga Bashkia, biznesi etj. Do të ishte një fat të lumë për ne që shkrimtari e studiusi i palodhur është vital në krijimtari e i palodhur në kontribute, qytetar model e njeri që reflekton mirësi e hirësi...

Pra, ky personalitet i letrave dibrane dhe shumë më gjerë, Xhafer Martini a është shpallur Qytetar Nderi për qytetin tim, për bashkinë tonë? Me siguri, i thoja vetës. Nuk mund të ndodhë ndryshe sepse në fushën e letërsisë, në fushën e artit pak të tillë ka qyteti im dhe lista e saj nuk është kushedi se sa e gjatë. Por isha gabuar. Më përgjigjet thjeshtë, me atë buzëqeshje të lehtë që nuk i hiqet nga buzët...Nuk më ka ardhur ende rradha. Ka të tjerë, plot të tjerë. Kuptohet se arsyet krejt subjektive e ka në lënë jashtë vëmendjes njeriun e nderuar z. Martini, pos të tjerave dhe larg nga titulli, larg nga vlerësimi i një këshilli bashkiak që nis e bitis nga diktimet e politikave të çastit, sipërfaqësore e rastësore. Por unë, e shumë të tjerë si unë do të kishin dëshirë, do të kisha nder të kisha më së pari pikërisht Xhaferin Qytetar Nderi, do të krenohesha me të thjeshtë si bashkëqytetar i tij e më thjesht se tek ai kanë gjetur përkrahje me dhjetra e dhjetra krijues të rinj të artit, letërsisë, kulturës, një ndër të cilët jam dhe unë.

Me bindjen se kam të drejtë në argumentat e arsyetimet e mia pyes: Po Xhafer Martini kur do të bëhet Qytetar Nderi i qytetit tim?

Rruga e Arbërit nr. 133

**Golloborda thuajse është harruar nga qeveritë shqiptare.
Askush nuk e vuri "ujin në zjarr" për të dhe banorët e saj...**

reportazh

GOLLOBORDA, vendi i varfër i mjeshtërve të punës dhe të mundjes

Nga **URIM BAJRAMI**



Ah, sikur të ishte bërë kjo Rruga e Arbërit, ah...!

E pamundur të mos e dëgjoje këtë ofshamë të zgjatur tek ata që kishin tejmbushur rrugët e Ostrenit të Madh, të enjten e 18 majit. Gra, burra dhe fëmijë i gëzoheshin kampionatit tradicional të mundjes, një aktivitet tashmë i përvitshëm, që përpiqet të mbajë gjallë një traditë të vyer e të vjetër sa vetë Golloborda.

Ostreni, ai i madhi, ishte bërë gati për të pritur mysafirë nga çdo cep i Shqipërisë ku gollobordasit duarartë kanë lënë gjurmët e tyre të pashlyera. Mysafirë ishin dhe kampionët e mundjes, të shpërndarë në shumë vende të botës. Ata u nderuan me kupa dhe tituj nga organizatorët e kampionatit tradicional të mundjes, si një përpjekje modeste për të kthyer kokën pas e për të mos harruar një trashëgimi që ua kanë zili të gjithë. Sofra e madhe e Gollobordës do të dukej e paplotë pa përfaqësuesit nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, bashkë me ekipet e tyre të mundjes, të cilët u ndeshën me vëllezërit e tyre në tapetin e gjelbër të barit.

Të gjithë kishin udhëtuar me qindra e qindra kilometra, në rrugë plot gropa, me dhe pa asfalt, për të mbërritur në qendrën e Gollobordës, për të duartrokitur djemtë e tyre mundës të të gjitha kategorive, e nga ana tjetër për të kujtuar të gjithë ata mjeshtra të këtij sporti burrëror. Kujtuan dhe nderuan kampionë me zë, që u dhanë emër dhe zë skuadrave më të njohura shqiptare, duke filluar nga Partizani, Tirana e Dinamo e deri tek Korabi, Vllaznia apo Përparimi i Kukësit.

USTAI NUK E DI KU I PIKON ÇATIA...

Nuk besoj se ka ndërtim në Shqipëri, ku nuk kanë lënë gjurmë gollobordasit, këta mjeshtër të ndërtimit. Ndërtuan vepra pa fund në kohën e komunizmit, vazhduan të ndërtojnë edhe në kohën e sotme të kapitalizmit. Siç shkruan miku im, Hilë Lushaku, njëherazi mik i vyer i të gjithë gollobordasve tashmë, në rindërtimin e vendit, pas çlirimit nga pushtuesit nazi-fashist, spikati më fort se kurrë dora mjeshtërore e kryeustallarëve gollobordas, që në fillim i quanin "ustabash", e më pas "duarartë", "kryemjeshtër" dhe "të talentuarit". Nuk e kishin zakon për t'u ankuar, por dhe kur ndodhte, nuk i dëgjonte askush.



"Vula" e duarve të rreshkura, por mjeshtërore të gollobordasve gjendet kudo ku ka vepra të ndërtuara përgjatë shumë viteve; në hidrocentrale, në kantiere të shumta ndërtimi, ndërmarrje, fabrika dhe uzina, në pallate banimi të panumërta që u dhanë formën e plotë qyteteve industriale në mbarë Shqipërinë. Ustallarët gollobordas u rritën, u burrëruan dhe u thinjën në veprat e kohës, aty mësuan dhe përsosën mjeshtërinë e gurskalitësit, muratorit dhe minatorit, inxhinierit dhe karpentierit. Ishin ndoshta themelues të zonave dhe qyteteve industriale - kur bëhet fjalë për zanatin e tyre - si ish-Qyteti Stalin, ish-Metalurgjiku, Laçi etj.

Jo vetëm kaq. Janë me emër të dëgjuar disa nga veprat më në zë që janë ndërtuar nga gollobordasit dhe dibranët në Selanik, Stamboll e më gjerë, si xhami, shkolla, konvikte, qendra tregtare, shëtitore etj. "Në Carigrad, dibranë specialistë nga Golloborda, kanë kryer punimet në oborrin e Illdiz-Koshk-Dollma, për ndërtimin e të cilëve janë dekoruar me dekorata e medalje dhe privilegje të tjera të Perandorisë Turke. Ata ftoheshin në festime të ndryshme dhe ushtarake, ku mbanin në gjoks dekoratat e tyre", shkruan studiuesi i njohur Kërsto Kostov.

Pavarësisht mjeshtërisë së tyre, qoftë në kohën e Enver Hoxhës, qoftë dhe më pas, Golloborda thuajse është harruar nga qeveritë shqiptare. Askush nuk e vuri "ujin në zjarr" për të dhe banorët e saj, që nuk kanë lënë cep të vendit pa ndërtuar, por asnjëherë nuk e kuptuan se ku pikonte çatia e shtëpisë së tyre. Ose nuk kishin kohë për ta kuptuar. Linin familjet dhe rrugëtonin anë e mbanë Shqipërisë, atje ku vendi kishte më shumë nevojë për ta. Ndërtonin, riktheheshin për pak ditë pranë familjeve të tyre dhe përsëri nxitonin për të shkuar kantiereve të shumta të ndërtimit, atje ku ndjehej mungesa e ustallarëve. Ndërtuan Shqipërinë, por nuk ndërtuan vendin ku lindën. Për fat të keq, Golloborda është më keq se dje. Nesër do të jetë më keq se sot, nëse qeveritë do të vazhdojnë me indiferencën e tyre vrastare ndaj kësaj zone plotë tradita që i ka dhënë Shqipërisë gjithçka ka pasur. Populli thotë: Ustai e di ku i pikon çatia. A vlen kjo mençuri edhe për gollobordasit dhe vendin e tyre?

"Vula" e duarve të rreshkura, por mjeshtërore të gollobordasve gjendet kudo ku ka vepra të ndërtuara përgjatë shumë viteve; në hidrocentrale, në kantiere të shumta ndërtimi, ndërmarrje, fabrika dhe uzina, në pallate banimi të panumërta që u dhanë formën e plotë qyteteve industriale në mbarë Shqipërinë. Ustallarët gollobordas u rritën, u burrëruan dhe u thinjën në veprat e kohës, aty mësuan dhe përsosën mjeshtërinë e gurskalitësit, muratorit dhe minatorit, inxhinierit dhe karpentierit.

RRUGËT PA RRUGË

Të nisesh këto kohë për të shkuar në Gollobordë, në cilindo fshat të saj, duhet të mendohesh dy herë. Ngado që të nisesh, do të të duhet të kalosh ose nga Rruga e Çerenecit ose nga Klenja, nga ana e Librazhdit. Rruga që nis nga Ura e Çerenecit për në Ostren e më tutje është ku "thërret qameti". Shumë që udhëtojnë me makina të vogla, i parkojnë ato afër urës dhe vijojnë udhëtimin me mjete më të larta ose me fugonët e shumtë aty pranë. Kur mendon se ia ke hedhur sadopak, vetëm pak kilometra më tutje rruga ndahet në dy drejtime. Një pjesë e fshatrave të Gollobordës shtrihen në anë të kufirit me Maqedoninë, dhe ajo që njihet si "rruga e kufirit" vetëm rrugë nuk mund të quhet. Ka qenë rrugë e keqe edhe para viteve '90, por të paktën atëkohë mirëmbahej. Ndërsa gati dy dekadash kjo rrugë nuk ka "parë" as dhe një lopatë dhe a zhavorr. Shumë shpejt, nëse nuk vihet dorë sadopak mbi të, nuk do të dallojë shumë nga "shtigjet e dhive".

Pjesa tjetër e fshatrave shtrihet në anën tjetër. Nga Ramnagora e tutje. Është rrugë më e mirëmbajtur e të çon drejt qendrës, Ostrenit të Madh për të vijuar më pas, përmes dy degëzimeve, drejt Klenjës e më tej drejt Librazhdit. Diku, pak pa hyrë në Ostren, ka një devijim që lidh rrugën e vjetër me rrugën e re që po ndërtohet prej vitesh, por që ende nuk ka përfunduar. Përfundimi i kësaj rruge do të gëzonte një pjesë të banorëve të kësaj zone, por pjesa tjetër mbetet si një xhep i fshehur, që nuk e vë re askush, as kur ka dhimbje.

Nëse kuvendon me banorët e Gollobordës, shtruar, fshat më fshat, mund të shkruash një histori më vete, sepse e tillë ka qenë jeta e tyre, histori e dhimbshme por plot me krenari. Secili ka një histori për të treguar. Histori plot dhimbje e sakrifica. Por ata zgjedhin të mos ankohen. Zgjedhin t'i ndërtojnë më parë shtëpinë tjetrit se sa të vetën... Kështu janë mbrujtur, rritur dhe edukuar.

FESTA E MADHE

Për fat, ne rrugëtuam nga Ramnagora. Peisazhi që ofron natyra, sidomos në këtë stinë, është fantastik. Kudo gjelbërim. Njerëz nëpër ara, për t'i bërë shërbimet e duhura asaj dhe për t'ia korrur frytet para se të vijë dimri i gjatë.

cyan magenta yellow black

Për Gollobordën dhe gollobordasit,
“dasma dhe mundja janë një binom i pandarë”.



Të tillë janë gollobordasit. Të presin me atë që kanë, të respektojnë si mikun e tyre më të shtrenjtë, dhe në fund të përcjellin duke të dhënë me vete gjithmonë diçka si dhuratë. Ç’rëndësi ka se çfarë është. Vlera e saj është e madhe. Të lidh fort me shpirtin gollobordas...

Nuk ka patur në Gollobordë dasëm pa mundje. Nuk ka patur garë mundjeje që të mos mblidhte rreth vetes kampionët e saj, që vinin sa nga Kukësi e Shkodra, por aq dhe nga Tirana. Dasma dhe mundja ishin dhe janë ende një binom i pandarë.

Atmosfera festive ndjehet që larg. Oborri i shkollës “Elez Koçi”, një figurë e shquar e kësaj zone, po mbushet me shpejtësi. Nuk ka shumë burokracira gjatë ceremonisë. Muzikë, valle, fjalime të shkurtra, titujt, një vizitë në muzeun e krijuar për mundjen gollobordase. Kaq. Sepse të gjithë mezi presin të zhvendosen disa metra më tutje, ku është gara mes mundësve. “Aty është lezeti”, thotë një plak simpatik, i veshur si për festë. Festë? Po, po, festë. Mundja në Gollobordë është vërtet festë popullore. Të gjithë përpiqen t’i kryejnë sa më shpejt punët e ditës, ato më kryesoret, dhe nxitojnë për tek livadhi. Aty ku bëhet gara e mundjes.

Kush e njeh mundjen dhe duelin e përjeton shpirtërisht muzikën emocionale të duelit, shijon spektaklin dhe përjeton vuajtjen apo gëzimin e ndeshjes. Në Gollobordë, këtë e shijojnë të gjithë. Pa dallim. Ndaj përreth tapetit të gjelbër ka burra, gra e fëmijë.

Këtë vit, falë edhe ekipit dhe ndihmës së pakursyer që i ka dhënë ish-kampioni Skënder Rama, gara dukej më e fortë. Dhjetëra të rinj, të peshave të ndryshme, u dhuruan emocione pafund qindra e qindra spektatorëve. Gara që zgjati disa orë u mbyll me ndeshjen mes ish-kampionit Dëfrim Koçi më kampionin aktual kosovar, Edon Shala, pjesë e ekipit pjesëmarrës të Kosovës në këtë aktivitet. E ku kishte më bukur se një mbyllje e tillë, me një duel brezash dhe vëllezërish.

Ceremonia mbyllet, por jo festa në shpirtin e gollobordasve. Ajo vazhdon...

TË VARFËR, POR BUJARË

Zonë me dimër të ashpër e të zgjatur. Pa infrastrukturën më minimale. Zonë e izoluar që po shkon drejt braktisjes masive, për shkak dhe të indiferencës totale të shtetit. Vetëm pak fshatra po e ruajnë gjallërinë e tyre të dikurshme. Të tjerët i ka pllakosur heshtja. E dhimbshme deri ën palcë kur e mendon se, në raste vdekjesh nuk gjenden njerëz jo thjesht për t’i bërë nderimet e fundit, por për të hapur vendin ku do të prehet përjetësisht.

Një mik i imi, i cili për arsye pune kishte vizituar disa nga fshatrat e Gollobordës, kur u kthye në Tiranë, më tha: Me profesionin që kam, kam bredhur thuajse gjithë Shqipërinë. Por nuk kam ndeshur si në anët e tua. Zonë e varfër shumë, njerëz gjithashtu të varfër, por shumë bujarë...!

Të tillë janë gollobordasit. Të presin me atë që kanë, të respektojnë si mikun e tyre më të shtrenjtë, dhe në fund të përcjellin duke të dhënë me vete gjithmonë diçka si dhuratë. Ç’rëndësi ka se çfarë është. Vlera e saj është e madhe. Të lidh fort me shpirtin gollobordas, ndaj sa herë ke mundësi kërkon të rikthehesh aty e të çmallesh me miqtë e tu.

Të shumtë ishin miqtë e ftuar në kampionatin e mundjes tradicionale, që u zhvillua së fundi në Ostren. Dëgjonin me ëndje historitë e shumta me mjeshtër të ndërtimit, të mendjes e të mundjes. Shumë prej tyre vinin për herë të parë në Ostren. Shijuan gjithçka, që nga gatimet tradicionale të zonës, vallet dhe këngët e saj, shoqëruar në çdo rast me veshjen e bukur popullore të krahinës, e deri tek duelet e mundësve në livazhd, sipas kategorive, grupmoshave dhe peshës. Miqtë u kërkonin organizatorëve të kampionatit ta vazhdojnë këtë traditë të bukur, duke premtuar se do të jenë përsëri në Ostren.

DASMA DHE MUNDJA, NJË BINOM I PANDARË

-Nga je?
-Nga Golloborda.
-A vazhdojnë ende dasmat me mundje...?

Janë pyetje që i kemi ndeshur të gjithë ne gollobordasit. Miq anekënd Shqipërisë, që për arsye të ndryshme kanë marrë pjesë në dasmat gollobordase, janë mrekulluar prej tyre, prej traditës që nis nga e hëna në mëngjes për t’u mbyllur të hënën tjetër, me përcjelljen e dasmorëve të fundit.

Dasma ka ritualet e saj, si çdo gëzim të tillë. Por disa tradita të zonës e hijeshojnë edhe më shumë dasmën gollobordase: Që nga marrja e bajrakut, i cili prin deri në përfundim të dasmës, dita e dridhit, e hallvës të përgatitur në shesh e që shpërndahet për të ftuar e të paftuar, e deri tek marrja e nuses, për ta mbyllur me mundjen.

Ja, pikërisht këtë episod monumental, që mblidhte dhe ende mbledh burra të zonës, jo thjesht për të shijuar emocionet e ndeshjeve, por dhe për ta garuar, të kujton kampionati tradicional i mundjes.

Në një marrëveshje me vetveten për të mos përmendur emra organizatorësh dhe mbështetësish të këtij aktiviteti tashmë të kthyer në traditë - pasi ata të gjithë janë për t’u falenderuar pa fund - mund të them vetëm se libri “Pehlivanët e Gollobordës” që i parapriu këtij aktiviteti, është një botim voluminoz, me shumë vlera, që risjell në kujtesë mundjen gollobordase, bashkë me kampionët e saj. Një hap i parë për t’u pasuar dhe pasuruar edhe më tej, e për të përfshirë brezat e ardhshëm e të talentuar të mundjes gollobordase, që nuk është vetëm e saj, por prej dekadash i përket Shqipërisë po aq sa edhe tabanit ku lindi.

Nuk ka patur në Gollobordë dasëm pa mundje. Nuk ka patur garë mundjeje që të mos mblidhte rreth vetes kampionët e saj, që vinin sa nga Kukësi e Shkodra, por aq dhe nga Tirana. Dasma dhe mundja ishin dhe janë ende një binom i pandarë. Edhe pse lëvizjet demografike pas viteve ’90 patën ndikimin e tyre, si kudo edhe në Gollobordë, disa fshatra të saj po përpiqen ta mbajnë gjallë këtë traditë të bukur. Optimizmi ndjehej thuajse tek të gjithë pjesëmarrësit, të enjten e 18 majit. Teksa ndiqnin dhe duartrokisnin garën e bukur të mundjes falenderonin organizatorët e këtij kampionati tradicional, që jo vetëm u risjellin emocionet e këtij sporti të ashpër në pamje të parë, por njerëzor kur e përjeton nga afër. Sepse për Gollobordën dhe gollobordasit, “dasma dhe mundja janë një binom i pandarë”.





Pehlivanët e Gollobordës

Nga HILË LUSHAKU
RAZI RAMA



Pehlivanët, mundësit e livadhit dhe ata të tapetit, janë djemtë e fortë të sportit burrëror, lindur e rritur në këtë krahinë me bukuri të shumta natyrore, por me plot vështirësi jetese. Kontradikta ndërmjet cilësive e vlerave të larta që kanë njerëzit e kësaj zone përkundër gjendjes së mjeruar të kushteve të munguara për një jetë normale dhe pa strese, na nxiti të gërmojmë e të pasqyrojmë vetinë e brendshme të gollobordasve...

Nisma e Shoqatës Sportive "Golloborda" për të shkruar librin "Pehlivanët e Gollobordës" bashkoi zemrat e shumë bijve të saj për të kontribuar me të gjitha mënyrat në pasurimin e përmbajtjes me të dhëna dokumentare dhe trashëgimi të vyer gojore që u është përcjellë brezave.

Zelli e përkushtimi i bashkëpunëtorëve të panumërt në këtë sipërmarrje rriti përgjegjësinë e autorëve për të përmbushur dëshirën e tyre, të përjetësojnë një pjesë të artë të traditës gollobordase në historinë e Shqipërisë dhe veçmas të mundjes "pehlivançe". Po kështu, duhej përçuar dëshira e tyre për të përcjellë mesazhin që kjo traditë të mos humbasë, përkundrazi të ruhet e forcohet në çdo gëzim popullor, në krahinë dhe kudo ku ka gollobordas, pavarësisht vendit ku banojnë. Me theks të posaçëm kjo shënohet në libër për përkujtimin vijimisht të saj në një periudhë që mund të bashkojë sa më shumë gollobordas në një prej qendrave administrative të kësaj krahine, duke respektuar e nderuar vijimisht mjeshtërit me kontribute në këtë traditë dhe bashkuar e miqësuar sa më shumë banorët vendas dhe ata që janë larguar prej trojeve të të parëve të tyre, por që kthehen aty me nostalgji, në respekt të kujtimit e nderimit të eshtrave në varret e tyre.

Teksa intervistonim personazhe të këtij libri, njëri prej tyre, Duro Ibrahimi, nga Ostreni i Vogël, u shpreh: "Ka ekzistuar një mentalitet përbuzës ndaj gollobordasve, shumë herë, ata, janë konsideruar si njerëz të dorës së dytë. Kanë qenë jeta e vështirë në atë zonë dhe shpirti i paepur i gollobordasve për mbijetesë që i nxiti të mërgonin, duke lënë gratë të vetme në shtëpi. Shpesh herë më ka rastisur të dëgjoj "...kam një gog Dibre në punë...".

Brenda këtij pohimi ka domethënie të madhe. Është fakt i pamohueshëm se gollobordasit janë njohur kryesisht për punët e vështira që kanë kryer, por filli i kuptimit të kësaj shprehjeje duhet të kalojë në vrimën e sitës së aftësive të njerëzve për punë të gjithëllojshme. Punët e vështira kanë qenë sipërmarrje të vullnetshme dhe të vetëdijshme, që u mësuan gollobordasve zanate që nuk i bën askush dhe i motivuan të punojnë e të mbijetojnë edhe në rrethana jo të volitshme. Duket se kjo i ka bëra ata të shquhen, si zezakët në botë, që janë kampionë absolutë në sporte që kërkojnë lodhje e sakrifica, sikurse janë boksi e atletika, ndryshe nga të bardhët që merren apo shquhen në sporte më pak të lodhshme dhe më tepër argëtuese, si golfi, lojërat me dorë, futbolli, pokeri etj.

Në thelbin e përmbajtjes së këtij libri janë pehlivanët, mundësit e livadhit dhe ata të tapetit, janë djemtë e fortë të sportit burrëror, lindur e rritur në këtë krahinë me bukuri të shumta natyrore, por me plot vështirësi jetese, prej mungesës së theksuar infrastrukturore për lëvizje dhe shërbime të tjera. Kontradikta ndërmjet cilësive e vlerave të larta që kanë njerëzit e kësaj zone përkundër gjendjes së mjeruar të kushteve të munguara për një jetë normale dhe pa strese, na nxiti të gërmojmë e të pasqyrojmë vetinë e brendshme të gollobordasve, atë veti që rrallë mund ta gjesh në ndonjë krahinë me kushte me përafërsi të tillë natyrore, klimatike, topografike apo vegjetariane. Kujtesa historike, e ruajtur me fanatizëm e dashuri dhe e përcjellë me kujdes, si dhe dokumentet burimore arkivore historike na zbulojnë se Golloborda është një trevë që ka gjurmë të ngulitura dhe me histori të pasur vlerash në gjirin e historisë së kombit e të shtetit shqiptar. Pa dyshim se është gjeni i veçantë i njerëzve, i cili, i plotësuar me vlera të tjera të spikatura, veçmas nga krahinat përreth, i shquan gollobordasit mbi të tjerët në mbijetesë dhe për punë, për respekt e marrëdhënie njerëzore të admirueshme në gjirin e tyre dhe me të tjerët, për ndjenjë sakrifice e triumfalizëm me optimizëm të çfarëdo lloj vështirësie në jetë, për përballimin me forcë të dhimbjeve e vuajtjeve, por dhe lumturimin pa fre e festimin dëfryes të papërshkueshëm të gëzimeve e ngjarjeve jetësore pozitive. Mjedisi gollobordas ka në palcë dashurinë për jetën, vullnetin për punën, mirësinë për të tjerët, optimizmin për përparimin, frymën e mirëkuptimit, guximin për të provuar e përparuar, bashkëjetesën harmonike, solidaritetin reciprok në rrethana të vështira. Të mëkuar në këtë ambient ambicioz vlerash humane, njerëzit në Gollobordë, natyrisht se do të gatuhen e kaliten për të kryer vepra të mira. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe edhe me pehlivanët, të cilët sikurse mjeshtërit gollobordas në fushat e tjera të jetës, edhe ata do të jenë të mbrujtur me të gjitha cilësitë sportive dhe pa dyshim edhe me shpirtin e paepur e me frymë luftarake gare të ndershme, duke u bërë të dallueshëm në përballjet cilësore me kampionë të mëdhenj. Gollobordasit e intervistuar pohojnë se sipas trashëgimisë gojore në breza, kjo krahinë është në rrugëtimin e ligjshmërisë kanunore të Skënderbeut.

Nuk mund të anashkalojmë apo të lëmë pa cekur në këtë parathënie edhe cilësi të vyera të gollobordasve, që krahas etjes për punë e zeje mjeshtërore, kanë spikatur edhe për frymën arsimdashëse të fëmijëve të tyre, madje këtu ata kanë qenë më të spikatur dhe më të përparuar se fshatrat e krahinave përreth tyre. Stebleva, Trebishti, Ostreni e Okshtuni janë shënuar si emblema të hershme të arsimit shqip. Në kujdesin e Hasan Moglicës, gjashtë normalistët e parë dibranë të shkollës normale të Elbasanit janë gollobordas dhe hapen shkollat e para shqipe në Luzni, Grevë, Lurë, Macukull, etj1. Nuk është për t'u çuditur se kjo cilësi e tyre ka ndikuar që Golloborda të ketë të regjistruar dy ministra të Arsimit, Shkencës e Kulturës në një hark kohor prej 30 vitesh2, gjë që nuk mund të gjendet as për ndonjë rreth të madh. Golloborda nuk ka djem të shquar vetëm për punët me mistri e peplumçe apo për duelet në livadhe e tapete. Ajo është një fidanishte kuadrosh elitarë, të përzgjedhur për aftësi të rralla në punët administrative dhe me kontribute në fusha të ndryshme, falë cilësive karakteristike që kanë në marrëdhëniet dhe punën në grup, në maturinë e përmbajtjen olimpike por edhe në energjizmin e brendshëm dhe shpirtin krijues e të paepur për kryerjen e punëve që u besohen. Gollobordasit, edhe pse janë prej "gjenit të dueleve" në mejdane sportive e livadhe argëtimi, kanë edhe një veti karakteristike që rrallë mund ta gjesh në mbarë krahinat shqiptare, atë të zgjidhjes me urtësi, mirëkuptim e paqedashje të konflikteve. Djemtë e kësaj krahine nuk e fshehin faktin se në kalitjen e cilësive më të vyera të tyre ka ndikuar krahas të tjerave edhe "nektari" i përzgjedhur në "lulet e livadheve të emigracionit", dëshmi edhe kjo e cilësive të tyre për përparim e kulturë, ku seleksionohen e mishërohen veti e vlera të popujve të përparuar. Nuk ka asnjë të dhënë dokumentare apo të trashëguar gojarisht që në këtë krahinë të ketë patur raste të konflikteve me armë zjarri, të ketë patur ndonjë rast që të jenë përdorur armët për gjakmarrje apo hakmarrje. Kjo frymë paqeje dhe pajtimi njerëzor manifestohet edhe pas ndeshjeve shumë luftarake, ku tifozëritë e zjarrta, rrëmbimet momentale, sedra e ambicia "fshatçe", përfundojnë në mirëkuptim e dashuri midis fshatarëve, shenjë e veçantë e burrërisë dhe pjekurisë së admirueshme në këtë zonë.

Gollobordës nuk i kanë munguar publikimet e as botuesit, madje nga studiues të spikatur që janë pinjollë të shquar të kësaj krahine, të cilët kanë prodhuar me shumicë botime ku paraqesin tablo shumëdimensionale, por vlen të evidentohet se i është mëshuar me forcë heroizmit luftarak, patriotizmit të zjarrtë e punës stërmundimshme kolosale ndërtimtare të vendit dhe shumë pak kësaj teme që kemi rrokur, e cila mbështjell brenda vetes një kurorë të artë lavdie, mbuluar gradualisht nga pluhuri i harresës e shpërfillja e kohës. Libri është si një udhëtim ngjarjesh e kujtimesh që mbartin histori mbushur me lavdi por edhe me mesazhe tradicionale e kulture, një bagazh dijesh praktike të ustallarëve gollobordas, pa arsimin e duhur tekniko-profesional, të cilët shkruan historinë e tyre në gur e në beton. Është mëkat që këtë pasuri, mbrujtur në gjakun e njerëzve fisnikë, që kryenin punë heroike por edhe fisnike ta lëmë në harresë, të mbulohet nga pluhuri i kohës. Gollobordasit nuk mund të jetonin vetëm në "liqenin e tyre natyror", midis kodrave e maleve, por si zgalemi në stuhi çanë përmes shtrëngatave oqeanike duke kërkuar jo tokën e premtuar, por punën mjeshtërore, që vetëm ata dinë ta kryejnë. Në këtë fragment zë vend përcaktimi i mendjemprehtit Mit'hat Frashëri, i cili duke folur për dibranët dhe gollobordasit përcaktoi: "...rrallë mund të shohësh njerëz të thjeshtë, analfabetë, me prirje të madhe për një mjeshtëri që kërkon mjaft inteligjencë dhe shumë studime paraprake...". Libri është strukturuar me 4 pjesë dhe secila prej tyre me disa kapituj, të cilët plotësohen me referenca të shumta burimore .

Pjesa e parë, titulluar "Golloborda-truall me diamante", ka dy kapituj, në të cilët prezantohet një vështrim i shkurtër gjeografik e historik i trevës dhe cilësohen vetitë karakteristike në shumë fusha, duke përmendur edhe protagonistë të shquar, në atdhetari, art, kulturë, heroizëm, besnikëri, siguri, mjeshtëri, politikë, mjekësi, biznes, sport etj.

Pjesa e dytë trajton "Mundja-traditë sportive e vyer në Gollobordë", ka 7 kapituj, në të cilën lexuesi do të gjejë një trajtesë për mundjen, për traditën e mundjes në Gollobordë dhe ritet e dasmës gollobordase, një përmbledhje rregullash të pashkruara për mundjen "vençe" në livadh, duke kulmuar me përshkrime e rrëfime episodike të këndshme të protagonistëve dhe shikuesve të mundjes në livadh dhe me listimin e mundësve sipas fiseve, përcjellë nga kujtesa e individëve. Në këtë pjesë zë një vend të rëndësishëm trajtesa dokumentare shteruese, referuar publikimeve zyrtare mediatike për sportin, nga viti 1946 deri në vitin 2002, nëpërmjet të cilëve plotësohen e saktësohen të dhënat e përmendura në kapitujt e tjerë dhe pasurohet më tej historia e mundjes në Gollobordë, Peshkopi e më tej edhe për shumë kampionë, të cilët "portretohen" me të dhëna koncize jetëshkrimore. Kjo trajtesë ka një vlerë të madhe dokumentare dhe mbi të gjitha shpluhuron harresën për kampionë të hershëm, jashtë Gollobordës, madje të shquar dhe kampionë në klube të mëdhenj sportivë.

Pjesa e tretë, titulluar "Nderimi i protagonistëve, përjetësimi i arritjeve e vlerave të mundësve" është strukturuar me 5 kapituj specifik, në të cilën ka trajtesë për shoqatën e mundjes "Golloborda", misionin e rolin e saj në nderimin e mundësve, ringjalljen e traditës së mundjes dhe mbështetjen e gjithanshme të ekipit të sapokrijuar "Golloborda", në mundje, nga fëmijët e deri në ekipin e të rriturve. Me interes dhe vlerë përgjithësuese e dokumentare janë edhe trajtesat për zhvillimin e aktiviteteve sportive tradicionale në vite, në Gollobordë, me theks kupa "Veli Muça", kupa Aziz Karasani dhe "Golloborda 2015" e "Golloborda 2016". Vlerësimet e kampionëve, trajnerëve dhe specialistëve të mundjes janë përmbledhur në kapitullin e fundit të kësaj pjese dhe janë shumë mbresëlënëse dhe me vlera për Gollobordën.

Pjesa e katërt është ilustrim me foto, me pak tekst, duke synuar të "flasin fotot", të cilat janë kontribut i protagonistëve, hulumtuesve dhe miqve të Shoqatës Sportive "Golloborda", duke rifreskuar kohërat dhe "ringjallur" eventet, kampionët dhe përjetësuar me pamje ato që janë hedhur me shkrim, në pjesët e tjera.

(Marrë nga libri me të njëjtin titull, botim i shtëpisë Botuese Mirgeeralb, Tiranë, 2017.)

"Shtegu i fjalës", libër i ri me poezi nga Islam Çenga

"Shtegu" që ndan **poezinë e vërtetë** nga vjershërimi amator

Nga **NAIM ZOTO**

Para disa muajsh, në prag të panairit kombëtar të librit, në studion e mikut dhe kolegut tim, Bujar Karoshi, do të njihja për herë të parë, njërin pas tjetrit, dy poetë. Fillimisht do të takoja aty Ahmet Prençin, të cilin, si njeri publik, e pata fiksuar përmes ekranit si "polic", si ish-drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Por kur miku ynë i përbashkët ma prezantoi si poet, madje duke më dhënë edhe një kopje të librit të tij, të sapobotuar, me titull "Udhë në pasqyrë", kjo nuk do të mbetej surpriza e parë. Ashtu si janë shprehur publikisht edhe të tjerë (B. Mustafaj, A. Tufa) që e kanë lexuar këtë libër, befasi për mua ishte cilësia e poezive të Ahmetit dhe jo qenia e tij një detyrë aq të lartë shtetërore. Dhe jam i sigurtë për një gjë: Ahmeti do jetë gëzuar më shumë në jetën e tij kur mori në dorë librin e tij të parë me poezi, sesa kur mori vendimin e emërimit në postin e lartë. Dhe këtu dallojnë poetët nga njerëzit e zakonshëm të kësaj bote, që, sa më shumë i largohet poezisë, aq më e vrazhdë dhe e mërzitshme bëhet.

Duke e ditur dobësinë time për poezinë, disa ditë më vonë, Bujari do të më prezantonte me një poet tjetër dibran, me Islam Çengën: "Ky është profesori i Ahmet Prençit", më tha Bujari, prezantim që unë e mora si referencë për librat. Islam Çengën nuk e kam njohur më parë personalisht, as si poet. Për më tepër, nuk i dija lidhjet mes tyre, përfshi edhe faktin që do e mësoja përmes faqes së I. Çengës në facebook, kur po e konsultoja për ta njohur më shumë këtë njeri. Ahmet Prençi shkruan aty për Islam Çengën: *"Është shumë i dashur për mua ish-mësuesi im dhe poeti i talentuar Islam Çenga. Poezitë dhe këshillat e tij më kanë ndjekur gjithë jetën"*. Ndryshe nga shumica e profesioneve të tjera të cilat përfitohen përmes edukimit, shkollimit, poezia më shumë konsiderohet si një mision (disa e konsiderojnë hyjnor, qiellor), se sa një profesion në tregun e madh të punës. Madje, janë gjithnjë e më të rrallë ata që e sigurojnë jetesën me këtë mjeshtëri. Shkurt, poet lind; nuk bëhesh dot.

I. Çengën dhe A. Prençin nuk besoj se i bashkon rastësia; vendlindja, katundi a qyteti, bindjet politike a sentimentet fetare, apo lidhje të tjera si raporti mësues-nxënës apo biznesi. Siç e thotë vetë në njërën prej poezive të tij Islam Çenga, të dy ata janë *"Njeri me fat poeti"*. Dhe kjo i bën të ndjehen superiorë jo në kuptimin e diktatit apo sundimit ndaj të tjerëve, përkundrazi. Duke qenë njerëz të urdhrit të shpirtit, të qiellit, pra, arkitektë të shpirtit njerëzor, poetët nuk lëndojnë, por ledhatojnë, nuk përfitojnë, por sakrifikojnë, nuk djegin, por digjen me misionin e qiririt, dritës. Ky është poeti sipas I. Çengës: *"Miku im,/ Ti vish një peliçe dimri/ Këpucë me këmbale ushtari/ Dhe dil në gjueti dhelprash, kunadhesh;/ Në të daltë një lepurush/ Mos qëllo;/ Në të daltë një ketër/ Mos shkrep armë;/ Në të daltë një dhi e egër/ Ndihmoje të ngjis shpatin e thiktë;/ Në të daltë një thëllëzë/ Mbylle njërin sy;/ Për pëllumba mbylli të dy…// Në ndodhtë kështu/ Anì pse nuk lexon poezi/ Anì, miku im, anì!"*. Poeti edhe në ditën e nisjes për në qiell mendon për tokën: *"Kam vënë shkallët për në Qiell/ Ti, në Tokën njerëzore njerëzisht jetoje çastin,/ Çastin që ka nevojë për hiret e tua"*.

Libri i ri me poezi i Islam Çengës me



titull "Shtegu i fjalës", botimet "Dita 2000", nuk është një libër i zakonshëm me vjersha, si ato që dalin rëndom nga shtypshkronjat si qoftet në zgarat e mejhaneve në "Rrugën e Kavajës". "Shtegu..." i I. Çengës nuk është as si kalamburet e kalamajve me diploma universitare të klubeve të "Bllokut" apo pensionistëve që nuk kanë ç'bëjnë dhe duan të ringjallin modën e bejteve. "Shtegu..." i I. Çengës është "shtegu" që ndan poezinë e vërtetë nga vjershërimi amator që përmbyt rrjetet sociale me "Like" hipokrizie dhe autolëvdata. Vargje të tilla nuk gjenden lehtë në poezinë e sotme: *"Ti, të dielën pastrove, lave/ Dhe sot është e hënë/ Dhe po vishem me të larat nga shiu i mbrëmshëm/ Me hekurosjen e yjeve fshehur nën pëllëmbë…"*.

"Shtegu i fjalës" është një libër plot ndjenja të shprehura me figura, imazhe dhe gjetje fine, të cilat përcjellin tek lexuesi përjetime, befasi dhe mendime të bukura. Fjalët çelësa që preferon autori janë: dallëndyshja (*shamizezat dallëndyshe*), kali (*jam Kalë*), qielli, era, plepi (*E mbaj mend si krihej në erë*), lumi, gjyshi *(Gardhi i thurur nga gjyshi po ha me dhëmbë thonjtë e mbetur)* etj. "Kënga e kalit" është gati një poemë për nga gjetja, bukuria e të shprehurit, por mbi të gjitha për mesazhet që përcjell: "*Unë jam kalë!/ S'ka errësirë për mua:/ Punoj në këmbë,/ Fle në këmbë,/ Pushoj në këmbë,/ Lind e vdes në këmbë,/ Ëndërroj në këmbë…/ Ëndërroj si kalë mbreti, imzot,/ Punoj si kalë druvari, imzot,/ Duroj si kalë tregtari, imzot,/ Flijoj si kalë beteje, imzot!// AT, DORI, HAMSHOR, IMZOT...// Jam kalë!/ Nuk kam pasuri/ As fëmijët e mi nuk kanë pasuri/ (Engjëjt nuk kanë pasuri, Imzot!)"*. Me pak fjalë, përmes simboleve dhe metaforave, kemi një histori të njeriut, të shoqërisë, kemi paradokset që sjell zhvillimi, teknologjia apo pabarazia. Poezia "Lumenjtë e shpirtit" është tronditëse: *"Pa brigje, pa ura, pa shtrat e pa rrjedhje,/ Thellë në shpirtin tim, lumenjtë pa emër;// ... Kërkoj një valë ngushëllimi për shpirtin,/ E sakaq mblidhen shamizezat dallëndyshe// Kërkoj të përkëdhel me shpirt një cironkë,/ Sakaq më vërsulen peshkaqenët..."*.

LUMENJTË E SHPIRTIT

Pa brigje, pa ura, pa shtrat e pa rrjedhje,
Thellë në shpirtin tim, lumenjtë pa emër;

Kërkoj një barkë shpëtimi për fjalën,
Më vjen në ndihmë një pyll i tërë;

Kërkoj një vend ankorimi për sytë,
Më hapet si Anteut,TOKA-NËNË;

Kërkoj një valë ngushëllimi për shpirtin,
E sakaq mblidhen shamizezat dallëndyshe;

Kërkoj një pikë ujë për të lagur lukthin,
E shtrydhen gjinjtë e borës në Alpe;

Kërkoj një velë të pagrisur për kurmin
Pëlhurë të mëndafshtë më thurin zogjtë;

Kërkoj një rimë për të ndalur plakjen
E të gjitha burimet më heqin nga një thinjë;

Kërkoj të përkëdhel me shpirt një cironkë,
Sakaq më vërsulen peshkaqenët...

TELEGRAM

Dielli perëndoi Pikë
Përshëndete nesër kur të lindë
në dritaren tënde Pikë
Do të jem aty Pikë
Vendosmërisht Pikë
Pafundësisht Pikë...

KLITHMA E GURIT

Macja e zezë po më ndjek si nata,
Si xhindi po më vidhet ky Ali Podrimja,
Mos, i dashur, me mungjira shkinjash,
Fushës së Kosovës nëpër brinja.

Me njërin sy të natës marr një sy gjumë,
Me tjetrin sy të ditës të ndjek nëpër gjurmë,
Në njërin sy të natës më del në ëndërr,
Në tjetrin sy të ditës je në zhgjëndërr.

O, Ali Podrimja, godit dhe me grusht
Veç mackën e zezë ma tërhiq zvarrë,
Fushës së Kosovës nëpër gusht,
Maleve të Sharrit në janar!

O, Ali Podrimja, qëndro, në je burrë!

Ndonëse autori ka jetuar e punuar në një nga zonat më periferike të vendit, në poezinë e Islam Çengës nuk rezulton ndonjë frymë periferike as në mesazhe, as në motive, madje as në teknika apo leksik. Poezia e tij ka origjinalitet dhe modernitet njëherësh. Lexoni, për shembull, poezinë "Portofoli": *"Në portofol /Kartëvizita nga shtëpitë botuese,/ Studiosh fotografike,/ Teknikë celularësh,/ Blerës mobiliesh të përdorura,/ Hidrauliku,/ Rrobaqepësi,/ Zhbllokues banjosh,/ Bojaxhinjsh,/ Berberësh,/ E pastaj... një kartëvizitë funerali/ (Edhe funeralet me kartëvizita!?)..."*.

Poetët e vërtetë dallohen nga amatorët a grafomanët sidomos në poezitë e ashtuquajtura të peizazhit ao të dedikuara. Janë bërë, për shembull, qindra poezi për vendlindjen, për Tiranën, për Pogradecin, Korçën apo Prishtinën, por shumë të rralla janë ato që mund të konsiderohen si gjetje apo këndvështrime origjinale. Në librin me poezi të Islam Çengës do të gjeni poezi për Tiranën, Prishtinën, Korçën apo Peshkopinë shumë të goditura jo vetëm për këndvështrimin, por sidomos për detajet poetike: Për Prishtinën, për shembull: *"Lind dielli në Kodrën e Diellit,/ Hëna nuk ka vend në Prishtinë,/ Hëna si një bukëls fshihet ferrave,/ Hëna astmatike nuk merr frymë.// Lind dielli në Kodrën e Diellit,/ Nata nuk ka qiell në Prishtinë,/ Nata vidhet maleve të Jutbinës/ Mbyllet si e marrë në çmendinë..."*. Për Korçën: *"I thatë Mali i Thatë,/ Mendjemadh e ngrefosur, si fyell i çobanit/ Midis dy gjinj-liqenesh... //Babush, Mali i Thatë,/ Me bastun' ere shkund manat nëpër natë,/ Devoll e Moravë;// Pastaj një serenatë.../ Në harem sulltanësh/ Digjet Mali i Thatë"*. Në poezinë më titull "Ndërrim motesh në Peshkopi" merr përparësi aspekti social i peizazhit: *"Këtë herë për Vitin e Ri/ Nuk ra borë në Peshkopi…/ Blirët, si gra të veja/ Nxisin zjarrin në vatra;/ Pa vellon e bardhë çatitë/ Dritaret pa qerpikë,/ Nën lëkurë mjegulle, kurrize oxhaqesh/ Ngrohin kësmetet e pakta,/ Si kurrize plakash.// Pa nur, pishat,/ Pa dantella, xhamat,/ Pa gjurmë, udhët,/ Pa lule, varret;/ Krejt potere gratë,/ Me krra-krra sorrash/ Kthejnë telfin e kafesë,/ Në djerrinën e fatit..."*. Dhe këto vargje të bukura për Tiranën thurur nga një dibran: *"Pas mesnatës Tirana flet me veten/ Duke krehur flokët në xhamin e Hënës,/ Era e lehtë me reçipeta mëndafshi/ Zbret si një hanëme nga sarajet e Dajtit"*.

Poezia e Çengës duket se nuk buron nga leximet, nga egoja apo maninë që ka çdo njeri për t'u shfaqur apo për t'u dukur; ajo nuk është një poezi e porositur, si është bërë e modës sot edhe në art. Poezia e tij lind sepse i vjen ora për të lindur, pasi është ngjizur diku a dikur përmes një kontakti direkt, jo përmes të tretëve. Ajo buron nga jeta, jo nga eteri, buron nga dhimbja dhe lind përmes dhimbjes, shpesh dramatike si dramat që lindin nga humbja, dhimbja, dilemat apo mungesat. Cikli i titulluar "Njëmbëdhjetë tregime për axhën Dik" është një poemth sa lirik, po aq i dhimbshëm që ka lindur nga dashuria dhe dhimbja për njeriun e thjeshtë, tek ai njeri që shumëkush nuk do të arrinte të dallonte asgjë poetike. Epo, prandaj, nuk mund të bëhen të gjithë poetë. Tek "*Tregimi III: Kishte një çadër shiu Axha Dik*" po shkëpusim disa vargje: *"Axha Dik kish një çadër/ Dalë boje si basma,/ Gjithnjë e mbante me vete/ Me vete në morte,/ Me vete në dasma…/ Axha Dik kish një çadër me ngjyrë të zezë si astari i natës"*.

Një libër me poezi të bukura dallohet nga librat mediokër edhe nga një fakt i thjeshtë: nëse lexuesi pas çdo vargu që lexon ndjen nevojën për ta cituar diku-r, për ta mësuar përmendësh krejt vjershën apo edhe ta ruajë mënjanë për ta rilexuar kjo don të thotë që kemi të bëjmë me art të vërtetë, jo kallp. Dhe kjo ndodh shpesh me librin e I. Çengës. Është një libër që besoj do ta nxjerr shpesh nga rafti im i rralluar i librave me poezi të epokës së tregut. Se *"Dy gisht qiell …më mjaftojnë për shtratin tim/ …për sytë jo!/ Ah, sytë e mi,/ Duan dyfish qiell!"*.

Tiranë, 26 maj 2017

Rruga e Arbërit nr. 133

15 -vjetori i shkollës jopublike “Sarina 2002”

portret

Liman Hoxha, *njeriu i punëve dhe jo i fjalëve*

Nga **SHAQIR SKARRA**



Fundi i pranverës erdhi mjaft i bukur dhe i veçantë për shkollën jo publike “Sarina 2002” . Viti shkollor po mbaron, matura e angazhuar totalisht për provimet e vetë e gjithë shkolla në festë. Një festë e madhe kolektive kjo që i ka kaluar përmasat e festave të zakonshme. Nuk paska nevojë për komision, protokoll e organizim. Çdo gjë shkon jashtë çdo lloj parashikimi. Kanë ditëlindjen e pesëmbëdhjetë të shkollës e ndaj janë bërë bashkë mësues, prindër e nxënës. Pesëmbëdhjet pranvera në arsim dhe dije nuk i thonë pak kur llogarit maturat e intelektualët që kanë dalë në këto vite nga shkolla “Sarina” ndaj bindesh plotësisht se kjo shkollë ka bërë një revolucion në arsimin shqip.

U desh ky përvjetor i shkollës jo publike “Sarina” e unë t’i kthehesha edhe njëherë portretit të administratorit të kësaj shkolle Liman Hoxhës.

Kam patur fat që me Limanin të njihem herët. Fshatrat tonë janë afër, kufitarë me njeri tjetrin e një përrua i keq në stinën e dimrit me reshje të mëdha na ndan.

Babai i Limanit, Vexhiu, ndjesë pastë njihej mirë në fshatin tim, njihej si burrë i mirë, i drejtë, bujar e mjaft fetar. Njihej në fshatin tim edhe vëllai i Limanit, Ramazani i cili punonte si veteriner në ish Ndërmarjen bujqësore, edhe ky ndjesë pastë pasi humbi jetën në një aksident vite ma parë.

Limani në ato vite i ri por gjithë ëndra e dëshira të mëdha për jetën. Kishte ambicie për të bërë gjëra të mëdha por as vendlindja nuk ia jepte këto mundësi dhe as periudha e asaj kohe .

Në vitin 1989, Limani së bashku me vëllezërit shkëputet nga vendlindja e tij e dashur Blliçe e vendoset me banim në Tiranë për një jetesë më të mirë por edhe me realizuar ato që kishte ëndërruar vite më parë.

U deshën vetëm pak kohë që të triumfonte demokracia ku u hapën dyert edhe për ata të rinj e të reja që thurnin ëndra të bukura natën e nuk kishin mundësi ditën t’i realizonin.

Në fillim filloi të merrej me tregëti e cila i krijoi mundësi për të investuar edhe më shumë. Dëshira e Limanit ishte të hapte një kopsht e një shkollë fillimisht për fëmijët e dibranëve që banonin në Tiranë.

Ndërtimi i një vepre të tillë nuk erdhi rastësisht. Limani u thoshte shpesh vëllezërve : “Na ka lënë një amanet baba: Kush ndërton një shkollë, ka ndërtue një xhami. Ne jemi një familje që e kemi dashur arsimin. Kjo zonë ka nevojë për një shkollë. Pse të mos investojmë në arsim!?”.

Kaq u desh dhe Liman Hoxha një mëngjez u drejtua për në Ministrinë e Arsimit, ku titullari e priti me dashamirësi dhe i premtoi gjithë mbështetjen e dikasterit. Me paratë e fituara, ai mund të hapte një biznes tjetër, nga ku mund të fitonte dhe më shumë, por amaneti i babës së tij, imam Vexhi Hoxhës, do të bëhej realitet vetëm 3 vjet pas vdekjes. Vexhi Hoxha ishte ndër nxënësit e parë të Internatit të Kastriotit, madje ka qëndruar në një bangë me aktoren e madhe dibrane, Besa Imami. Imam Vexhiu nuk u nda nga librat deri në momentet e fundit të jetës së tij. Sot në shtëpinë e Limanit është një bibliotekë e pasur me libra, që ka lexuar në vite Vexhi Hoxha. Kjo edukatë dhe dije që kishte përfituar në Internat, bëri që ndjenjën për arsim dhe kulturë ta kultivonte dhe tek djemtë, të cilët të gjithë u diplomuan.

Të gjithë ata që e njohin dhe që e kanë njohur Liman Hoxhën, flasin me plot respekt për të. Por ajo që zotëron tërë qenien e tij është guximi dhe iniciativa “e çmendur” për të ndërmarrë iniciativa të mëdha, që për shumë njerëz dukeshin ëndrra të pa realizuara .

Limani në fillim e nisi me një kopësht, pastaj hapi shkollën jo publike “Sarina 2002”, me një emër tepër njerëzor, duke bashkuar germat e fëmijve të tij dhe tashmë ka hapur dhe shkollën e mesme të përgjithshme, të profilizuar. Dhe kishte besim në vetvete se e ardhmja do të flasë krejt ndryshe. Limani edhe pse sivjet feston bashkë me kolektivin e shkollës 15 vjetorin e kësaj shkolle jo publike përsëri ka ambicje në fushën e arsimit, kërkon më shumë nga vetja dhe asnjëherë nuk kënaqet me aq sa ka arritur ku edhe pse shkolla radhitet ndër më të mirat në të gjithë Qarkun e Tiranës. . Megjithëse investimi në arsim është një biznes human, elitar Limani është i bindur se duke investuar bindshëm bëhet më i dobishëm për Dibrën dhe dibranët.

Shtatëdhjetë vite më parë, etja e dibranëve për t’u arsimuar u kurorëzua me sukses me hapjen e Internatit të Kastriotit, ku nga bangat e saj dolën shumë personalitete të shquara të kombit shqiptar. Dhe ja para pesëmbëdhjetë vitesh Liman Hoxha do të përsëriste të njëjtën histori, por tashmë jo në fshatin Kastriot, ku u hap Internati, por pikërisht në kryeqytetin shqiptar, ku ka shumë dibranë. Madje, ky bir nga fshati Blliçe pinjoll i një familje arsimdashëse, jo shumë larg fshatit Kastriot, ku u ndërtua Internati, është i pari biznesmen nga trevat tona, që hapi një shkollë të tillë në Tiranë.

“Do të hap dhe një Universitet. Ky duhej të ishte ndërtuar në Dibër, por tani dhe unë djalë dibre jam dhe do ta hap në metropolin shqiptar”. Dhe Liman Hoxha si njeri me vullnet dhe kurajo nuk ka dështuar asnjëherë.

“Do të hap dhe një Universitet. Ky duhej të ishte ndërtuar në Dibër, por tani dhe unë djalë dibre jam dhe do ta hap në metropolin shqiptar”. Dhe Liman Hoxha si njeri me vullnet dhe kurajo nuk ka dështuar asnjëherë.

Limani është krenar për veprat e mëdha të dibranëve. Duke qenë se është shumë i pasionuar pas historisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas historisë së popullit të Dibrës, ai ndjehet tepër i lumtur për ata që kanë lënë paraardhësit e tij, por ai dëshiron që brezat e nesërm të krenohen me veprat që do të lëmë ne sot. *Të mburremi me atë që bëjmë ne, jo me ato që bënë të parët tanë.*

Ndaj, mesazhi i tij është: “Çdo dibran, kudo që ndodhet ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve, përmes veprave me vlerë që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Mjaft dibranë kanë bërë emër edhe jashtë trojeve tona. Ne kemi vlera. T’i ruajmë pra ato, të mos i humbasim. Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën”, -përfundon ai.

Liman Hoxha ka lindur në fshatin Blliçe, në një familje me dije dhe kulturë, nga e cila ka përfituar shumë dhe Limani. Në vitin 1989 mbaron Shkollën e Mesme “Myslim Shyri” në Fushë-Çidhën. Në vitin 1989-1990 mbaron kursin e Ushqimit në Tiranë. Më 1990-1993 punon në Gardën e Republikës së Shqipërisë. Pas kësaj kohe është marrë me tregti, duke qenë mjaft i suksesshëm. Në vitin 1999 emigron në Angli për t’u kthyer në atdhe në vitin vitin 2001 dhe në vitin 2002 hapi dyerët shkolla Jopublike “Sarina 2002”. Është i martuar dhe ka dy vajza dhe një djalë, Sarën, Rominën dhe Samelin. Janë pra bashkimi i germave të fëmijve të tij, që është emërtuar shkolla”Sarina”, një emër tashmë që ka krijuar identitetin e saj. Dhe sot në pesëmbëdhjet vjetorin e shkollës “Sarina” Limani i kthehet kujtesës.

– E nisa para pesëmbëdhjetë vitesh me 53 nxënës gjithsejt e me ambjente të pakta, afro 240 metra katror, - nis e tregon Limani, - por pa menduar se ja sot do të arrija këtu ku jam. Në fillim kishim 6 mësues, ku drejtoreshë ishte Rudina Maksuti e nëndrejtor Mentor Hoxha.

Në këto pesëmbëdhjetë vjet shkolla jo publike “Sarina”, nuk është ajo e vitit 2002 me 53 nxënës, por ka shtatëqind e ca nxënës. Nuk ka 240 metra katror, por ka gjithsejt 4000 metra katror ndërtim, si dhe po 4000 metra katror oborr, palestër, fushë futbolli etj. Sot nuk kemi vetëm gjashtë mësues, por kemi një personel prej shtatëdhjet vetash. Nga maturat e shkollës “Sarina” po thuaj të gjithë kanë vazhduar studimet e larta, përjashto ndonjë rast të rrallë ku thjeshtë për arsye ekonomike nuk kanë dashur vetë.

Limani zakonisht flet pak për vete por më shumë flet për shokët, kolektivin e mësimdhënjes në shkollën “Sarina” për nxënësit e talentuar, për prindërit e shumtë që zgjedhin këtë shkollë për të arsimuar fëmijët e tyre, dhe ndjehet borxhli karshi tyre që i kanë besuar arsimimin dhe edukimin e fëmijëve. Dhe Liman Hoxha, njeri punë shumë fjalë pak nuk i ka zhgënjyer e nuk do t’i zhgënjejë asnjëherë.



arsim

Shkolla e Sarinës vjen në 15 vjetorin e saj me një bilanc të pasur suksesesh e arritjesh që përbëjnë një përvojë mjaft pozitive, bazë për rezulate më të lartë në të ardhmen.

Rruga 15 vjeçare e shkollës "Sarina 2002", një histori suksesi

Nga **ZABIT LLESHI**

Me pasionin për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Mëzes Fushë, Z.Liman Hoxha hapi Shkollën 9 Vjeçare Jopublike "Sarina 2002", me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.300, datë 14.10.2002, ndërsa për funksionim e gjimnazit "Sarina 2002" leja u dha me urdhër nr.162 me datë 09.06.2005 nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Emri "Sarina"vjen si fryt i bashkimit të emrave të fëmijëve të Presidentit të shkollës Liman Hoxha: Samel **(Sa),** Sara **(Sar),** Romina **(Ina)**.

President i shkollës është Liman Hoxha. Familja Hoxha është nga fshati Blliçe i Çidhnës në rrethin e Dibrës, patriote e arsimdashëse brez pas brezi. Vexhiu, babai, kishte marrë kulturë orientale pas mbarimit tëInternatit të Kastriotit dhe shërbente si imam në fshatrat e Çidhnës. Katër djemtë e tij u shkolluan në degë e profesione të ndryshme. Kështu, Ramazani mbaroi Universitetin Bujqësor në degën zootekni, Haliti për ekonomi në Universitetin e Tiranës, Shefqeti mbaroi arsimin e lartë ekonomik, Limani ekonomi-biznes në Universitetin Bujqësor Përveç punës, ata ishin të apasionuar pas sportit kryesisht atij të mundjes si sportistë cilësorë të Klubit "Korabi".

Ne vitii 1985 vëllai i Limanit, Haliti u largua nga Dibra dhe u sistemua me banim ne Tirane. Në vitin 1989 erdhi e gjihe familja dhe u vendosen me banim në Mëzes Fushe, njësia ad.13 Tiranë, duke krijuar marrëdhënie mjaft të mira me banorët vendës. Ekonomia e tregut u hapi horizonte të reja vëllezërve Hoxha. Të bashkuar, ata punonin kudo, provuan edhe emigracionin. Limani la punën në Gardën e Republikës si nën/oficer dhe emigroi për dy vjet qënrdroi në Angli. U kthye nga Anglia me dëshirën për hapjen e një biznesi. Kishte ëndërruar një kopsht privat dhe iu fut punës për ta bërë realitet. Në një ndërtesë të thjeshtë, por i vendosur e me vullnet e nisi punën me 53 fëmijë dhe 6 punonjës. Fillimi i mbarë gjysma e punës.

Në këtë 15-vjetor shkolla Sarina vjen me një bilanc të pasur në fushën e arsimit dhe edukimit. Ajo është ndër shkollat më të mira publike në Qarkun e Tiranës. Sarina lindi si domosdoshmëri për disa arsye: Shtimi i shpejtë i popullsisë në Mëzes Fushë; Mungesa e shkollave publike në këtë zonë; Nevoja për uljen e ngarkesës në shkollat publike (mësimi bëhej me tre turne).

Pasioni, vullneti, këmbëngulja, puna e palodhur e Presidentit të saj Liman Hoxha i cili bashkë me mësuesët arriti në këto nivele që shohim sot. Brenda një kohe të shkurtër bëri tëmundur që shkolla të sigurojë laboratorin e kimisë, të fizikës, të biologjisë, kabinetin e gjuhëve të huaja dhe atë të informatikës. Shfrytëzimi me kriter i kësaj baze materiale ka bërë që të realizohet programi mësimor në sasi dhe cilësi.Për edukimin fizik është ngritur një park sportiv ku zhvillohen lojrat sportive si futbolli, basketbolli, hendbolli, volejbolli, një ambient që kryen funksionin e një palestre për gjimnastikë, aerobi, ping-pong, shah etj.

Në vitin shkollor 2016-2017 në shkollën Sarina janë regjistruar dhe frekuentojnë rregullisht: kopësht + 9-vjeçare 405 nxënës, 158 femra, në shkollën e mesme 205 nxënës, 127 femra, japin mësim 37 mësues, 29 femra.

Në 15 vjet, numri i nxënësve është rritur afërsisht 12 herë kurse ai i mësuesve 9 herë.



Mësuesët janë të gjithë me arsim të lartë, me master e kualifikime tëtjera pas universitare, 17 prej tyre janë mjeshtra. Në funksion të shkollës janë angazhuar 70 punonjës bashkë me mësuesët dhe administratën.

Shkolla jo publike është biznes elitar por kjo nuk e ka penguar Presidentin, drejtorin e shkollës dhe mësuesët të punojnnë me përgjegjësi, me përkushtim e pasion për të realizuar detyrat që shtron sistemi ynë arsimor para shkollës. Ajo është një vlerë e shtuar në shkollat dhe arsimin tonë, një fidanishte e edukimit të brezit të ri.

Drejtorët e shkollës, Besim Toçi, ish mësues në gjimnazin e Peshkopisë, drejtor për rreth 11 vjet, Bexhet Aga, ish drejtor i gjimnazit Peshkopi, Qazim Karaj ish shef i Kabinetit Pedagogjik Burrel, inspektor në Drejtorinë Rajonale të fshatit Tiranë, drejtori aktual Halil Begu ish drejtor i gjimnazit, kryeinspektor dhe drejtor i Zyrës Arsimore Bulqizë, kanë meritën për rezultatet e larta dhe të qëndrueshme në rritjen cilësore të procesit mësimor e edukativ, për plotësimin e detyrave që shtron koha dhe shoqëria përpara shkollës sonë.

Tregues tjetër për rezultatet e mira të Sarinës ka qenë kualifikimi i mësuesve. Ata merren në punë pas një testimi duke pasur parasysh përvojën, eksperiencën pedagogjike, rezultatet në shkollat ose rrethet nga vijnë. Rudina Maksuti, Mentor Hoxha, Hajrie Hoxha, Marsela Bardhollari, Viktor Gjini, Bardha Qari, Shazivar Koka, Nafis Topi, Katerina Gjikola, Raimonda Çeço, Elona Goxhaj, Tatjana Miftaraj, Rushit Begu (ish zëvëndës drejtor) ndihmuan me kontributin e tyre shkollën tonë – thotë Liman Hoxha. Shumë të tjerë vazhdojnë të derdhin djersë pa u lodhur si Shkëlqim Salillari, Fadil Vukaj, Shkëlqim Çollaku, Zyrie Zavalani, Miftar Veliu, Ledio Nuro, Flogerta Banaj, Albana Muça, Ndue Kolndreu, Sabajet Likrama, Afërdita Beshi, Skënder Hidri (zëvendës drejtor), Klodiana Jaupi (zv. dr. në Shkollwn e Mesme), Brikena Hoxha (zëvendës drejtore e Ciklit të ulët) etj. Shembulli i tyre, përgatitja pedagogjike, puna e diferencuar, kompetenca metodiko-shkencore, kërkesat në rritje për forcimin e disiplinës kanë çuar në rezultate gjithnjë e më të mëdha duke i dhënë shkollës një emër të mirë e të respektuar, tashmë edhe të lakmuar. Ajo si Institucion është bërë i njohur dhe njëkohësisht shumë i kërkuar. Kjo shihet në fillim të çdo viti nga kërkesat e mëdha për regjistrime.

Në ballafaqimet me shkollat e kryeqytetit në olimpiada e konkurse të ndryshme janë fituar trofe e vende nderi.

Fitues të olimpiadës së matematikës: Taulant Prençi, Gerald Osmani(2008), Egzon Cakraj(2010), Sara Hoxha(2011), Fatjon Veliu(2012).

Në letërsi: Lunada Methasani, Seleme Përzhilla, Arlinda Çera, Irina Dauti, Hygerta Duka.

Në gjuhën angleze: Blerta Hoxha, Valentina Marta.

Në fushën e inovacionit: Romina Hoxha, Taulanta Selja.

Në kimi Ersi Spahia, në biologji Sindi Shima. Në aktrim Sara Hoxha u shpall aktorja më e mirë në vitin 2011 midis 90 shkollave 9-vjeçare të Qarkut.

Nga viti 2009 matura e parë, deri më 2017 kanë mbaruar 605 nxënës. 95% kanë vazhduar arsimin e lartë.

Nxënësit e shkollës Sarina i gjejmë jo vetëm në auditorët e universiteteve të vendit tonë por edhe në vende të tjera si në Amerikë ku studjojnë Eda Stafa, Eduard Doda, Elona Peçi, Besjana Loka; në Gjermani Fatjon Murati, Gëzim Muslia, Kledia Hoxha, Jonada Hoxha, Jonida Tafçiu; në Kanada Seit Sorra; në Itali Lirdi Hasanaga, Elda Kosova; në Turqi Renata Picari, Ersilda Aga. Gjatë studimeve ata janë paraqitur me dije të qëndrueshme. Rezultatet e larta që kanë marrë në studime tregojnë se ato nuk janë vetëm krenaria e shkollës tonë por janë edhe pjesë e krenarisë kombëtare.

Në shkollën Sarina zhvillohet një aktivitet i gjërë kulturoro-artistik e fizkulturoro-sportiv me objektiv pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në këto veprimtari. Në kuadrin e shkollës janë të shumtë konkurset në gjuhë, letërsi, histori, matematikë, fizikë, biologji, i zërave të rinj, i piktorëve të vegjël që përfundojnë me festën e abetares së klasave të para në muajin maj të çdo viti shkollor.

Ajo ka një bibliotekë të pasur, jo vetëm me libra e revista që u duhen nxënësve gjatë procesit mësimor sidomos në gjuhë e lexim por edhe librin artistik e atë shkencor.

Arritjet e shkollës në këta 15 vjet janë pasqyruar në stendat e muzeut. Azem Tetën e gjetëm në punë për rifreskimin e pasurimin e tij. Ai ka shumë vite që punon këtu si edukator por edhe si drejtues i veprimtarive kulturore e artistike. Repertorët e shfaqjeve, montazhet muziko-letrare, konkurrimet midis klasave dhe shkollave janë vlerësuar në përmbajtje me nivel të lartë artistik, tematikë të gjërë dhe të larmishme. Ndihmë të veçantë kanë dhënë mësuesët Shpresa Gjoka, Sonila Totraku, Elenika Kavaja, Arta Kaca, Myrvete Thimio etj. Midis nxënësve shquhen Igla Morina, Griselda Damsi, Marsela Elezi etj.

Edukimi Fizik dhe sportet zënë një vend të veçantë. Veprimtaritë sportive janë të përditshme. Punohet me moton çdo nxënës të merret me një lloj sporti. Sipas moshës zhvillohen garat e atletikës, gjimnastikës, lojrat sportive, tërheqje litari, lojrat popullore, ping-pong dhe shah. Mjaft të rinj stërviten me ekipet cilësore të kryeqytetit. Aurela Hoxha mjeshtre sporti në gjimnastikë, anëtare e ekipit kombëtar ka ndihmuar në promovimin dhe rritjen e dashurisë për gjimnastikën sidomos tek vajzat. Alban Çejku futbollist, është anëtar i ekipit kombëtar Shpresa U17. Futbollistë cilësorë janë edhe Mikel Bralika, Hamdi Picari, Petrit Selmani, Neritan Përzhilla, Arbër Matranxha, etj. Yrgen Përzhilla dallohet në sportin e karatesë, në not Grejsi Koxhaka, në shah Elton Dega, AlbanaSelaj, Oksana Vatishevetj.

Kjo shkollë po e çon më përpara traditën e deritanishme me një dukuri të re, atë të ditës olimpike që është finishi i veprimtarive gjithë vjetore 6 prill (dita olimpike).

Në ditët e fundit të muajit prill 2017 në Universitetin Epoka u zhvillua kampionati i shkollave të mesme në futboll me 32 skuadra të qyteteve Tiranë, Durrës, Gjakovë dhe Bosnje. Skuadra e Sarinës u paraqit mjaft mirë duke zënë vendin e katërt, një sukses i merituar që e rradhit sportin me fituesit e lëndëve të tjera të shkollës Sarina. Padyshin një punë sistematike e me pasion kanë realizar mësuesit e edukimit fizik, Sulë Beqiri, Shazivar Koka, Nafie Lleshi etj.

Në ambiente të posaçme me një rregull, pastërti e kulturë, shkolla Sarina siguron shërbime sociale për nxënës e mësues, bashkë me ambientet e çlodhjes dhe të pushimit në kohën e lirë.

Me merak është punuar për gjelbërimin. Pemët dekorative kanë krijuar një mjedis ku ke dëshirë të punosh me pasion, vullnet e kënaqësi.

Ruajtja e dokumentacionit është prioritet i Drejtorit të shkollës dhe Presidentit. Zonja Fatmira Veliu mban gjithë dokumentacionin për të cilin tregohet një kujdes i veçantë. Ajo bashkë me mësuesët kujdestarë mban lidhje të vazhdueshme me prindërit për përparimin dhe sjelljen jo në fund të muajit e vitit por brenda javës e çdo ditë. Drejtoria e shkollës së bashku me Presidentin organizojnë shpesh mbledhje me prindërit gjë që përbën njërën prej hallkave të suksesit të kësaj shkolle. Pranë sekretarisë mund të sigurosh fotokopje të materialeve të ndryshme që u duhen mësuesve e nxënësve për detyrat me shkrim, anketat, konkurset deri tek shërbimi i urgjencës mjekësore.

Transporti i nxënësve nga familja në shkollë dhe anasjelltas kryhet me autobusë të përshtatshëm e komodë. Ata nuk varen administrativisht nga shkolla por si rezultat i një komunikimi mjaft të mirë me Presidentin, nuk ka pasur asnjë problem shqetësues. Nëpërmjet transportit shkolla ka zgjidhur edhe realizimin e disa projekteve mësimore si ekskursione në vende historike e turistike në shërbim të programeve që hartohen për këtë qëllim.

Gjatë muajit maj është krijuar traditë që nxënësit e Sarinës sipas klasave të shkojnë në Pezë, Kepi i Rodonit, Prezë, Apolloni, Pogradec etj., ndërsa maturat kanë realizuar eskursione me itinerar më të gjatë në qytetet kryesore të Shqipërisë, në Itali, Kroaci, Turqi, Kosovë etj.

Shkolla e Sarinës vjen në 15 vjetorin e saj me një bilanc të pasur suksesesh e arritjesh që përbëjnë një përvojë mjaft pozitive, bazë për rezulate më të lartë në të ardhmen. I urojmë suksese gjithnjë e më të mëdha në realizimin e detyrave që shtron koha dhe shoqëria para shkollës. Tradita vazhdon...



Rruga e Arbërit nr. 133

botime

**Nuk është rastësi që nga kritika letrare,
emri i Naim Plakut si poet kënge, radhitet përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës...**

Vepra e **Naim Plakut**, një **testament** fjale

Nga **HALIL RAMA**

Katër dekada pas ndarjes nga jeta të autorit të poemës së famshme "Bagëti e Bujqësi", lindi një tjetër poet i talentuar, me të njejtin emër. Jo në Frashër të Përmetit, por në Sllatinë të Dibrës.

"Data shënonte 14 nëntor 1940. I jati, Shemsiu ishte në punë e vonë, kur u kthye, e mori vesh se ishte shtuar me një djalë.... Emri Naim ishte emër i librave. Nxënësit e shkollave, ato që kishin pak klasë, e njihnin këtë emër. Ishte Naim Frashëri i Rilindjes sonë Kombëtare. Nxënësit e mësonion nëpër shkolla e të rriturit e kishin lexuar. Edhe në shkollën e Sllovës kishin mësuar e recituar poezitë e tij. Shemsiu pothuaj i kishte lexuar të gjitha poezitë e tij të botuara. Djalit që lindi këtë natë nëntori, ia lanë emrin naim. 'E gëzoftë! – u dëguan urimet nëpër kullën që ishte mësuar të priste e të përcillte miq të shumtë, të ftuar e rrugëtarë të ndryshëm…".

E nisëm me këtë perifrazim të autorit të librit më të ri "Dritëhijet e një poeti", të shkrimtarit të njohur Shaqir Skarra, për të bërë një analogji të dy Naimëve, poetë, që ngjasojnë shumë në jetët dhe veprat e tyre.

Nëse rilindasi i shquar rridhte nga dega e Dakollarëve ose e Dulellarëve e Familjes së shquar Frashëri, edhe Naim Plaku, ishte pinjoll i një fisi emërndritur në Sllatinë, nipi i "gjeneralit me shajak" Elez Isufi.

Nëse Naim Frashëri u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat "Gjuha shqipe", "Korçës" 1887, etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut ("Bagëti e bujqësia") dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij (krijime të ndryshme, "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve"), në shekullin që lamë pas, vepra e Naim Plakut, është një testament fjale.

Dhe siç shprehet autori në monografinë "Dritëhijet e një poeti", Naim Plaku, që e konsideronte poezinë si një "zanë mali, por kryeneçe", me mjeshtri të rrallë e ledhatoji, e përkëdheli dhe pastaj u dashura pas saj. U dashurua me poezinë që në fëmijërinë e tij, kur qau për "dhinë pikaloshe që ia hëngri ujku" dhe për "mushkën, që ia hodhi ngarkesën të gjithën në tokë, ngaqë nuk e kishte ngarkuar mirë". Janë këto detaje nga fëmijëria e një nxënësi që shkëlqente në të gjitha lëndët, në gjuhë e lexim, në aritmetikë e gjeometri, në histori e gjeografi, në kimi e biologji...Ngaqë mbante sy e vesh te shpjegimi, si rrallë nxënës, por edhe ngaqë tek kulloste bagëtinë apo dhe kur shkonte për dru në mal, me vehte kishte edhe trajstën me libra. I tillë do të ishte ai edhe në në fidanishten e mësuesisë, siç njihej Shkolla e mesme Pedagogjike e Peshkopisë, për përfundimin e së cilës, babait të tij, Shemsi Plakut iu desh të shesë pothuaj të gjithë bagëtitë. Por edhe në Universitet, tek do të përballej e trimfonte me pedagogun e sintaksës që "dhjetën" e konsideronte pronë të veten. Ishte pikërisht N.Plaku, ndër studentët e paktë që me zotësinë e talentin e tij të rrallë e theu këtë tabu të pedagogut zemërngurtë, ashtu siç sfidoi në vitet e dekadat e jetës së tij të gjithë nihilistët e mediokrit që i shërbyen me zell sistemit të diktaturës.

Këto e të tjera detaje jetësore për këtë poet të këngës, e bëjnë më të dashur për lexuesin këtë vepër dinjitoze të publicistit, studjuesit dhe analistit tashmë të njohur, Shaqir Skarra. Me mjeshtri të rrallë ai ka ditur të "shfrytëzojë" arkivën e pasur që la si trashëgimi, poeti i këngës, Naim Plaku. Nuk është rastësi që nga kritika letrare, emri i Naim Plakut si poet kënge, radhitet përkrah



Gjokë Becit e Lefter Çipës. Këtë, përveçse autorit të monografisë "Ditëhijet e një poeti", e pohojnë edhe emra të spikatur të letrave shqipe, që e kanë studjuar hollësisht veprën e Naim Plakut. Kjo edhe për faktin se tekstet e Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat më presitigjioze të botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: "O prite Azem Galicën", "Një gërshët u la me gjak", "Na knojnë pushkët nëpër kulla", "O i madhi Skënderbe", "Përcolla ylberin", "Mine mori Mine", "Tinguj krenarie", "Fluturo shqipe ka kalaja", etj.

"Naimi u bë gjuhëtar, punoi shumë për të, mblodhi fjalë të rralla jo vetëm të krahinës, por edhe jashtë saj...Naimi truppakët, çapitej nga Fushë Alia në Shumbat, nga Cereni në Slllovë e nga Sllova në Gollobordë...Ai çliroi shpirtin, duke tjerrë zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi jo vetëm nga gjuha e mësuar e shkollës, por edhe në odat e kullat dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit e oshëtima e Korabit, duke i shikuar këto nga shpirti i lirisë...Pas mësimit, gjatë udhëtimeve do të nxirrte bllokun e do të shkruante toponime e mikrotoponime. Për to pyeste qoftë dhe një çoban që ishte me bagëti....Gjeti ninullat e bukura të djepit e shprehjet frazeologjike, të përdorura aq bukur në këto anë. Përpara se ti hidhte në bllok, këngë qoftë apo shprehje gjuhësore, kërkonte burimin. Kështu ai ra në gjurmë të ciklit të këngëve të Korabit, mblodhi këngën e Ymer Agë Ulqinit, "Motra me nantë vllazën", "Balada e Rexhës" e dhjetra të tjera...I mori këto këngë nga goja e popullit, ua hoqi pluhurin dhe i bëri pronë të të gjithëve për të mbetur visare të folklorit shqiptar". Mjaftojnë qoftë edhe këto perifrazime të shkëputa nga faqe të ndryshme të veprës së Sh.Skarrës "Ditëhijet e një poeti", për të konkluduar në punën e mirëfilltë studimore e shkencore që ai ka bërë për të na e sjellë në mënyrë sa më origjinale madhështinë e profilit krijues e njerëzor të Naim Plakut.

Poeti që përjetoi skajshmërisht përndjekje, ishte vërtetë një poet i përmasave të spikatura. Në monografinë e sapobotuar nga Shtëpia Botuese e mirënjohur tashmë MB, evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku brenda konstruktit poetik të poezive të tij që shkrihen në kodet

Qoftë edhe me një vështrim sporadik të veprës "Ditëhijet e një poeti", lexuesi do të mrekullohej me "rrëfimet nga ditari", të cilat autori Sh.Skarra ka patur fatin t'i ketë në dorë dhe prej tyre të përveçojë nektarin e veprës shumëdimensionale të Naim Plakut. Dhe jo vetëm kaq, por shkrimtari e studjuesi Skarra, sjell risi në "Raportet e Naimit me veprën", duke i parë ato në një kontekst të gjerë, në fushën e gjuhësisë e letërsisë, por edhe duke na e paraqitur Naim Plakun si një figurë të shquar të folkloristikës tonë, si skenarist dhe libretist.

nëntekstuale, të shartesave të kumteve dhe përcjelljeve të folkut. Kjo edhe për faktin se në poezinë e tij, Naim Plaku i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, maturia, etj. Këto, më së miri i gjejmë në veprat poetike të N.Plakut "Fllad e frullizë", "Kreshtat e Korabit" dhe "Trëndafila mbi mermer". Por vitet e fundit botimet e tij po lexohen e po pëlqehen nga publiku, sidomos "Krojet e zanave" e "Folklor nga viset e Dibrës".

Qoftë edhe me një vështrim sporadik të veprës "Ditëhijet e një poeti", lexuesi do të mrekullohej me "rrëfimet nga ditari", të cilat autori Sh.Skarra ka patur fatin t'i ketë në dorë dhe prej tyre të përveçojë nektarin e veprës shumëdimensionale të Naim Plakut. Dhe jo vetëm kaq, por shkrimtari e studjuesi Skarra, sjell risi në "Raportet e Naimit me veprën", duke i parë ato në një kontekst të gjerë, në fushën e gjuhësisë e letërsisë, por edhe duke na e paraqitur Naim Plakun si një figurë të shquar të folkloristikës tonë, si skenarist dhe libretist.

Dhe në vlerësimin e veprës së N.Plakut, autori i mografisë "Ditëhijet e një poeti", nuk ndalet vetëm tek mendimi i tij analitik, mjaftë i vlefshëm, por sjell referenca të çmuara nga bashkëkohës të mirënjohur. Kështu, Prof.Dr.Shaban Sinani, përveç shumë punëve të bukura në krijimtari, veçon atë çfarë Naim Plaku i ka kushtuar traditës gojore të popullit të Dibrës, traditës etno-zakonore dibrane, studimeve me karakter historiografik dhe etnologjik, krijimtarinë letrare në përgjithësi, sidomos poezinë e tij. Ndërsa Ali Ahmeti, sjell në kujtesë këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula dhe të tjerë këngëtarë, që atij dhe shokëve të tij, kur luftonin për të drejtat e popullit shqiptar, u jepnin zemër dhe i hidhte në flakën e betejave. Por, lideri i mirënjohur historik i shqiptarëve të Maqedonisë pohon se në atë kohë nuk e dinte që tekstet e tyre aq të fuqishme i I kishte bërë Naim Plaku.

Dhe nëse për Shkurte Fejzën, poezia e N.Plakut ka shpirt dhe i jep motiv kompozitorit, që të kompozojë, por edhe këngëtarin e frymëzon për të kënduar me shpirt, për Dr.Fejzulla Gjabri, që është edhe redaktori i librit, "Në vëllimet e Naimit ka frymëzim vendlindor, dibran dhe gjithëshqiptar. Aty është lashtësia, aty burojnë mesazhet, aty ngrenë krye hulumtimet....".

“Shtëpia e Dodës sa gjysma e Turqisë”.

Fisi Doda në Reç të Dibrës



Ura e Dodës. Ndërtuar dhe emërtuar me emrin e Fisit Doda

Nga **AGIM ISUF DODA**

ORIGJINA

Dy vëllezër Dod Gjaksi dhe Mark Gjaksi ishin me origjinë nga Shkodra dhe mbiemri Gjaksi atëherë u kishte ngelur se me shumë shtëpi e fise në Shkodër ishin vra e kishin ra në gjak. Duke qenë se në Shkodër kishin më shumë se tridhjetë gjaqe dhe në të njëjtën kohë, ata i ndiqte për t’i arrestuar dhe Qeveria Osmane. Dy vëllezërit Doda dhe Marku u larguan nga Shkodra dhe u vendosen për të jetuar në fshatin Ploshtan të Dibrës. Edhe këtu Doda dhe Marku u sulmuan disa herë si nga ata që ishin në hasmëri, ashtu edhe nga qeveria Turke, por ata asnjëherë nuk u dorëzuan. Ishin trima dhe luftëtarë të papërballueshëm dhe të pathyeshëm. Nisur nga lufta e vazhdueshme që bënin aty ngeli emri Kalaja e Dodës. Edhe pse ka rreth 250-300 vjet nga ajo kohë edhe sot ai vend quhet Kalaja e Dodes. Më përpara qendër lokaliteti, pastaj qendër e kooperativës bujqësore dhe sot njësi administrative me të njëjtin emër: “Kalaja e Dodës”. Të gjithë ne që kemi mbiemrin Doda jemi trashëgimtar dhe pasardhës të këtij burri të madh që me emrin dhe historinë e tij, e la të përjetshëm këtë emër për brezat që kanë kaluar dhe për brezat që do vijnë. Çdo djalë e çdo burrë i Fisit Doda është krenar për historinë dhe mbiemrin që kemi. Doda dhe Marku disa herë u rrethuan nga ushtria Turke dhe në luftim e sipër ushtria Turke arriti të arrestonte Markun, ndërsa Doda çau rrethimin dhe u largua. Markun, ushtria Turke e mori për ta dorëzuar në komandën e tyre në Prizren, por gjatë rrugës, te ura e Lapave në Bushtricë, ai tentoi të ikte dhe turqit e vranë. Në këto rrethana Doda e kishte të pamundur të qëndronte në Kala. U largua prej andej dhe u vendos në Reç për të jetuar. Ku u pranua dhe u përkrah nga të gjithë fiset. Në Reç, djemtë e Dodës dhe në vazhdimësi të tjerët u kthyen në besimin Mysliman dhe emri i Dodës u mbajt për mbiemër, në vazhdimësi e deri sot. Në besimin mysliman si të parët e fisit njihen Selman Doda e Taf Doda.

BANIMI NË REÇ

Si familje erdhi gjithnjë duke u rritur e fuqizuar si nga ana ekonomike ashtu dhe në numrin e pjesëtarëve të familjes. Deri në vitin 1905 ishin një familje e madhe prej 97 pjesëtarësh, të gjithë në një familje të pandarë, prandaj dhe sot kur takon ndonjë që e njeh historinë e këtij fisi të thonë: “Ku je shpia e Dodës?”.

Nga ana ekonomike të ardhurat kryesore e mjaft të mëdha ishin nga sejmenlliku. Në kohën e Turqisë kishte grabitje shumë të mëdha. Grupe 20-30 vetë të armatosur në mes të ditës grabisnin gjithë fshatin dhe i pari që i organizonte këta grabitës quhej Bylykbash. Ata që ishin të pamundur për t’u mbrojtur kërkonin mbrojtje te persona apo fise të tjera. Ato fise që i merrnin në mbrojtje ato fshatra quheshin Sejmen. Shtëpia e Dodës ka qenë Sejmen vazhdimisht në shume fshatra si në Rekë, Shkup, Dibër të Madhe etj. Ato fshatra që i merrte në mbrojtje Shtëpia e Dodës i bënte të njohura në të gjithë zonat si Mirditë, Lumë, etj. dhe në ato fshatra nuk mund të ndodhte dhe nuk ka ndodhur asnjë plaçkitje. Këto fshatra organizonin dhe në fund të vitit çdo familje sipas mundësive bashkonin një sasi të ardhurash, të cilat ja sillnin shtëpisë së Dodës. Kjo ishte e ardhura kryesore e shtëpisë së Dodës. Shtëpia e Dodës në ato vite kishte 30 djem e burra, të gjithë të armatosur. Ata ishin të organizuar dhe të pathyeshëm si me qenë një repart ushtarak. Në librin e saj, Brenga e Ballkanit, Edith Durham shkruan: “Po kaloja nga Arrni për në Lurë. U ndalova tek një shtëpi që ishte më e madhja e më e fuqishmja e këtyre anëve. Ajo kishte 72 vetë, të gjithë në një familje, 28 djem e burra të armatosur, shumë pasuri e disa kulla trekatëshe për banim. Kjo ishte shtëpia e Dodës”.

Shtëpia dhe fisi i Dodes, autoritetin dhe forcën që kishte asnjëherë nuk e ka shpërdoruar me fshatrat dhe fiset e tjera, por ajo ishte vazhdimisht në mbrojtje të tyre dhe sa herë ishte nevoja për mbrojtjen e Atdheut ajo organizonte dhe u printe e para për në luftë kundër turqve dhe serbëve. Shtëpia (fisi) i Dodës në çdo rast kishte mundësi të grumbullonte rreth 350-400 burra të armatosur për në luftë. Në Dibër dhe në Lumë (Kukës), në megjelis ose në rrethe të ndryshme me burra të mençur e patriotë të këtyre krahinave vlerat dhe historinë e fisit të Dodës e kanë përkufizuar me dy fjalë:

1. Shtëpia e Dodës sa gjysma e Turqisë
2. Shtëpia e Dodës, shtëpi pushke e lufte brez pas brezi

Të shkruajmë ngjarjet dhe të vërtetojmë thëniet e mësipërme. Dibra në historinë e vet asnjëherë nuk e ka pushuar luftën kundër Turqisë. Nga fisi i Dodës, që nga fillimi i vitit 1800 deri në fund të viteve 1900 burrat dhe djemtë kane qenë ata që kanë organizuar sa herë që ka qenë nevoja për tu ngritur në lufte si në Reç, Arrën dhe Lurë. Ata i organizonin njerëzit për në lufte dhe ishin vetë që ju prinin të parët dhe në ballë të luftës. Duke qenë se për këtë fis janë shkruar dy libra, do të shkruaj shumë shkurt vetëm për disa nga burrat e këtij fisi.

I pari që njihet si prijës e luftëtar nga ky fis ishte Taf Doda me reçnjanët e tjerë që luftoi kundër Turqisë dhe u vra në luftë në vitin 1844. Po kështu dhe Selman Doda ka qenë luftëtar në ushtrinë e Ali Pashë Tepelenës. Pas Selmanit dhe Tafës vjen brezi i dytë dhe ishin Suf Doda dhe Bajram Doda. Të dy ishin vëllezër, të dy luftëtarë që janë shumë të njohur në historinë e fisit Doda në luftë kundër Turqisë. Suf Doda me luftëtarët që kishte arriti të thente ushtrinë Turke në fushën e Karadakut dhe me dorën e tij arriti që të merrte dhe flamurin e ushtrisë turke, flamur të cilin e kemi pasur deri në vitin 1960. Ushtria turke, pasi kishte marrë informacionin se kush e mori flamurin dhe kush ishin prijësit e luftës në frontin që u thye, organizoi forcat e veta ushtarake dhe me artileri sulmoi kullat e Dodës për 5 ditë rresht dhe pasi u bind se janë larguar nga shtëpia burrat e armatosur, dërgoi ushtarët këmbësorë dhe i dogji kullat. Në atë kohë gjithë burrat e armatosur kishin dalë në mal dhe gratë me fëmijët kishin shkuar te njerëzit e afërt. Përveç pjesëmarrjen në lufte kundër Turqisë, Suf Doda dhe Bajram Doda ishin të dy në Lidhjen e Prizrenit. Në librin e tij “Historia e Dibrës”, Kristo Frashëri shkruan: “Një nga figurat kryesore të Lidhjes së Prizrenit përkrah Iljaz Pashe Dibrës ishte ajo e Suf Dodës (fq. 267). Me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizerenit për meritat dhe kontributet e dhëna janë dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Duke qenë se Sufa e Bajrami ishin të moshuar vjen brezi i tretë, Baftjar Doda e Xhafer Doda, të dy luftëtarë e prijësa në luftë kundër Serbisë. Edhe Xhafer Doda edhe Baftjar Doda ishin gjithmonë në një front bashkë me Elez Isufin në luftë kundër Serbisë dhe ishin bërë tmerri për ushtrinë serbe. Në vitin 1913 kur Luma kishte kërkuar ndihmë nga Dibra, Baftjar Doda e Xhafer Doda ishin bashkë



Trojet në Reç

me më shume se 300 reçnjanë të armatosur dhe ishin të vendosur në Qafe të Kolosjanit, të gatshëm për të filluar luftën. Por paria e Lumës nuk ishin dakord, sepse luftimet do zhvilloheshin në fshatra e dëmtoheshin familjet e pambrojtura, pasi nuk ishte bërë largimi i popullsisë, por Xhafer Doda u thotë: “Mu më keni dërguar fjalë për luftë dhe nuk kthehem prapa”, dhe u hodh i pari në sulm kundër serbëve. Kështu lufta filloi e vazhdoi për dy ditë me rradhë dhe forcat serbe u thyen e kaluan matanë Qafë Morinës. Prandaj edhe këngës i thonë: “Xhafer Doda po len nam,/ po i hyn serbit në istikam./ Kur po vikat Baftjar Doda,/ dridhen male, dridhen kodra.” Ushtria serbe arriti ta arrestojë Xhaferrin dhe gjatë rrugës për në Prizeren, në përleshje e sipër e kan therur me thikë. Për trimëritë e tyre në luftë të dy janë dekoruar dhe në Qafë të Kolosjanit për Baftjar Dodën është ngritur një lapidar. Në luftë kundër Serbisë kanë marrë pjesë dhe shumë djem e burra të fisit Doda si: Sadik Doda, Cam Doda, Sali Doda etj..

Pas luftës me Serbinë vjen brezi tjetër dhe lufta për çlirimin e vendit. Nga fisi i Dodës në luftë për çlirimin e vendit thuajse ishin gjithë djemtë e këtij fisi. Riza Doda, Rexhep Doda, Hamdi Doda, Osman Doda, Murat Doda, Liman Doda ishin partizanë e kuadro në luftën Nacionalçlirimtare. Po nga fisi i Dodës ishin edhe me Ballin Kombëtar: Sali Doda, Ramadan Doda, Mer Doda, Selim Doda. Të dyja palët ishin vëllezër dhe kushërinj të parë, por në luftë ishin kundërshtarë e ball për ball. Si ato që ishin partizanë dhe ata që ishin me Ballin Kombëtar janë shumë të njohur në historinë e Luftës Nacionalçlirimtare. Nga partizanet Riza Doda u vra dhe është dëshmor i atdheut.

Duke marrë në konsideratë periudhën e luftës kundër Turqisë vërtetohet ajo që thamë më larte: “Shtëpia e Dodës sa gjysma e Turqisë”.

Me tej duke marre në konsiderate luftën kundër Serbisë dhe luftën Nacionalçlirimtare, vërtetohet dhe thënia tjetër: “Shtëpia e Dodës, shtëpi pushke e lufte brez pas brezi”.

Nga fisi Doda jo vetëm në luftë por në vazhdimësi ka pasë dhe kuadro në detyra të ndryshme e gjatë gjithë periudhave.

Në kohën e Zogut: Sadik Doda - kapedan; Sali Doda - kapedan; Ramadan Doda - kryetar komune; Zenel Doda - oficer; Mer Doda - kryetar komune Shpal, Mirditë; Myftar Doda - xhandar; Dali Doda - oficer me ushtrinë Italiane; Xhem Doda - nëpunës; Xhafer Doda II - komandant xhandarmërie në Prizren.

Në kohën e Partisë së Punës, të gjithë drejtuesit nga fisi Doda ishin me arsim të lartë: Rexhep Doda - kryetar i Komitetit Ekzekutiv Dibër dhe Rektor i Universitetit Bujqësor, Hamdi Doda - komandant Brigade; Murat Doda - shef seksioni në Komitetin Ekzekutiv Tiranë; Osman Doda - kryetar dege; Liman Doda - oficer; Fatmir Doda - pedagog në Universitetin e Mjekësisë, drejtor spitali; Mesila Fatmir Doda - deputete; Piro Doda - inxhinier mekanik; Albert Doda - inxhinier ndërtimi; Xhemal Doda - inxhinier pyjesh; Gazmend Doda - mjek; Agim Suf Doda - shkolla e Partisë, kryetar i Degës së Kuadrit në Sharre, kryetar i Degës së Tregtisë Pukë; Kujtim Doda - shef Seksioni në Komitetin Ekzekutiv Pukë; Besnik Doda - shkolla e Partisë, shef Kuadri; Qemal Doda - Financë, shef Finance + Tatime; Arben Doda - Finance, shef Finance + Tatime; Petrit Doda - Financë, institucione të ndryshme; Femi Doda - Finance, institucione të ndryshme; Halil Doda - drejtor shkolle; Dashamir Doda - arsimtar; Muhamed Xhafer Doda - arsimtar; Ali Xhafer Doda - arsimtar; Edison Dida - inxhinier; Ergin Doda - Universiteti i Sporteve; Rraman Doda - kryetar kooperative Reç; Misim Doda - kryetar kooperative Tejmalle; Agim Ramadan Doda - arsimtar; Vesel Doda - arsimtar; Haqif Mus Doda - llogaritar; Muhamed Gani Doda - agronom; Sabri Halim Doda - teknik ndërtimi; Ismail Doda - teknik ndërtimi; Nezir Doda - ekonomist (llogaritar); Sahit Doda - arsimtar; Asllan Doda - kryetar komune Reç; Llam Doda - teknik ndërtimi.

Duke filluar që nga Doda I e deri në brezin e sotëm, ato që kanë marrë pjesë në lufte, e këta që kanë punuar në administratë, jemi të gjithë deri në gjashtë breza.



Kullat e Fisit Doda

Çdo djalë e çdo burrë i Fisit Doda është krenar për historinë dhe mbiemrin që kemi. Doda dhe Marku disa herë u rrethuan nga ushtria turke dhe në luftim e sipër ushtria turke arriti të arrestonte Markun, ndërsa Doda çau rrethimin dhe u largua. Markun, ushtria turke e mori për ta dorëzuar në komandën e tyre në Prizren, por gjatë rrugës, te ura e Lapave në Bushtricë, ai tentoi të ikte dhe turqit e vranë...

TREGIMET E DRINIT

Fëmijëria. *Shkolla e mesme. Rinia*

Nga **DIONIS XHAFA**

Nuk ka ndonjë dyshim se nëse fëmijëria nuk është periudha më e bukur për jetën e një njeriu, kjo periudhë më së paku është ajo që ka pafajësinë më të madhe. Kjo periudhë jetësore që është fëmijëria me siguri që nuk është ajo më me trazira, më e bujshmja, por se është periudha kur nis e mëson se çfarë është jeta. Ti si qenie njerëzore e ke jetën, nëse do të bënim një krahasim, sikundër një lumë që në fillimet e veta nis qetë, njeh vetëm qetësi, një vazhdë thuajse të njëtrajtshme. Kështu rrjedh fëmijëria për shumicën e njerëzve. Edhe nëse fëmija qëllon se rritet në familje të varfër, nis të kuptojë se nëse të tashmen e ka të qetë, trubullirat e vorbullat do të vazhdojnë më pas, në të ardhmen e afërt. Fëmija ngjan kështu si qenie e pafajshme, më së paku reflektim i sjelljes, edukatës së prindërve, që në bazë të jetës të fatit të vet, rrethanave, ajo çka sheh, vepron edhe në të ardhmen. Po tashmë jam duke e kaluar të përgjithshëm dhe po dal te e përveçmja. Fëmijëria për mua personalisht ka qenë moshë e veçantë, por me siguri që më ngjan njëjtë si fëmijëria e çdo njeriu që rritet në tokë.

Kjo fëmijëri kishte ngjyra të kulturave të popujve të ndryshëm, të rruzullit tokësor. Ajo kishte ngjyra braziliane, për shkak se luanim futboll me Mirin, Mondin, me Fredin, Azemin, Klodin, Gentin, Xhikun, Arjanin. Bukuroshin që sot e kësaj dite nuk është më. Ndjesë nëse harroj ndokënd se lista është shumë e gjatë, por se luanim tetë orë futboll në ditë, në gurë e gëmushë, në borë e në shi, në fushë të shkollës e në fusha të Allejbegisë, E thyenim edhe rregullin se në orën 2 të drekës kur është vapë e dielli të përcëllon prindërit na thoshin që të flemë gjumë, kurse ne çoheshim dhe me hapin prej majmuni shkonimn e linim zemër e mend në fushë të sportit.

Fëmijëria kishte edhe ngjyrën gri. Kur në verë ika në shkollë për tu larë në liqenin e Pesjakës, erdhi mamaja dhe të tjerë persona për shkak se kishin frikë se zhytesha, mbytesha, në llucë të madhe të ujit të izoluar prej kodrash, por ja që as vdekjen nuk e kisha frikë. Kjo periudhë jete merrte ndonjëherë edhe ngjyrë gri të errët, kur në një grup shokësh mendjekrisur jo pak, ikëm në një shkëmb e lëndinë të Korabit, tregonim barceleta rrugës, hipur mbi Deshat e çmendurisht rrëshqisnim në borën e pashkrirë në pranverë, që ishte prezente në atë vend me lartësi mbi 2000 metra. Ujëvara e largët ku ishte e vështirë të shkoje e pamë, edhe pse në lëkurë në sytë tanë ishte vdekja. Me siguri që jam me fat që në atë udhëtim ishte Korabi, një djalë tepër shpirt mirë, i respektueshëm, me trup të lidhur dhe që më ndihmoi, për shkak se përndryshe mund të kisha përfunduar tragjikisht në një hon a në ndonjë humnerë të ndonjë fshati me pak shtëpi, por këta me qerpiqë e me taban të fortë tradicional. Po fëmijëria e ka pasur ngjyrën ndonjëherë edhe të zezë me drama e tragjedi që shihje ngado rreth e rrotull. Një burrë mbaj mend si e mori policia, forcat speciale, brisku, se ky rrihte njerëz të lagjes, edhe të pambrojtur ndonjëherë, jepte spektakël, teksa me shkop vrau bollën e shtëpisë që thonë se është ajo kafshë shtëpiake që të mbron. Po ashtu, jam frikësuar kur vija nga Pocesti, i isha ngjitur pas një makine e se që aty dolën tri të rritur, mua mu duk befasisht si mënyrë disi mafioze, por se ndoshta talleshin e unë kërceva kangjella dhe fusha për të mbërritur në Maqellarë me zemrën e ngrirë. Po në fëmijëri jam vrarë e sakatuar me këmbë e duar, rrëzuar nëpër fusha me gurralecë, sikundër edhe dëmtuar në ije në futboll apo këpusja mishin e mesit mënjanë.

Për fëmijërinë kam shumë për të treguar dhe se nuk do të mjaftonin faqe të tëra me gërma. Por se e tërë fëmijëria ime u zhvillua ndërkohë që bëja shkollën e ulët në atë 8-vjeçare në Maqellarë. Pikërisht shkolla në qendër të komunës kishte një kat lart, të tretë, të ndarë fizikisht prej një porte nga ne në katin e dytë e të parë, edhe për shkak se atje "lart" ishte tjetër moshë që zhvillonte mësim. Kur isha klasë e gjashtë, por edhe e shtatë, nisa të kuptoj edhe moshën e katit të tretë, të adoleshencës. Një histori që u zhvillua me bujë atje la mbresa kudo, më la edhe mua në fakt, edhe pse pak kuptoja në atë kohë nga këto gjëra. Një vajzë e bukur, e sjellshme, dhe e mirë në mësime ishte dashuruar me një djalë që me thënë të vërtetën kishte një bukuri të veçantë, të stilit italian. Djali ishte kaq i bukur sa vërtetë ngjante sikur një yll hollivudian kishte "zbritur" në një provincë të humbur. Mirëpo zërat e opinionit publik vendor e shanin disi djalin për sjelljet, se nuk mendonte mirë çka vepronte etj. Ama djali edhe veprimet e pahijshme disa i bënte për dashurinë që shumë persona përreth vajzës ia kishin mohuar. Vajzën e torturuan jo pak, e mbyllën në dhomë, i thanë që të mos e merrte atë djalë për bashkëshort të ardhshëm, por se ajo e donte, zemra e saj rregëtinte për të. Djali nga ana tjetër arriti deri në kufijtë e çmendurisë për dashurinë, dhe vajzën e mori në fund, por me një lloj historie jo të zakontë, jo siç ndodh zakonisht, por me një tragjizëm u përjetua ngjarja. Sidoqoftë fundi ishte si në përralla.

Kjo ishte pak a shumë ajo që shihja, përceptoja, nga shkolla e mesme në vegjëli. Nuk ishte vetëm kaq. Por shpesh kur në oborr të shkollës mblidheshim bashkë, ne të vegjlit e shkollës 8-vjeçare dhe ata të shkollës së mesme në Maqellarë, me shpoti iu thosha se unë nuk jam i vogël. Kjo ishte ajo gjë të cilën e mbaj mend, se shkollën e mesme e përfundova në Tiranë, e se kam përjetuar edhe vetë momente, thuajse të njëjta me ata që kisha parë te të tjerët kur isha i vogël. Mu shfaq shkolla e mesme, kjo pjesë e jetës si një pasqyrë e jetës, e cila pashmangshmërisht bën që të gjithë të kalojmë fazat e saj, me patjetër secili sipas mënyrës së vet por se emocionet, të dridhurat, gëzimet, tragjeditë, përjetohen thuajse njëjtë prej të tërëve.

Për të dalë tashmë te rinia jo veç imja, por e atij vendi të bukur, të shtrirë në buzë të Drinit. Sipas syrit tim, që sigurisht edhe gabon, të rinjtë në atë zonë ndaheshin në disa kategori. Kishte nga ata të rinj që mësonin relativisht mirë, dhe se kokën për të ardhmen e mbanin ose për nga Tirana ose Durrësi. Te ky rreth shkollarësh le ta themi kështu, kishte nga ata të rinj që synonin degë mësuesie, për të bërë karrierë në mësimdhënie në fshatra të Maqellarës dhe më gjerë. Ndërkaq, pjesë tjetër ishte edhe ajo moshë rinie, që duke qenë se ishte e vetëdijshme se nuk ishte për shkollë e karrierë dhe ky është aspekti ndoshta më i mirë që ka ajo zonë, se askush nuk lavdërohet nëse s'e ka diplomën ose dhe në e ka, pak e vije re, kjo klasë pra të rinjsh iknin jashtë dhe punonin fuqishëm, si kafshë pune, duke mbajtur familjet me bukë, në Greqi në Itali ose më gjerë. Nga këta me patjetër që ka edhe pjesë që hyjnë në rrugë të krimit, mirëpo shumica e kishin mendjen për të ndërtuar familje dhe kishte nga ata që përnjëmend me djersë të thata ngrinin ndërtesa 2-3 kate në fshatin m'u në mes të komunës, me ndonjë flamur kombëtar ose partiak, hijshëm disi. Pjesa më e errët e rinisë ishin ata, që mendja vetëm për keq iu punonte, për të vjedhur e për t'u marrë me fenomene të errëta të tilla si prostitucioni, dhe droga. Por atë rini në trajta të përgjithshme e shoh turbullt. Kur isha aty te klasa e gjashtë, kam parë në një urë në Pesjakë sesi të rinjtë e këtij fshati ziheshin me grushte e hunj me të rinj nga të tjerë fshatra,

Ky sherr masiv që bëhej mbi urë të Pesjakës, kur dielli ishte në perëndim, qielli i skuqur, retë e purpurta, ishte sa tragjik, po kaq edhe pa logjikë të qartë, një demonstrim force i një moshe delikate, kur njeriu rrëshqet shumë kollaj prej udhës të drejtë të jetës. Në fakt unë mendoj se ky sherr, kjo përplasje rinore, më shumë dukesh se ishte për të shfryrë inatet e moshës që ishin të shumta dhe nuk kishin se ku të çoheshin në një vend ku s'kishte punë. Sherret ndaleshin pasi të rinjtë iknin në emigrim, çlironin energjitë në punë të rëndë. Por sherrin në fjalë nuk e shoh vetëm të asaj moshe. Ajo rini e kishte përpasjen fizike, përballje kjo e drejtpërdrejtë, Por me siguri se po këta të rinj, nëse i merr të burrëruar, inatin e kanë me njëri – tjetrin ndoshta të njëjtë, fatkeqësisht, por me forma të ndryshme, jo më fizike, por mendore më shumë. Kaq shumë urrejtje në një vend kaq të bukur, kaq të vogël, fatkeqësisht. E unë do të doja që ata vila 2-3 katëshe të mos e kishin flamurin partiak, traditë që disi është zbehur, por as kombëtar të ngjyer me urrejtje, por të kenë flamur të kuq si dashuria e të bardhë si bardhësi e paqe, mirësia. Por edhe flamujt të mos jenë vetëm karikatura të rrejshme, por dashuri të valonte kudo në zonë. Mirëpo, edhe kushtet ekonomike e pamundësojnë lumturinë, e që kjo e fundit të hyjë në jetën e njerëzve, do të duhej një dritë fat e bardhë, thuajse verbuese.

Ali Abas Buci, *drejtuesi e kryetari që mbahet mend për mirë*

Nga **DEDË DOÇI**

Kur radhis figura të nderuara të Lurës, nuk mund të lë pa përmendur dhe emrin e veprën e nderuar të Ali Abas Bucit, burrë trim, organizator dhe drejtues i talentuar, i lindur dhe i dalë nga Kulla e nderuar e Bucit në Fushë-Lurë. Ky burrë i zoti, i mençur shquhej për patriotizëm, burrëri, bujari dhe besnikëri. Nga kjo kullë dolën njerëz të nderuar të cilët mishëronin tiparet e të parëve të tyre dhe bënë gjatë jetës së tyre punë e vepra të mira që janë vlerësuar nga populli i Lurës. Aliu ishte drejtues i familjes së madhe të Kullës së Bucit, aftësia, respekti, puna e palodhur, besnikëria e shumë cilësi të mira e të veçanta që kishte ky njeri, ranë në sy për mirë jo vetëm në fisin e tij por dhe në gjithë Lurën. Aliu kishte shokë e miq të nderuar, në Lurë e jashtë saj.

Buci, fisi i Aliut, ka bërë emër për mirë, ky fis nuk ka kursyer edhe djalin për mikun, ka luftuar dhe ka kontribuar edhe në luftëra për atdhe e për liri. Është Buci i Lurës që krahas timave të bajraktarit, ka marrë pjesë në luftë dhe ka ruajtur flamurin dhe e ka sjellë në Lurë. Ali Buci ka drejtuar një familje shumë të madhe, me respekt, me ato cilësi të larta të malësorëve të Bucit, bujarë dhe të drejtë. Në drejtimin e familjes së madhe të Bucit, binte në sy organizimi, drejtësia në familje, respekti për njëri-tjetrin e shumë cilësi që duhen përmendur dhe të merren shembull frymëzimi për njerëzit edhe në ditët e sotme.

Në Kullën e Bucit nderoheshin miqtë, dera e Bucit ishte e hapur si për fukaranë dhe për të pasurit. Me bujarinë e madhe të kësaj shtëpie nderoheshin të njohur e të panjohur dhe urimi i njerëzve e vizitorëve për këtë familje ishte i madh. Nga kjo kullë dolën burra të zotë, trima e punëtorë. Aliu ndihmoi me familjen e tij për çlirimin e vendit, sjellja dhe puna e këtij personi admirohej nga të gjithë. Për cilësitë e tij, për vendosmërinë që kishte, për ndihmën që dha gjatë luftës për liri, Aliu zgjidhet kryetar i parë i Këshillit në Fushë-Lurë në këtë fshat të nderuar dhe patriot. Në atë kohë edhe në Lurë të vjetër e Bovie-Lurë u vendosën kryetarë të nderuar si Hasan Batalli dhe Liman Dullë Hoti.

Në ditët e para të çlirimit Aliu ndihmoi në Fushë-Lurë po dhe në Lurë dhe merrte vendime të pjekura dhe ruante gjithnjë figurën e nderuar të tij për të mos i bërë keq askujt, ai jepte garanci për njerëzit në qeveri dhe i ndihmonte ato që të ruanin veten nga rreziqet që mund t'i vinin çdo njeriu, sepse ishte koha e turbullt.

Besnikëria e kësaj familje ra në sy për mirë si për qeverinë e asaj kohe por më shumë për Lurasit. Janë burrat e Kullës së Bucit që nuk i bënë keq askujt dhe gëzuan respekt. Ata ishin patriotë por dhe njerëz gjigantë, punëtorë, pasqyronin kudo dhe kurdoherë figurën e malësorit me Kostum Kombëtar, me pastërti shembull në veshje, në shtëpi e kudo. Shtëpia ku jetonte Aliu me vëllezër shkëlqente si bora e pastër dhe Kulla e Bucit binte në sy jo vetëm për pozicionin që kishte, por edhe pamjen që jepte. Në atë kullë jetonin njerëz fisnikë.

Nga kulla e Ali Bucit dolën njerëz të nderuar, por dhe njerëz që kanë shërbyer si kuadro në Lurë e në vende të tjera. Të tillë përmendim kuadrot si Hamit Buci, Hysen Buci, Faik Buci, Idris Buci, Xhavit Buci etj. Këta dhe pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje punuan me devotshmëri dhe jepnin figurën e nëpunësitë të nderuar me të gjitha cilësitë e mira. Nuk lihet pa u përmendur puna e Hysen Bucit, nëpunës i përpiktë, korrekt, i cili ka drejtuar për një kohë të gjatë sektorin e mirëmbajtjes së rrugëve në Lurë. Cilësitë e tij prej organizatori, drejtuesi i rregullt dhe i përpiktë binin në sy, por duhet theksuar se duke qenë nga Kulla e Bucit që kanë dhënë kontribute për liri e demokraci, figura e Hysenit nuk u vlerësua nga sistemi i parë. Hyseni kishte një humor të veçantë, sarkazëm (figurë letrare) që përdorte Hyseni vinte në lojë drejtuesit e paaftë të asaj kohe. Pra Hsyeni ishte inteligjent, trim i zgjuar dhe e mbylli jetën e tij shembull i njeriut punëtor i arsimuar dhe prind model, ku dhe djemtë e tij manifestojnë ato cilësi bujare e të mira të Hysenit. Me gjithë luftën që iu bë në kohën e diktaturës, ai me zgjuarsi e me punë të ndershme i shpëtoi atij regjimi që shumë herë e luftonte. Xhavit Buci, punoi e jeton në Tiranë për shumë vite, duke ruajtur cilësitë e Ali Bucit dhe duke ruajtur vlerat e asaj familje.

Të rinjtë e Kullës së Bucit sot punojnë e jetojnë më së miri kudo që janë brenda e jashtë vendit. Duhen përmend për mirë të gjithë vëllezërit e Ali Bucit, por dy fjalë po shkruaj për shumë të nderuarin Seit Bucin, njeri i rregullt në paraqitje, në veshje e pastërti model. Edhe kur shkonte diku jepte figurën e njeriut estetik, me humor e delikatesë, ku dallohej e çmohej nga njerëzit. Për Kullën e Bucit duhen shumë rreshta, por me këto pak fjalë, shpreh atë respekt për këtë familje të nderuar në Lurë. Është detyrë e institucioneve që krahas vlerësimit të figurave të tjera në Lurë, të vlerësohet e të nderohet figura e nderuar e Ali Bucit të Fushë-Lurës si këshilltar i zoti e i pari.

kujtesë

Ish futbollisti, trajneri dhe drejtues sportiv, flet sot edhe me mungesën e tij...!

SABRI ABDIU, meteori i sportit dibran!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Ka qenë një ditë e ftohtë dhjetori ajo që mori një jetë, aty në zyrën e tij ku punonte me aq pasion, në klubin "Studenti", klub që e kish kthyer në një model sportiv në vend. Ishte Sabri Abdiu, një drejtues i aftë, por edhe një njeri tepër fisnik, që transmetonte te njerëzit cilësi të rralla volitive. Kanë kaluar afro 13 vite nga ai moment fatal, por kujtesa mbetet e freskët, ashtu si pasioni i tij i jashtëzakonshëm, për të bërë sportin e ndershëm. Dhimbja është bashkudhëtare në familjen e tij, por edhe te secili nga ne, që arriti ta njihte nga afër këtë meteor të sportit dibran dhe shqiptar...



Sabri Abdiu, Mjeshtër i Madh.

Sabri Abdiu, drejtues i aftë, por edhe një njeri tepër fisnik, që transmetonte te njerëzit cilësi të rralla volitive. Kanë kaluar afro 13 vite nga ai moment fatal, por kujtesa mbetet e freskët, ashtu si pasioni i tij i jashtëzakonshëm, për të bërë sportin e ndershëm. Dhimbja është bashkudhëtare në familjen e tij, por edhe tek secili nga ne, që arriti ta njihte nga afër këtë meteor të sportit dibran dhe shqiptar...

BULQIZA, QYTETI KU HODHI THEMELET E PARA TË SPORTIT

Dhjetor 1971. Sabri Abdiu, emërohet mësues i edukimit fizik në shkollën "Xhevdet Doda" në Bulqizë. Ky misionari i madh i sportit, e nisi udhëtimin e madh të jetës pasionante nga ky qytet i minatorëve, aty ku ndërtoi edhe të parën skuadër të futbollit, "18 Shkurti",duke treguar se sporti kishte nevojë edhe për atë qytet, sepse edhe aty kishte djem pasionant, që iu bashkëngjitën dëshirës së mësuesit dhe trajnerit, që sapo kish veshur kostumin sportiv të trajnerit të futbollit. Sabriu, ishte bere personi më i dashur ne Bulqizë, në jo pak, por nje dekadë, nga viti 1972, deri në vitin 1982... Përveç ekipit të futbollit, Sabriu ngriti edhe ekipet e basketbollit, por edhe mundjes. Tashmë Bulqiza ishte realiteti më i ri dhe i bukur i sportit shqiptarë dhe në këtë qytet, vinin e luanin edhe skuadra të tilla si Laçi, Rrësheni, Puka, Gramshi, Burreli, Kruja, Peshkopia, por edhe Durrësi me Lokomotivën e famshme në një ndeshje miqësore... Lëvizja e madhe fiskulturoro-sportive në Bulqizë, ishte tashmë fryt i padiskutueshëm i kryetarit të fizkulturës e sporteve, Sabri Abdiu. Për 10-të vjet me radhë, Bulqiza gumëzhinte nga një jeta e gjallë sportive, aktivitete masive, por edhe kokurime lokale e kombëtare në sporte të ndryshme. Aftësitë e tij drejtuese dhe organizative, pasioni dhe puna e përkushtuar i dhanë tjetër dimension dhe personalitet mësuesit, trajnerit dhe drejtuesit Sabri Abdiu. Ky respekt u shtua, sepse aty njohu edhe njeriun e jetës, një mësuese dhe veprimtare e pashoq në atë qytet, Elida Daci Abdiu. Ata tashmë së bashku, formonin duetin ku njerëzit kishin një model për jetën...

PESHKOPIA AFIRMOI TRAJNERIN DHE DREJTUESIN MODEL

Por rruga e bukur e njeriut pasionant, vijoi në një tjetër qytet, ne Peshkopi, fare afër fshatit ku kish lindur, Sohodollit. Sabriu këtu në dhjetë vite punë, arriti të ishte jo vetëm njëri nga mësuesit më korrekt dhe punëtorë, por edhe si trajner i shkëlqyer, që solli modelin e tij të korrektesës dhe punës, tashmë duke drejtuar jo vetëm skuadrën e te rinjve, por edhe ekipin e parë të Korabit. Rezultatet e tij ishin optimiste dhe cilësore, madje skuadra e parë, pë një rezultat të fundit nuk arriti të ngjitej dot në kategorine e parë të asaj kohe, që sot njihet si superliga. Në vitet e fundit, Sabri Abdiu drejtoi edhe klubin sportiv Korabi. Në vitet që ai drejtoi klubin sportiv Korabi, ushtroheshin 15 lloje sporti, me 53 ekipe konkurrente, të rinj dhe të rritur. 48 ishte numri i konkurrimeve kombëtare në kategorinë e dytë, ndërsa 12 ishte ne elitë. Njeriu vizionarë dhe largpamës, ishte koherent edhe me ngjarjet politike dhe ndryshimi i sistemit krijoi mundësinë e një bashkëpunimi te klubit sportiv Korabi të Peshkopisë, me klubin sportiv të Dibrës së Madhe. Për herë të parë pas përpjekjeve të zotit Abdiu dhe autoriteteve vendore u arrit që me 20 deri më 25 maj 1991, me ftesë të klubit të Korabit të Dibrës së Madhe, të zhvillohej i pari manifestim madhështor mes dy klubeve sportive. Pas 44 vjetësh, u ringjall një bashkëpunim sportiv, mes vëllezërve të përmalluar nga ndarja e padrejtë. Akujt tashmë ishin shkrirë dhe zemrat e vëllezërve dhe motrave u ngrohën edhe në fushën e sportit...

KRYEQYTETI RINGRITI EMRIN E NDERUAR TË TIJ

Pas vitit 1992 ai nuk është më drejtues i klubit Korabi dhe bashkë me familjen, vjen në Tiranë. Edhe këtu pas disa vitesh, rigjen vetveten, madje si drejtues në klubin sportiv Studenti. Është viti 1998. Tashmë Studenti nis ndryshimin e madh dhe bëhet një nga klubet cilësore në vend. Deri në vitin 2004, për pra për gjashtë vjet me radhë, klubi që ai drejtonte shpallet kampion në disa sporte, si volejboll meshkuj, volejboll femra, gjimnastikë, xhudo, basketboll, ping-pong, qitje, shah, mundje, peshëngritje, etj. 9 lloje sportesh me 27 ekipe sportive, përfaqësonin këtë klub sportiv në vend, duke u ngritur ne elitën e sportit shqiptarë. Merita ishte e padiskutueshme edhe e drejtuesit të aftë dhe kurajoz, Sabri Abdiu. Jo pak, por gjashtë vite me radhë, ai nuk rreshti së punuari për ta lartësuar emrin e një klubi sportiv që kish mbetur në hije, krahasuar me Tiranën, Partizanin, Dinamon, etj. Tashmë Studenti, ishte afirmuar edhe në mjaft ndeshje dhe gara ndërkombëtare. Arritje të tilla, por edhe mënyra e menaxhimit profesionist që i bënte klubit, krijuan një emër dhe personalitet të padiskutueshëm, saqë mediat shpesh herë kishin të ftuar special, këtë drejtues të zot, që po sillte një risi të punës dhe marrëdhënies në grup...



Me ekipin e futbollit të Bulqizës "18 Shkurti".

ABDIU, VLERËSIME EDHE NË MUNGESË

Sabri Abdiu, vërtet nuk jeton prej dhjetorit të vitit 2004, por vlerësimet për këtë figurë dhe personalitet të sportit nuk kanë munguar në vite të ndryshme. Qyteti i Bulqizës pas vdekjes i ka akorduar titullin e lartë: "Qytetar Nderi", ndërsa klubi sportiv Korabi në 75-vjetorin e tij, ka nderuar me titullin e lartë "Nderi i klubit Korabi" zotin Sabri Abdiu. Ndërkaq që federatat e basketbollit, mundjes dhe peshëngritjes e kanë vlerësuar me titull "Nderi i Federatës", pa harruar edhe urdhrin olimpik dhe memorialin dhënë nga KOKSH. Presidenti i Republikës Bujar Nishani me 15 pill 2016 e nderoi me titullin më të lartë "Mjeshtër i Madh", për merita dhe kontribut të shquar të dhënë në sport.

FAMILJA, FRYMËZIMI I JETËS

Asnjëherë suksesi i një individi, s'mund të kuptohet pa mbështetjen e familjes së tij. E tillë ka qenë edhe familja Abdiu. Vëllezërit dhe motrat e Sabriut, Nuriu, Ismeti, Fehmiu, Shahja, Kujtimja, Metapja, pa harruar prindërit e shtrenjtë të tij, Hazisi dhe Gjulja, kanë qenë dhe mbeten mbështetësit e parë të realizmit të ëndrrave për shkollën, por që më pas, kur ai ngriti dhe ndërtoi familjen e tij të ngushtë, suksesi i jetës shënoi kulme. Bashkëshortja Ida, por edhe fëmijët, Genta dhe Ridjan Abdiu, ishin shtyllat, ku mbështetej puna dhe misioni i jashtëzakonshëm i një bashkëshorti dhe prindi model, që arriti të shijonte vetëm lindjen e nipit të parë të tij nga vajza Genta, Marini. Ida, ishte dhe mbetet, zonja e rrallë e një njeriu, familjeje, por edhe qyteteve ku punoi dhe tregoi vlerat e saj. Ajo vazhdon edhe sot, bashkë me vajzën, djalin, nipërit dhe mbesat, ta lartësojë emrin e "meteorit" që kurrë nuk shuhet në sportin dibran dhe shqiptar, i pavdekshmi Sabri Abdiu....



Me ekipin e futbollit të Korabit.



Me ekipin kampion të volejbollit "Studenti".

Rruga e Arbërit nr. 133

Tola i Çidhnës – kullë
e provave të atdhetarisë në brezni.

TOLA I ÇIDHNËS, kullë e nacionalizimit





Nga **MEVLUD BUCI**

Të shkruash për Tolën e Çidhnës, të pasqyrosh fisnikërinë e unitetin, mençurinë, trimërinë e qëndresën e tyre nuk do të mjaftonin dhjetëra shkrime a libra. Janë dëshmitë, provat e qëndresës të bujarisë, të urtësisë, të shëmbëllimit në epoka, të cilat flasin me gjuhën e fakteve. Mustafa Tola (i riu) një nga pinjollët e kullës së Tolës në Çidhën është sinonimi i të parëve, intelektuali, organizatori, studiuesi, veprimtari e njeriu i thjeshtësisë që mban mbi supe, por edhe që justifikon historinë e ndritur të të parëve të vet.

Në fakt në Çidhën tek cilido fis e kullë që të "gërmosh" gjen mineralin e çmuar të qëndresës, mençurisë e të fisnikërisë. Por këtë radhë po shkruajmë për Tolën.

***

Çidhna si njëri nga 9 malet e Dibrës (Mali i mençurisë), Mia e Çidhnës siç i thonë prej lashtësisë krahas shumë e shumë atdhetarëve ka edhe Taf Taf Tolën. U lind më 1854 në Çidhën. Më 23 maj 1978 shpallet Dëshmor i Atdheut. Taf Tola i parë u rrit dhe edukua në një familje me tradita. U edukua me kulturën e odave, me mençurinë çidhnake. Ishte prijës popullor me emër në Malin e Çidhnës, pjesëmarrës në rezistencës dhe luftërat kundër turqve dhe në kryengritjen e vitit 1912 në Arras. Taf Tola përfaqësoi Çidhnën në zgjidhjen e konflikteve territoriale që lindën me Pashën e Matit (Haxhi Pashë Sakatin). Me ekonomi të mirë dhe shumë autoritet, impulsiv dhe bujar ndërtoi në fshat një kullë tre katëshe në vitet 1880-1890 me gurë gëlqere që edhe sot qëndron madhështore si për të sjellë peshën e kohës gjurmët e qëndresës nëpër vite, fisnikërinë e bujarisë e të krenarisë legjitime. Në vitin 1916 arrestohet nga austriakët dhe dërgohet tek kisha e Lurës e prej atje internohet në Xhurë të Prizrenit ku për rezistencën e kundërshtimet ndaj pushtuesit mbytet me tortura. Sot është pa varr. Taf Tola është në historinë e në zemrat e brezave në kujtimet e këngët e trimërisë, sepse për të flet vepra prej prijësi popullor, qëndresa dhe heroizmi në emër të atdheut e të lirisë kombëtare.



Shaqir Tola në kampin e të burgosurve politikë në Ventotene të Italisë.

Taf Tola është në historinë e në zemrat e brezave në kujtimet e këngët e trimërisë, sepse për të flet vepra prej prijësi popullor, qëndresa dhe heroizmi në emër të atdheut e të lirisë kombëtare.

... Çidhna vatra e mençurisë / Me plot bij trima, sokola / T'ndrit n'altar të historisë / Prijsi i rrallë çaj Taf Taf Tola...

***

Kulla e Tolës në vite e dekada nxori breza të traditës, të urtësisë e atdhetarisë. Ndër pasardhësit e prijësit popullor Taf Taf Tola ishte edhe Sadin Tola. U lind në Çidhën në vitin 1904. Provat e jetës e të

punës flasin shumë për Sadin Tolën. Ai ishte zv. Komandant Poste në Tropojë, Gjirokastër dhe Zerqan, xhandar në Durrës. Ishte njeri me intelekt, me mençuri të rrallë, i matur, i thellë në mendime, me alegori të hollë dhe vizion, i respektuar shumë në odat e mexheliset dibrane në Çidhën e krahinat fqinje si Lura, Dardha, Reçi, Muhurri, Selishta (Katër-Grykët) etj. I këndshëm në biseda me të gjitha moshat e nivelet intelektuale, një filozof popullor i lindur. Në vitin 1948 i hiqet triska e frontit dhe dërgohet në hekurudhën Tiranë-Durrës, në punë të detyruar. Më pas Sadin Tola kreu detyrën e kryetarit të këshillit të fshatit Çidhën dhe prokuror popullor duke qenë se mbajti një ekuilibër të admirueshëm në heshtje e kujdes në biseda. Vdiq në vitin 1983 në moshën 79 vjeçare. Edhe sot përmendet si model e simbol i mençurisë dhe i alegorisë çidhnake.

***

Një epope qëndrese, vuajtje e fisnikërie përbën jeta dhe vepra e Shaqir Tolës. Ai u lind më 1908 në Çidhën. U rrit jetim nga nëna. U shkollua, edukua e burrërua në "parlamentin" e odave çidhnake e atë të kullës shekullore të Tolës. Më 1921, kur ishte vetëm 13 vjeçar, merr pjesë me armë në dorë në luftimet kundër serbëve në Mallë të Hoxhe duke zëvendësuar vëllain Sadinin që kthehet në fshat për varrimin e Hasan Tolës vrarë po në Mallë të Hoxhe në Muhurr gjatë luftimeve. Shaqir Tola shquhej për zgjuarsi, kulturë popullore, për peshën e fjalës, për zellin dhe guximin prej çidhnaku të urtësisë. Më 1936, pas mbarimit të shërbimit ushtarak në gardën mbretërore, emërohet n'oficer dhe zv.komandant në Baterinë e Artilerisë në Burrel. Më 7 prill 1939, me baterinë që komandonte mbërrin në Brra të Tiranës për të luftuar kundër italianëve, por mëson që Mbreti kishte ikur dhe i gjen armët e reparteve ushtarake që kishin mbërritur më parë, të kulmuara, të grumbulluara për dorëzim. Në këtë kohë Shaqiri ngarkon 2 (dy) mushka me armë dhe 1 (një) mitraloz dhe kthehet në vendlindje në Çidhën, ku qëndron 6 muaj i arratisur në mal deri në dhjetor 1939. Njeri i lidhur me vendlindjen, me familjen, me fisin, me karakret e traditat ndaj në vitet 1933-1937 u zgjodh edhe kryeplak i fshatit Çidhën. Shaqir Tola, në dhjetor 1939 pak ditë pasi ishte dorëzuar prefektit të Dibrës, arrestohet në një ceremoni fejese në Kishavec dhe bashkë me Osman Bashën, Adem Hoxhën, Idriz ZImorin etj., dërgohet në internim në ishullin Ventotene të Italisë si i burgosur politik ku qëndroi plot 3 vjet. Në vitin 1942 kthehet nga internimi me 5 shqiptarët e fundit si Abas Ermenji e Izet Belezigi. Në vitin 1941, kur kishte filluar lufta italo-greke në një anije lufte ngarkuar me armatime që vinte në Shqipëri konfliktohet me një oficer italian në Portin e Brindizit dhe rikthehet në Ventotenie përsëri, pasi ridënohet edhe 5 të tjera nga një gjykatë ushtarake në Bari. Në vitin 1944 merr pjesë në luftime kundër partizanëve në Brezhdan, Fushë-Alie dhe Sinë. Në vitin 1946 burgoset dhe dënohet për fshehjen e armëve të marra në prill të vitit 1939 me dy mushkat. Shaqir Tola, me mençurinë e çidhnakut përballoi sfidat e kohës. Në vitin 1990 i dërgon letër Ramiz Alisë për t'i njohur të drejtën e pjesëmarrjes në luftën antifashiste për periudhën e internimit dhe marrë 100 lekshin e luftës, por merr përgjigje refuzuese: "ky problem është mbyllur që në vitin 1973. Burrë i sedrës, i mençurisë dhe vendosmërisë për atdheun,



Shaqir Tola me të vëllain, Sadinin.

për jetën, familjen dhe kohën Shaqiri ka gjurmë në kohë, gjurmë të cilat janë modeli i atdhetarisë, pasionit e traditave.

Mëson autodidakt të shkruajë e të lexojë shqip. Në internim mëson italishten dhe merr kontakte me studentët shqiptarë dhe politikanë të kohës midis të cilëve Ibrahim Dervishi, Sadik Bekteshi, Xhemal Ponavija, Zef Mala, Abas Ermenji etj. Për rezistencën e fortë dhe qëndrimin burrëror në internim në Ventotenie merr vlerësimin dhe respektin e shokëve të internuar. Burrë me shpirt vetmohimi, me krenari legjitime për Çidhnën, Dibrën e kombin, për udhën e nacionalizmit ishte dhe mbeti çidhnaku i qëndresës Shaqir Tola. Për mospajtime me idetë komuniste si nacionalist dhe fetar që falej 5 herë në ditë tërhiqet dhe jeton në fshatin Çidhën në kushte të vështira dhe nën trysni e presion të vazhdueshëm i ndjekur vazhdimisht nga agjentët e sigurimit të shtetit dhe spiunët në fshat. Një jetë me plot sakrifica e rezistencë, një jetë burrërore dhe me plot besim e vendosmëri prej çidhnaku të pamposhtur, vizionar të qartë në udhët e vështira e plot sfida.

Në kushte shumë të vështira gjatë viteve të regjimit komunist shkollon me shumë sakrifica tre vajzat Alltanen, Kadën dhe Mihanën dhe djalin Mustafën që për arsye politike i dërgonin në shkollat që nuk kërkoheshin shumë, degët e dorës së dytë. Bashkëshortja e Shaqirit Sulbije Tola, grua e urtësisë dhe e lerave të rralla e lindur në Arras në vitin 1926 i erdhi në krah e hijeshoi dhe nderoi derën, kullën bujare të Tolës. Kjo grua dhe nënë burrëreshë, deri sa u nda nga jeta në vitin 1983 i qëndroi në krah, rriti dhe edukoi fëmijët si s'ka më mirë, bëri emër me virtytet, bujarinë dhe kulturën që i rrezaton e do t'i rrezatojë tek pasardhësit, farefisi, nipërit e mbesat e saj. Nga çfarë kemi dëgjuar e mësuar për të paharruarën Sulbie Tola vërtet ishte e jashtëzakonshme, punëtore e rrallë, shumë e dashur për fëmijët e lagjes, bujare e zemërgjerë e pakrahasueshme në kushtet e varfërisë së madhe. Ka mbetur si testament urtësie fjala e dhimbjes me ngushëllimin e të birit, intelektualit virtuoz e të talentuar Mustafa Tola: "Nuk ka vdekur vetëm nëna jote, por edhe nëna jonë, nënë për të gjithë ne, e kemi bashkë dhimbjen...

Shaqir Tola, pasardhësi i kullës së nderuar çidhnake la gjurmë të pashlyera në kujtesën e brezave. Udhët e provat si atë të këtij burri të qëndresës janë rrezatimi i mirësisë, krenarisë dhe i fisnikërisë dibrane e mbarëkombëtare. Në këtë udhë ecën edhe Mustafa Shaqir Tola. Fati më bëri që të gjej e lexoj edh enjë poezi (baladë) shkruar nga e bija e Shaqir Tolës, Kada më 1996, "Jam krenare për ty baba". 23 strofa. E 23-ta thotë: Dhe mbeti kujtimi prapa / Vepra dhe burrëria jote / Kështu e kanë lënë stafetën / Gjithë brezat e kësaj bote...

Provat dhe jeta, puna dhe përkushtimi, lufta prej atdhetari e nacionalisti, familja e fisnikërisë, gjurmët në breza dëshmojnë për të paharruarin Tola. Tola i Çidhnës – kullë e provave të atdhetarisë në brezni.

kujtesë

Si populli i zonës së Lurës së Dibrës në vitin 1974 arriti të anulojë vendimin e byrosë së Partisë së rrethit për shkurtimin nga detyra të kryetarit të kooperativës bujqësore.

Sulejman Istrefi, *shpirti stoik*

Nga **METUSH SKEJA**

Sulejman Istrefi lindi në Ploshtan të Kalasë Dodës më 1949. Prindërit e tij kanë qenë bujq. Ata kanë pasur një shtëpi dy katëshe guri në krye të fshatit me një çezmë ujë të ftohtë e të kulluar. Shtëpia ka pasur oborrin e gjerë, me pemë frutore përreth, ku dalloheshin dardhat erëmia e të shijshme dhe kumbullat e panumërta. Pak më tutje ka qenë kopështi i perimeve. Arat e të mbjellat ishin jo larg. I ati, Ramizi, ka qenë mezin në xhaminë e fshatit. Familja Istrefi vlerësohej në komunitet e sojit të mirë. Ajo ka ardhur në Ploshtan para 100vjetësh nga fisi i lavdruar Istrefi i Kalisit me kontribute atdhetare. Tafil Istrefi është dëshmor i Atdheut, i cili ka rënë në luftë kundër ushtrisë pushtuese serbe më 1912. Ai ka qenë i internuar së bashku me Maliq Kokën nëTurqi nga ushtria osmane.

Sulejmani ka pasur një trup të drejtë, mesatar të gjatë, i dobët, me raport harmonik mes pjesëve të fytyrës. Ka pasur flokë të zeza të parëna gjatë gjithë jetës. Lëkura me pak pigment. Ai ka qenë më shumë shpirt se trup, ose më shumë shpirt se materie. Pa shtiratje. Dashuronte vyrtytin. Ai shkollën shtatëvjeçare e ka kryer në vendlindje. Më pas ka shkuar në gjimnazin e Durrësit. Kjo ka qenë dalja e tij e parë jashtë familjes. Ky moment ka qenë ballafaqimi i parë me jetën dhe formatimi i vetvetes. Prurjet e nxënësve kanë qenë nga gjithë vendi. Durrësi , qytet, ka civilizim përpara Romës. Të mësoje këtu ka qenë fat. Mësuesit kanë qenë nga më të mirët që ka pasur Shqipëria. Djaloshi i ri me shpirt vlues gjen vetvetën. Nga ana tjetër ka pasur ndërtim vetjak të njohurive nga ana e Sulejmanit. Ndërtimi e nxjerrja e kuptimit nga informacionet që merrte ka qenë detyra që i kishte vënë vetës. Mendja e adolishentit zgjohet. Ndërveprimet sociale me bashkëmoshatarët e tij e bëjnë të komunikojë e të lidhet me të tjerët. Gjatë shkollës mesme te Sulejmani vërehet zhvillim konjitiv , ndryshime pozitive në mendime e sjellje, shkëputje befasuese nga një fazë piazheriane zhvillimi në një tjetër. Ai ka një koncept të gjërë për identitetin, vetëkoncept që e ruajti gjatë gjithë jetës. Ndjesinë e përgjithshme që kishte për vetvetën , së bashku me bindjet , qendrimet e sjelljen i formoi në shkollën e Durrësit dhe i përmirësoi më vonë. Mjedisi social dhe nxitja që mori ndikuan në zhvillimin intelektual.

Njerëzit janë produkte të konteksteve shoqërore ku rritën dhe edukohen. Pas



Personaliteti tij kërkonte Po-në ose Jo-në të madhe, por kurrë mes këtyre të dyjave. Vinte në dyshim atë që e dinin të gjithë. E shikonte tjetrin në sy. Nuk i ka ulur sytë e ndritshëm asnjëherë poshtë. Ka pasur zë të ëmbël, me timbër të veçantë, vende-vende me tejkalim të vetës , duke ngelur mik i së vërtetës. Ka pasur koncept stoik për jetën të cilën e përballoi me sjellje stoike e kohëzion moral...

mbarimit të shkollës mesme ka vazhduar studimet në Insitutin "Luigj Guarkuqi" në Shkodër për matematikë-fizikë. Është diplomuar mësues i këtyre lëndëve. Disa herë ka kërkuar për ti zgjeruar dituritë, të studionte në UT dega fizikë. Kjo kërkesë nuk iu plotësua . Në Shkodër Sulejmani mësoi edhe letërsinë e madhe të këtij qarku, Fishtën, Migjenin, Mjedën, Rozafën, Teutën e Dhimitër Farin, Oso Kukën, "Bardhën e Tejmalit". Kjo e fundit i shfaqej shpesh, papritmas para syve si hije a fantazmë.

Por më shumë se gjithçka e ka habitur historia e Skënderbeut , bëmat e lavdia e tij. Sulejmani ka qenë njohës i gjithçkaje që është shkruar për kryheroin tonë kombëtar, që nga Marin Barleti e deri më sot. Citonte vargje pafund. Shpesh bënim konkurs mes kolegësh për Skënderbeun, dhe gjithnjë fitonte Sula. *" E dua atë që jeton për të ditur"*. (Friedrich Nietzsche, *Kështu foli Zarathustra*, Tiranë, 2001, f. 15)

Sulejmani ka punuar gjithë jetën në vendlindje mësues i matematikës e fizikës. Ka qenë i përpiktë ashtu si shkenca që u mësoi nxënësve të tij. Ka edukuar breza të tërë nxënësish. Matematika, geni, mësimet pitagorike e kishin shtyrë drejt logosit. Dhe këtë të fundit e ndan një hap nga filozofia. Pyeste vetën mbi enigmat që shfaqen në raportet sasiore e cilësore të jetës. Herakliti na ka mësuar se shpirti është jo vetëm frymë, por përbërësi mendor i njeriut. Kufitë e shpirtit nuk do ti arrijmë kurrë sado larg të shkojmë. Sula-siç e thërritshim shpesh ka qenë dy herë drejtor i shkollës në Ploshtan ku shquhej për stilin demogratik të drejtimit. Ka qenë i zgjedhur në organet e qeverisjes vendore. Ai ka dashur të bëhej gjeolog. Donte të zbulonte xeherorë të dobishëm për vendin tonë. Fati nuk ja plotësoi këtë dëshirë rinore.

Sulejmani dinte të kuvendonte dhe shpesh e merrnin për miqësira. Fjala e tij ka pasur vlera ligjërimore, prurje të freskëta dialektore. Ai ka qenë përdorues i kuptimit të dytë të fjalës, të fjalës së thukët e urtake, shpesh me shpotitje. Gjërat për të cilat fliste të dukeshin të pranishme sado abstrakte të ishin, se i sqaronte me imtësi. Për çdo argument kishte një argument tjetër të barasvlefshëm për të kundërshtuar. Gjykime përballë gjykimeve. Ajo që përbën thelbin e personalitetit tij dinjitoz edhe të çdo njeriu, është karakteri i mirë. Prova më e mirë për Sulejmanin janë sjelljet e mira.

Në shkollë mesuesit tregonin histori e barsoleta të ndryshme. Pas disa ditësh Sulejmani u ndryshonte personazhet, i shtonte ose i hiqte diçka fabulës dhe i ritregonte. Subjekti ishte real , por më shumë i krijuar. Ata që ja kishin thënë e dëgjonin dhe qeshnin me shpirt nga mënyra e deklamacionit , fjalori e konteksi i situatës. Atij i punonte fantazia. Nga gjëra të thjeshta i bënte njerëzit të qeshnin, duke improvizuar nga hiçi.

Personaliteti tij kërkonte Po-në ose Jo-në të madhe, por kurrë mes këtyre të dyjave. Vinte në dyshim atë që e dinin të gjithë. E shikonte tjetrin në sy. Nuk i ka ulur sytë e ndritshëm asnjëherë poshtë. Ka pasur zë të ëmbël, me timbër të veçantë, vende-vende me tejkalim të vetës , duke ngelur mik i së vërtetës. Ka pasur koncept stoik për jetën të cilën e përballoi me sjellje stoike e kohëzion moral. Koha në të cilën jetoi ka pasur kufizime e mospërmbushje të vetvetes. Jetë jo shpërblyese. Por ai pranoi fatin që i dha ajo dhe kufizimet kohësore. Nuk po krijoj një legjendë për mësues Sulën. Këto rreshta janë vetëm përafrime për të përshkruar përsonalitetin e tij. Pasi jo vetën Sula , por çdo mësues është një libër i hapur , që kurrë nuk arrihet të lexohet deri në fund.

Sula ka jetuar 64 vjet. Ai ka qenë fëmijë i zgjuar , djalë i zgjuar dhe burë i matur e me gjykim të mprehtë. Punën e merrte pa ngutje, por e çonte deri në fund. Nuk ka qenë i fizikshëm, por këmbëngulës. Vitet e fundit të jetës shëndeti iu rëndua nga sëmundja, e cila e kishe kapur që në rini. Por asnjëherë nuk e mposhti. Durimtar. Nuk ankohej, nuk i mërziste njerëzit duke treguar sëmundjet e veta. Raporti që ka pasur me sëmundjen pesëdhjetëvjeçare do ti shkonte mirë togfjalëshi –përballje siziftiane. Bënte humor të këndshëm. Trupi u kthye kundër vetvetes.

Por jo kundra shpirtit, se shpirti ishte më i madh se qenia e tij. Kodi gjenetik nuk e kontrolloi shtimin e përshpejtuar të qelizave të liga. Por Sula i shpëtoi ankthit të vdekjes. Nuk ka pasur frikë për tu frikësuar, por vetë frikën. Ai ka pasur koncept stoik për shpirtin, ardhjen e ikjen në jetë të njeriut. Kjo dukej në sjelljen dinjitare, pasi veprimi i shpirtit është të drejtojë e të rregullojë sjelljen e përditshme të njeriut. Afro dhjetë vjet jetoi në liri, në Tiranë. Ka rritur e edukuar pesë fëmijë , dy vajza e tre djem. Secili është qytetar shembullorë. Të shkolluar në universitetet më të mira të vendit e Londrës. U ndezi një flakë në zemër për punë të nalta e atdhedashuri.

Qazim Prejsi, vendimi i Byrosë së Partisë dhe reagimi i banorëve të Lurës

Nga OSMAN VLADI

Në muajin gusht të vitit 1974 Komitetit Ekzekutiv i rrethit Dibër i propozon Byrosë së Komitetit të Partisë shkarkimin nga detyra të kryetarit të Kooperativës së Lurës Qazim Prajsin dhe çuarjen e tij për ndjekje penale për shpërdorim detyre ngase në këtë kooperativë ishin konsumuar rreth 800 kv misër mbi planin vjetor të caktuar për bukë. Për këtë dhe byroja e Partisë e shkarkon nga detyra si kryetar dhe jep porosi kryetarit të Kooperativës Selishtë për ta vendosur si brigadier arash. Në zbatim të kësaj porosie, ai vazhdon punën atje.

Por nuk do të kalon 2-3 ditë që ai do të lajmërohej për të shkuar në Lurë, mbasi atje do të shkonte një ekip nga byroja e Komitetit të Parisë si dhe nga Komiteti Ekzekutiv, të cilët do të diskutonin në të nëntë fshatrat e Lurës dhe në përfundim dhe në asamblenë e kooperativës për të vendosur në popull shkarkimin ose jo nga detyra e kryetarit të kooperativës.

Për këtë, si në diskutimin në fshatra dhe në fund edhe në asamblenë e kooperativës gati në unitet të plotë u tha se nuk ishin dakort me vendimin e byrosë së Partisë së Rrethit.

Ndër diskutantët e shumtë do të fliste edhe një person nga fisi Çoke të fshatit Lajthizë, ku ndër të tjera tha: "Kjo dasi misri që është shpenzuar nga ana jonë mbi planin e caktuar, atë ne e kemi ngrënë për bukë dhe nuk e kemi marrë me u pasuruar me të, se edhe e kemi ble me lekë e nuk e kemi marrin falas. Unë jam i autorizuar nga banorët e fshatit Lajthizë që t'ju them ju të deleguarve që na keni mbledhur këti se ne jemi gati të firmosim që nuk do të kërkojmë më bukë nga kooperativa, për aq sa kemi marrun nga kooperativa dhe se ne nuk jemi dakord kurrën e kurrës që të shkarkohet kryetari i saj me këtë motivacion, mbasi për ne ky veprim konsiderohet si prerje në besë ndaj tij, e ju siç e dini, populli i Lurës besën e ka shumë e shenjtë e për këtë ka sakrifikuar edhe djalin e saj dhe shkarkimi i tij nga detyra do ta linte atë të turpëruar përjetë, e nëse ju nuk do t'i pranonin këto fjalë të banorëve të fshatit Lajthizë, ata thonë se do t'i drejtohemi Tiranës dhe nuk do të dalim në punë në kooperativë.

Mbas këtij diskutimi pati vetëm solidarizim me parafolësin dhe në sallën e mbushur me mbi dyqind veta do të krijohej ilaritet sidomos kur në këto momente do të ngrihej një person dhe do të thirrte me të madhe: Rroftë Komiteti Qendror i Partisë së Punës me në krye shokun Enver Hoxha! Kjo bëri që salla të gjëmojë nga duartrokitje e brohoritje për Partinë e shokun Enver dhe së bashku me të do të bashkoheshin edhe pjesëtarët e ekipit të ardhur për të zbatuar vendimin e byrosë së Partisë së rrethit për të shkarkuar nga detyra kryetarin e Kooperativës bujqësore të Lurës.

Por, megjithëse Qazim Prejsi mbeti përsëri kryetar i Kooperativës së Lurës nuk do të shkonte viti që atij do t'i gjendej një cen në biografi (nga ana e dajave) dhe do të shkarkohej në masën "kthim në kandidat partie", por në këtë rast edhe populli i zonës së Lurës nuk mund ta mbronte më.

Kohë më vonë për atë që ndodhi në zonën e Lurës në atë kohë do të prononcohej një nga pjesëtarët e ekipit të Komitetit të Partisë duke thënë se: Ajo që bënë banorët e Lurës në atë kohë unë nuk di nëse mund të kishte ndodhur ndonjëherë në ndonjë vend të Shqipërisë, pasi vendimi i Byrosë ishte absolut i kthyer në tabu, pra aty unë kuptova se burrat e asaj zone bëhen një dhe kthehen në ortek, duke mos njohur, por vetëm për të ruajtur dinjitetin e tyre të ruajtur brez pas brezi.

Arif Vladi, zëri i këngëve lapidare

Nga **ARSIM KOLARI**



Arif Vladi lindi më 3 shtator të vitit 1956 në Lurë ku kreu shkollën fillore, për të vazhduar Liceun Artistik "Jordan Misja" dhe Akademinë e Arteve – dega kanto (1980). Si nxënës i klasës së gjashtë, u ngjit për herë të parë në skenë, në festivalet e zonës, për të vazhduar pa shkëputje në të gjitha festivalet folklorike të Rrethit, ndërsa kënga e parë e kënduar nga ai para publikut ishte "Djemtë e Lumës, hiç s'kanë dert". Fama e tij artistike nisi në fillim të viteve të '80-ta, ku pas mbarimit të Akademisë, dy vjet punoi si këngëtar në Ansamblin Shtetëror të Këngëve e Valleve dhe pastaj në Estradën e Peshkopisë (deri në vitin 1989), kurse kulmin famës e arriti në vitet e fundit të shekullit XX. Përhapja e famës së Arif Vladit në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e diasporë, u bë me punimin e këngëve "O prite Azem Galicën", "Hajredin Pasha", "Jakup Ferri me bajrak", "Sefë Kosharja i pari i fisit", "Jam Kosova e shqiptarisë", "Marshi i UÇK-së", etj. Si talent i rrallë i këngës shqipe, me popullaritet të pazakonshëm, merr pjesë në shumë turne ndërkombëtare, ku këngët e tij ishin "ajka" e repertorit të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve, si në Francë (1980), Zvicër (1981), Gjermani Perëndimore (83), Algjeri-Tunizi (1984), Itali-Austri (85), Egjipt (89), etj. Në sirtarin e tij artistik rradhiten këto albume muzikore: "Arif Vladi këndon", "Kënga ime për shqiptarët", "Unë dhe këngët e mia", "Jam Kosova e shqiptarisë", "Marshi i UÇK-së", etj.

Arif Vladi me këngën e tij të kënduar me profesionalizëm dhe përkushtim të pashoq, u bë "pushka" atdhetare e shqiptarisë, krisma e të cilës u dëgjua në luftën heroike çlirimtare të UÇK-së së Kosovës, për çlirimin njëherë e përgjithmonë nga regjimi i Serbisë. Sot ai bashkë me familjen jeton e vepron në Belgjikë, por kohë pas kohe vjen në Shqipëri e Kosovë, ku me bashkëpunëtorët e tij: tekstshkruesin Agim Doçi, kompozitorët Edmond Zhulali e Përparim Tomçini, me këngëtarin që kanë realizuar disa hite kushtuar heronjve dhe kombit shqiptar Ilir Shaqiri, punon projekte të reja. Sivjet, për personalitetin dhe veprimtarinë e tij artistike, të pazakontë deri më tani, është realizuar një film dokumentar nga kolegu i tij Ilir Shaqiri, regjisori Blerdi Malushi,e gazetari Besart Galica, i titullluar "Arif Vladi – Zëri i këngëve lapidare" u shfaq në Muzeun Historik në Tiranë dhe në Qendrën për Kulturë "Haki Stërmilli" në Peshkopi. Emri i Arif Vladit do të përmendet gjithnjë, asnjë kohë nuk do të kalojë pa e kujtuar këtë këngëtar brilant, dhe do ngrihet në krahët e kujtesës për të fluturuar në fushat e mbjella me histori e kultura të reja të së ardhmes. Tre bashkëpunëtorët, njëherit dhe miqtë e Arif Vladit që i kemi përzgjedhur për të shprehur vlerësimet për të, na veçojnë:

HAXHI MAQELLARA (këngëtar dhe kantautor): "Të flasësh për Arif Vladin, këtë figurë markante të muzikës shqiptare dhe asaj dibrane, duhet të mendohesh mirë. Këngëtar si Arif Vladi, Shqipërisë dhe Dibrës, i vijnë njëherë në 100 vjet! Unë jam krenar që e kam shok e mik të ngushtë dhe po ju them me plot gojën se përulem deri në pafundësi përpara emrit të tij të madh. E kush përfaqësoi Dibrën më mirë se ai?! Kush i këndoi "Kosovës Martire" dhe Epopesë së lavdishme të UÇK-së më bukur se ai?! Përsëri me plot gojën po them - askush! Ai është NDERI i kulturës shqiptare dhe asaj dibrane, ndaj uroj , me shpirt e me zemër, që të ketë jetën e gjatë e të lumtur dhe të na freskojë shpirtin edhe me shumë këngë të tjera".

LIRIE RASHA (këngëtare): "Me Arifin kemi punuar bashkë që nga vitet '80 e deri në vitin 1994, në trupën e Estradës Profesioniste të qytetit të Peshkopisë. Arifi ka spikatur gjithmonë për vlerat e tij vokale dhe interpretative. Ai ka dhënë një kontribut të çmuar për artin dibran, si dhe ka elaboruar mrekullisht zhanrin e këngëve patriotike, sidomos ato kushtuar luftës në Kosovë. Karriera e tij ka qenë e suksesshme dhe me një trend vazhdimisht në rritje. Përveç pjesës së muzikës, Arifi është një koleg shumë i shoqërueshëm që sjell humor në tryeza miqsh".

AVNI NDREU (koreograf e valltar): "Arif Vladi pa dyshim është një ndër zërat më brilant të këngës e muzikës kombëtare. Ai gurgullon me zërin e tij të papërsëritshëm si ujëvarë, në flladin e bjeshkëve. Me interpretimet e fuqishme të tij, ai e ka ngjitur këngën shqipe në majat më të larta duke bërë që të shpaloset plot dinjitet edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërkohë, Arif Vladi mbetet gjiganti i këngëve hymn kushtuar patriotizmit e atdhetarizmit e të luftës së UÇK-së. Pa mëdyshje mund të themi se ai ishte kolona zanore dhe shpirti i UÇK-së. Zëri i Arif Vladit mobilizon, por edhe flladit, të bën krenar por dhe te hedh në valle, është zëri që i kishte munguar këngës shqiptare e tani siç e thashë edhe me lartë, e ka ngritur në majat më të larta. Unë jam shumë i vlerësuar që në dhjetra koncerte të tij kam qenë pjesëmarrës si koreograf dhe valltar, duke u rreshtuar përkrah këtij artisti të madh e të papërsëritshëm, ku padyshim muzika e këngëve të tij ka qenë edhe muzika e koreografive të krijuara nga unë. Arif Vladi është artist human që e do vendlindjen, i don njerëzit, i dhimbset kombi kur vuan, por ngazëllen kur sheh që shqiptarët kudo që janë ndjehen mirë. Kjo e bën më dimensional si artist, duke i dhënë dhe tagrin e zëvendësit të kombit me këngët e tij".



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**
Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.